


Trafiku
Çiklistët, "delet
e zeza" në
komunikacion

Fq.6



**HULUMTIM
I UNSH-së**
Ngacmimet
në shkolla
shënojnë rritje

Fq.9



**Gruaja
nga DJ
që u bë
kryemi-
nistre**

Fq.18



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3618 · e martë, 26 mars 2019

5°C | 15°C

15 DEN



**KOHA për
Kulturë**

Fq.12-15

RAJON

**Kosova po
braktiset,
politikës s'i
bëhet vonë!**



Migrimi i qytetarëve të Kosovës nëpër vende të ndryshme, kryesisht ato evropiane, pavarësisht perceptimit se ka shënuar rritje, sipas të dhënave zyrtare ka shënuar rënie. Sipas një raporti të publikuar ditë më parë nga Ministria e Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, thuhet se për periudhën 2013-2017 mesatarisht në vit kanë emigruar deri në 35 mijë qytetarë të Kosovës. Përgjatë viteve 2013-2017, nga Kosova, sipas këtyre të dhënave, të cilat kanë si...

Fq.16

GLOBI


**Mjalti sintetik
po mbyt
Europën**

Fq.17

FORUM

**"Ballkanizimi"
i BE-së është i
rrezikshëm**

Fq.10



RRETH 20 INICIATIVA NË GJYKATËN KUSHTETUESE

VAZHDON "LUFTA" KUNDËR SHQIPES



Burime zyrtare tregojnë për gazetën KOHA se iniciativat kundër Ligjit të gjuhëve janë dorëzuar që nga qytetarë të rëndomtë e deri në profesorë universitarë dhe politikanë maqedonas. Një pjesë kërkojnë anulimin e tërësishëm të Ligjit, ndërsa pjesa tjetër kontestojnë shqipen në proceset gjyqësore, në pushtetin lokal, madje edhe në polici dhe armatë

Fq.3

Bellanoc-Stançiç, kufiri që po ngec

Shkup, 25 mars - E iniciuar që në vitin 2011, ndërsa e planifikuar të hapej në janar të këtij viti, vendkalimit kufitar Bellanoc-Stançiç nuk i duket fundi. Përveç asfaltimit të rrugës me dy korsi, nga fshati Sllupčan deri në fshatin Stançiç të Kosovës, objekti ku duhet të vendoset pika kufitare akoma nuk ka përfunduar, edhe pse në qershor të vitit të kaluar, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ai i Maqedonisë,

Bujar Osmani dhe ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zhbogar, vunë gurthemelin e objektit kufitar, ndërsa siguruan se në janar 2019, pika kufitare do të jetë e hapur. Punët në terren herë ngecin e herë zhvillohen me tempo të ngadalësuar, ndërsa në afërsi të pikës kufitare, janë katër gurë betoni që kanë bllokuar hyrje-daljet Maqedoni-Kosovë. "Kantier ndërtimi" dhe "Kujdes! Zonë punimesh"...

Fq.5



EDITORIAL

SHOUMENI I MADH
I EVROPËS

Nga Alexander Clarkson

Letra e dashurisë së Emanuel Makronit ndaj Evropës, ishte një teatër i pastër, dhe tipike e presidentit francez. Ndoshta më shumë se çdo politikan tjetër, Makron ka një aftësi të spikatur për të diktuat axhendën e lajmeve në Evropë. Përmes shfaqjeve të tij butaforike, ai ka ndërnuar një markë që u bë menjëherë e njohur, shënoi një ngjitje marramendëse në pushtet, dhe ka ruajtur që atëhere vëmendjen e kontinentit.

Kur hasi në vështirësi, si më së fundi kur u sulmua nga lëvizja anti-establishment e Jelekëve të Verdhe, Makron përdori fasadat, si takimet qytetare apo traktatin franko-gjerman të Ahenit me kancelaren Angela Merkel, për të rifituar popullaritetin e humbur.

Letra e hapur e kësaj jave, që u botua nga gazetaret në ç' do vend të BE-së, nuk përbën ndonjë përjashtim. Të fokusohesh në përmbajtjen e saj dhe propozimet e politikave, do të thotë të humbasësh thelbin e këtij akti. Qëllimi i tij i vërtetë, qëndron në atë që na tregon, drejtimin e politikës në një kontinent në ndryshim të shpejtë.

Letra e Makron, është një thirrje për një BE më aktive dhe më të fuqishme. Ajo i drejtohet kryesisht një audience të brendshme. Presidenti francez, po kërkon të tërheqë mbështetjen e votuesve të cilët, megjithëse janë në përgjithësi në favor të BE-së, do të ishin më të prirur për të votuar për socialistët, të gjelbërit apo Republikanët e qendrës së djathtë në Francë.

Me partinë e tij "La République En Marche" me vetëm paksa mbi 20 përqind në sondazhe, kokë më kokë me udhëheqësen e ekstremit të djathtë të Tubimit Kombëtar, Marin Lë Pen, Makron nuk ka luksin të humbasë ndonjë mbështetje nga e djathta ose nga e majta.

Por, letra kishte gjithashtu edhe një audiencë tjetër. Polemikë e menjëhershme që shkaktuan propozimet e tij në të gjithë Evropën, i dhanë Makron një mundësi tjetër, për të shitur veten si udhëheqësi i vetëm i aftë që mbron projektin evropian nga një sulm i populistëve.

Shkalla në të cilën Makron vuri prestigjin e tij personal, në frontin e betejës elektorale për Parlamentin Evropian, dhe jehona e mesazhit të tij në mbarë Evropën, flet gjithashtu për vetëdijen e tij, se faza politike evropiane është vendimtare për udhëheqësit kombëtarë.

Një apo dy dekada më parë, krerët e shteteve do t'i kishin trajtuar zgjedhjet e Parlamentit Evropian, thjesht si hapin e rradhës. Tani, përqendrimi gjithnjë e më i dukshëm i fuqisë kolektive në duart e institucioneve të BE-së, i ka bërë ato mjete me vlerë, ku ia vlen të shpenzohet një kapital i madh politik për të fituar.

Gjithkush është duke u angazhuar për të diktuat të ardhmen e BE-së. Nuk është një fushëbetejë e lehtë, ku mund të kesh epërsi. Krizat e njëpasnjëshme, eurozona, emigrimi, Brexit, krijuan domosdoshmërinë e një debati politik ndërkufitar. Por, pasojat e tyre i kanë polarizuar shoqëritë, dhe kanë forcuar politikën e partive kombëtare.

Rreziqet e mëdha në këto zgjedhje për të ardhmen e BE, kanë mprehur linjat e betejës ideologjike, midis rrjeteve rivale partiake brenda Parlamentit Evropian, dhe midis forcave politike në nivel kombëtar. Kjo ka bërë që të jetë më e vështirë gjendja e konsensusit evropian.

Gjithkush, pro-evropianët dhe euroskeptikët, po përpiqen të dominojnë në debatin politik, dhe të vendosin mbi të ardhmen e BE-së. Dhe mjeti më i mirë për ta bërë këtë, janë shfaqjet e shkëlqyera publike, që shfrytëzojnë çështjet evropiane në avantazhin e tyre.

Kështu është gjenerata e re e liderëve të BE-së, duke përfshirë Makronin, dhe në anën tjetër udhëheqësin e të djathtës italiane, Mateo Salvini, si dhe të tjerë, janë duke luajtur se kush do të kontrollojë BE-në. Këto ditë, sukcesi kombëtar është i lidhur me aftësinë për të shkëlqyer në skenën evropiane. Zhgënjimi kryesor nga letra e Makron, është se shoumeni më i madh i Evropës, e ka kuptuar më mirë se kushdo tjetër, "manualin" e ri të lojërave.

(Alexander Clarkson, është lektor mbi studimet evropiane në Kolegjin Mbretëror në Londër)

RRËFIMI PËR
DASKALLIN SERB
DHE MËSUESIN
SHQIPTAR

"Shkolla e parë shqipe në Veshallë u hap më 22 Dhjetor të vitit 1945. Lajmi se kishte ardhur një mësues i ri, u përhap shumë shpejt në tërë katundin. Natën e parë ai djalosh e kaloi te një familje e njohur e prindërve të tij. Ende ishte koha kur shumë nga katundarët nuk e kuptonin fjalën „Mësues”. Në kujtesën e tyre ende mbahej mend daskalli i dikurshëm serb nga Kragojevci, icili kah vitet e 30-ta, në këtë katund e hapi shkollën në gjuhën serbe.

Mësuesi i ri shqiptar, djaloshi nga Gajrja, natën e parë e zbardhi me dilemën nëse do ja dalë apo jo, të bëhet mësues i mirë. Kurrështja për ta parë këtë njeri që kishte ardhur nga Gajrja në Veshallë për të na mësuar, nuk më la të qetë, doja ta shoh sa më shpejt, thotë Shabani, një ish nxënës i gjeneratës së parë të kësaj shkolle.

Shtëpia ku e kaloi natën e parë ky i ri, që do e hapte shkollën shqipe, rrëfen Shabani, ishte ajo e axhës Selam, krejt afër shtëpisë sonë. Derisa në mëngjesin e acartë të dhjetorit ai po dilte nga dera e madhe e kurtit të vogël, për në shkollë, vazhdon ai, ia zura rrugën, dhe e pyeta: A je ti ai daskalli që ke ardhur të na mësosh, ai më përkëdheli mbi kësulën e bardhë dhe më tha: Jo, nuk ka më daskall, unë jam mësuesi që do ju mësoj në gjuhën tonë të bukur shqipe. Ai mësues ishte Hysni Vela. Kështu e mbaroi rrëfimin e shkurtër Shabani, vogëlushi i dikurshëm, nxënësi i mësuesit Hysni, sot një burrë që po shkel në të tetedhjetat.

Lavdi jetës dhe veprës fisnike e të shenjtë të mësuesit të parë të shkollës fillore „Besa”, të Veshallës, mësuesit Hysni Vela!", ka shkruar një status në Facebook, prof. Vebi Bexheti.

TË SHKËPUTURIT
NGA REALITETI

"Kompleksi i madhështisë dhe ai i persekucionit, ka kapur të gjithë të shkëputurit nga realiteti, ata që bëjnë fresk dhe ata të cilëve u bëhet fresk. Si nuk u ngopën?! Askush prej tyre nuk shqetësohet për gjendjen e Shqipërisë apo për të ardhmen e saj. Shqiptari vidhet përditë, edhe ai që mendon se nuk vidhet. Nuk di se ku do i çojë deliri dhe mitomania, por një gjë është e sigurtë, të gjithë do të gjykohe mi një ditë!", ka shkruar një status në Facebook, politologia nga Tirana, Haris Vongli.

MEDIACitate

Sadiç Khan kërkesë
Theresa May-it,
Luftë ndaj
"islamofobisë"

Kryetari i Londrës, Sadiç Khan ka sfiduar kryeministren May duke i kërkuar që ta adaptojë një definicion të ri për Islamofobinë, duke thënë se ai vazhdimisht ka qenë subjekt i fjalorit anti-mysliman nga anëtarët e Partisë Konservatore. Në një letër dërguar për Theresa May, Khan i ka bërë thirrje kryeministres që të merret me këtë çështje.

Ai ka thënë se duhet të merren masa që të sigurohen Britanikët e fesë islame, duke e pasur parasysh rrezikun që vjen pas sulmit në Zelandën e Re. Ai paralajmëron se masakra tregon "pasojat e dështimit që ta largojmë islamofobinë me rrënjë nga shoqëria jonë."

Disa anëtarë të partisë Konservatore, ishin dyshuar për fjalor anti-mysliman javën e kaluar. Numri i sulmeve ndaj mysli-manëve në Britani vetëm javën e kaluar, pas sulmit në Zelandën e Re, është rritur me 59%.

Khan i bëri thirrje kryeministres që ta pranojë definicionin mbi Islamofobinë dhe që ai definicion të jetë i pranuar nga të gjitha partitë parlamentare të Britanisë.

Në definicionin të cilin partia Laburistë tashmë e ka pranuar shkruhet "Islamofobia i ka rrënjët tek racizmi dhe si target konsiderohet mysli-manët, ose mysli-manët konsiderohen armiq" Khan shkruan: "Sigurimi i britanikëve mysli-manë pas sulmit në Zelandën e Re, nuk është vetëm për çështje politike apo sigurie. Gjithashtu kërkoj që të shkatërrohen të gjitha rrënjët e islamofobisë dhe anti-islamizmit. Ndalimin e abuzimit të mediave sociale dhe abuzimi në debate politike. Është vitale që partitë politike të na udhëheqin në arritjen e këtij qëllimi, dhe ato duhet të jenë shembull për shoqërinë."

"Partia Konservatore në veçanti duhet të bëjë më shumë përpjekje që të dërgojë mesazhin se islamofobia nuk është e pranueshme."

"Unë personalisht vazhdimisht kam qenë subjekt i islamofobisë nga anëtarët e partisë Konservatore dhe mbështetësit e saj. Unë tashmë e kam humbur durimin mbi disa anëtarë të partisë suaj, dhe me ta do ndjekë mënyrat ligjore të zgjidhjes së problemit."

Kryetari Khan, gjithashtu sulmoi edhe kandidatin konservativ për kryetarë të Londrës, Shaun Bailey, për ripostimin e artikujve në Twitter, ku në ato artikuj Sadiç Khan përshkruhet si "Imam i çmendur i Londistanit". Skuadra e Baileyt ka thënë se nuk ka vërejtur se këto artikuj kanë pasur përmbajtje ofenduese. Madje Bailey ka bërë thirrje që të luftohet islamofobia nga rrënjët, dhe partia duhet ta bëjë një diskutim për këtë çështje.

(The Guardian, 25 mars)

RRETH 20 INICIATIVA NË GJYKATËN KUSHTETUESE

MAQEDONASIT NUK "DORËZOHEN" KUNDËR SHQIPES

Burime zyrtare tregojnë për gazetën KOHA se iniciativat kundër Ligjit të gjuhëve janë dorëzuar që nga qytetarë të rëndomtë e deri në profesorë universitarë dhe politikanë maqedonas. Një pjesë kërkojnë anulimin e tërësishëm të Ligjit, ndërsa pjesa tjetër kontestojnë shqipen në proceset gjyqësore, në pushtetin lokal, madje edhe në polici dhe armatë



parashikuar dhe akoma nuk parashikon që vendimet në Gjykatën Kushtetuese, ashtu sikurse për Ligjet që prekin të gjitha etnitetet, të mund të sillen me shumicën e Badenterit", thonë në Gjykatën Kushtetuese. Në Qeveri dhe Parlament ndërkohë janë në dijeni të iniciativave kundër Ligjit të gjuhëve, por shpresojnë se Gjykata Kushtetuese do të sjellë vendime që nuk e rrezikojnë situatën politike në vend.

"Jemi në dijeni të iniciativave kundër Ligjit të gjuhëve, megjithatë shpresojmë se tek anëtarët e Gjykatës Kushtetuese do të mbizotërojnë qëllimet e mira që të mos futet vendi në krizë politike, pasi abrogimi i pjesëve të Ligjit do të sillte bllokim total të punës së Parlamentit dhe Qeverisë", thonë deputetë shqiptarë për gazetën KOHA, ndërsa sigurojnë se janë në konsultim edhe me kabinetin qeveritar për gjetjen e mënyrave për implementimin e tërësishëm të Ligjit të gjuhëve. Ndryshe, Ligji për përdorimin e gjuhëve hyri në fuqi më 15 janar të vitit 2019, kur edhe u shpallë në "Gazetën Zyrtare" të Maqedonisë së Veriut.

Koha Vedat MEMEDALIU

Shkup, 25 mars - Maqedonasit nuk ndalen kundër Ligjit të gjuhës shqipe. Edhe pse shtetit iu ndërrua emri bashkë me Kushtetutën, madje është rrezikuar dhe identiteti maqedonas, bashkëqytetarët tanë duket se problem më të madh në vend e kanë pikërisht përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe nga vet shqiptarët. Rreth 20 iniciativa kundër Ligjit të gjuhës tashmë janë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese. Një pjesë për tërë Ligjin, ndërsa pjesa tjetër kërkon heqjen e dispozitave

ligjore që parasheh përdorimin e shqipes në proceset gjyqësore, në pushtetin lokal, madje edhe në polici dhe armatë.

Burime zyrtare tregojnë për gazetën KOHA se iniciativa kundër Ligjit të gjuhëve, Ligji që tashmë ka filluar implementimin e pjesërisht, janë dorëzuar që nga qytetarë të rëndomtë e deri në profesorë universitarë dhe politikanë maqedonas. Madje, siç thonë për gazetën KOHA nga Gjykata Kushtetuese, disponimi i gjykatësve maqedonas është që sa më shpejtë të fillohet me procedimin e këtyre ini-

ciativave, ndërkohë që situata brenda në gjykatë nuk është në favor të mbrojtjes së Ligjit. Nga ana tjetër, po kjo gjykatë ka hedhur poshtë iniciativat kundër Marrëveshjes së Prespës dhe ndërrimin e emrit të shtetit, duke mos diskutuar fare për përmbajtjen e marrëveshjes.

"Tashmë janë hedhur poshtë iniciativat për Marrëveshjen e Prespës, ndërsa në radhë janë iniciativat kundër Ligjit të gjuhës. Është e sigurt se Ligji në tërësi nuk do të anulohet, por ka gjasa që pjesa të Ligjit të kontestohen dhe të shpallen jokushtetuese, siç është pjesa e

përdorimit të shqipes në pushtetin lokal, në gjyqësi dhe në polici e armatë", thonë për KOHA nga kjo gjykatë, ndërsa shtojnë se gjykatësit maqedonas duan që sa më shpejtë të bëjnë shpërndarjen e lëndëve për gjykatësit.

"Është vështirë të mbrohen pjesë të Ligjit, kur votimi bëhet me shumicë të thjeshtë dhe jo me Badenter. Është absurde që një Ligji i votuar në Parlament me dy të tretën e votave dhe me Badenter njëkohësisht, të mund të anulohet me shumicë të thjeshtë. Kjo është mangësia e Parlamentit që nuk ka

Publicitet



ПОЧИТУВАЈ, НЕ МРАЗИ!
RESPEKTO, MOS URRE!
SAYGI GÖSTER, NEFRET ETME!
RESPECT, DON'T HATE!



Petar Arsovski
Analist

Gjuha e urrejtjes është dhunë, e ngjashme me dhunën fizike. Prandaj, duhet të mos e tolerojmë dhe injorojmë. A do të heshtnit po nëse dikush ju godet me shuplakë?



Кампањата е иницирана и спроведена од АЗНММ | Feshata e inicuar dhe realizuar nga AMMSHM | The campaign is initiated and implemented by APSPM

СЛОБОДЕН ПЕЧАТ. **вечер** **ПОРА** **Канџан** **М** **ЛИМ** **ZAMAN** **Борак**
Koha **НЕЗАВИСЕН** **ДОРНО** **ЗБИТ ШЕНЈА** **М** **МАКЕДОНИЈА** **ТРАНСЛУК** **СКОПЈЕ**

TAKIM PUNE PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR SHQIPEN

EKIPI I AGJENCISË PËR GJUHËT, PAS ZGJEDHJEVE

“Qeveria ka vendosur që deri në ekipimin e Agjencisë me kuadër profesional, përkthimet do të bëhen në Qeveri e më pas do t’ju dërgohen institucioneve tjera”, tha Osmani

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 25 mars - Dy muaj pas hyrjes në fuqi të Ligjit për përdorimin e gjuhës, tanimë veç ka vullnet politik dhe institucional për zbatimin e Ligjit, ndërsa Qeveria ka formuar Agjencinë për gjuhë dhe së shpejti, ky institucion do të vendoset në zyrat e saj. Kështu deklaroi zëvendëskryeministri i Qeverisë, Bujar Osmani, pas takimit që pati me drejtorin e Agjencisë për gjuhë, Ylber Sela. “Sfida më e madhe do të jetë përkthimi adekuat, sepse ka institucione që u nevojitet sasi e madhe përkthimi në baza ditore dhe bëhet fjalë për 1300 institucione”, tha Osmani. Pikërisht për këtë, potencoi Osmani, së shpejti pasi Agjencia të vendoset në zyrat e saj dhe të kompletjë ekipin, do të shpall konkurs për pranimitë e përkthyesve dhe lektorëve profesional.

“Qeveria ka vendosur që deri në ekipimin e Agjencisë me kuadër profesional, përkthimet do të



EMRI I RI I FASADËS SË QEVERISË, PAS ZGJEDHJEVE

Vendosja e emrit të ri në fasadën e Qeverisë do të bëhet pas zgjedhjeve, deklaroi dje sekretari i përgjithshëm i Qeverisë, Dragi Rashkovski, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas takimit me përfaqësuesit e Grupit të punës ndërdikasterial për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. “Kjo është procedurë e cila imponon procedura me tender dhe mund të prisni kjo të ndodh pas përfundimit të zgjedhjeve në pajtim me atë se gjatë

zgjedhjeve procedurat e tenderëve të cilat nuk janë në planin vjetor për furnizime publike nuk mund të zbatohen”, tha Rashkovski. Pas fuqizimit të Marrëveshjes së Prespës, nga fasada e Qeverisë u hoqën shkronjat “Qeveria e Republikës së Maqedonisë”, ndërsa në vendin e tyre duhet të vijë emri “Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

bëhen në Qeveri e më pas do t’ju dërgohen institucioneve tjera”, tha Osmani. Që në të ardhmen të mos ketë gabime, Osmani paralajmëroi se nuk do të lejohen gabime gjatë përkthimeve, të cilat gabime deri më tani i justifikoi me faktin që kanë ndodhur në periudhën kur nuk kishte Agjenci për zbatimin e gjuhës shqipe. “Ajo çfarë kam bërë unë, është të shfrytëzohet kapacitetet aktuale që janë në Sekretariat, që

nuk janë realisht përkthyes profesionistë, por janë shqiptarë dhe bëjnë çështje tjera në Ministri. Do të bëjnë përkthime derisa Agjencia të furnizohet me njerëz. Tani kur veç kemi Agjencinë si dhe së shpejti formohet dhe Inspektorati për themelimin e të cilit po punon Ministria e Drejtësisë, do të ndërtojnë urë bashkëpunimi edhe me Kosovën, por edhe me Shqipërinë”, tha zëvendëskryeministri për Çe-

shtje Evropiane, Bujar Osmani.

Drejtori i Agjencisë për gjuhë, Ylber Sela, deklaroi se kompletimi i kuadrit të Agjencisë do të bëhet pas mbarimit të zgjedhjeve presidenciale, ndërsa më pas do të përpilojë Programin vjetor. “Pasi të përfundojë procesi zgjedhor, do të kemi edhe konkurse për ta kompletuar ekipin. Kam njoftuar edhe për sistematizimin dhe rregulloren, ku jemi në fazën finale. Si ta

kompletuam ekipin, do të kemi edhe programin e Agjencisë, kështu që vazhdojmë me fazat tjera që na presin”, tha Sela.

Ndërkohë, sekretari i përgjithshëm i Qeverisë, Dragi Rashkovski, njoftoi se personat që do të angazhohen në Agjenci, janë të angazhuar në Sekretariat dhe përgjithshëm, ndërsa kalimi i tyre bëhet me qëllim që të fillojë zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve. “Personat që do të kalojnë në Agjenci janë nën Sekretariat dhe përgjithshëm. Bëhet fjalë për persona që tashmë kanë njëfarë përvojë në punën e administratës shtetërore, ndërsa vlerësojmë se kapacitetet e tyre do të kontribuojnë në këtë Agjenci. Është me rëndësi që në fillim të tregojmë se nuk ka diçka të keqe në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, dhe se i njëjti nuk dërgon në ndryshim të asnjë rregulloreje shtetërore. Këto janë të drejtat të qytetarëve”, tha Rashkovski,

Sa i përket vendosjes së tabelave edhe në gjuhën shqipe nëpër institucionet shtetërore, Rashkovski deklaroi se tabelat e reja me emrin e ri të shteti edhe në gjuhën shqipe do të vendoset pas zgjedhjeve presidenciale.

“Në pamundësi për shpallje të tenderëve gjatë procesit zgjedhor, do të duhet të presim të përfundojmë zgjedhjet presidenciale e pastaj të shpallim tender”, tha Rashkovski, ndërsa potencoi së është i kënaqur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe se deri më tani nuk ka pasur asnjë opstrukcion nga institucionet shtetërore. “Ligji është në rrugë të drejtë të shih dritën e saj”, tha Rashkovski.

CIVILI KËRKON MASA KUNDËR TATJANA LLAZAROVSKËS

Të sanksionohen radikalët në institucione

Shkup, 25 mars - Nuk mundemi dhe nuk guxojmë të pranojmë se mes nesh ka njerëz që lartësojnë kriminelë, vrasës dhe ekstremizëm, pasojat e të cilit janë tragjike - humbje të jetëve njerëzore, pasiguri, frikë dhe bashkësi dhe shoqëri të rrënuara. Nuk mundemi të pranojmë gjendje në të cilën ekstremizmi i një kopeje kultivon bashkëjetesë me ekstremizmin e një kopeje tjetër. Kjo nuk është bashkëjetesë, nuk ka lidhje me tolerancë. Kjo është gjakderdhje e cila sa nuk ka ndodhur. Kështu thuhet në reagimin e organizatës qytetare Civil, ndërsa ka kërkuar të merren masa ndaj Tatjana Llazarovska, punonjëse në ARM, e cila kishte mbështetur aktin terrorist në xha-

mitë e Zelandës së Re, ku u vranë 50 besimtarë musliman.

“Shpërblim Nobel për guxim t’i jepet ‘sulmuesit’, njeriut në Zelandë të Re. Bravo, bravo”, ka shkruar Tatajana Llazarovska në profilin e saj në Fejsbuk.

“Ky profil me të vërtetë ekziston, me të vërtetë është e punësuar në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mban uniformën e këtij shteti, ka aftësi që i ka arritur në sistemin tonë arsimor, pranon rrogë nga buxheti që e mbushin të gjithë qytetarët. Llazarovska është e stacionuar në njësi ushtarake me shumicë banorësh shqiptarë, në gjini artilerie, e cila është jashtëzakonisht mobile. Me armët deri te të cilat ka qasje, trajtohet me lehtësi,

ndërsa pasojat mund të jenë të mëdha dhe tragjike”, thuhet në reagimin e organizatës Civil, ndërsa shpreh indinjatë ndaj Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët vazhdojnë të heshtin rreth skandalit me Llazarovskën.

“CIVIL kërkon nga Qeveria dhe institucionet përkatëse të marrin masa urgjente, kritere të ashpra për vlerësimin e njerëzve që punojnë aty dhe menjëherë t’i sanksionojnë të gjithë të punësuarit dhe funksionarët nëse ata shërbejnë me gjuhë të urrejtjes dhe nxisin radikalizëm, ekstremizëm të dhunshëm, ose në ndonjë mënyrë kontribuojnë ndaj lartësimit të dhunës, kriminit dhe terrorizmit. Përgjegjësia nuk është frazë, është ndërtim i vazhdueshëm i



jetës dhe dinjitetit të qytetarëve dhe qytetarëve, mbrojtje e vazhdueshme e vlerave të një shoqërie të civilizuar dhe humane. Për këtë ekzistojnë buxhetet e shteteve!”, thuhet në reagimin e Civil. Ekstremizmi në shoqërinë dhe sistemin tonë, vazhdon më tej reagimi i Ci-

vil, është operacion shumëvjeçar nga i cili nuk mund të lirohemi nëse heshtet dhe nuk ndërmerret asgjë dhe me heshtje. “Ndoshta me vonesë të madhe, por duhet të fillojë menjëherë, sot! Sipas ligjeve dhe standardeve të ligjvënies tonë!”. (Z.V)

Paditet kërçovari për pastrim të parave

Shkup, 25 mars - Departamenti për shkatërrim të krimit të organizuar dhe serioz pranë MPB-së, deri te PTHP ka parashtruar kallëzim penal kundër N.SH. (39) nga Kërçova për shkak të ekzistimit të dyshimit se ka kryer vepër penale - "pastrim të parave dhe të ardhurave të tjera të veprës ndëshkuese, me ç'rast në periudhën prej 1 janar të vitit 2016 e deri më 24 gusht të vitit 2017 në qarkullim ka lëshuar gjithsej 63.845.147 denarë apo 1.038.132 euro të fituara në mënyrë të paligjshme. I dyshuari, me qëllim që mjetet në para të fituara në mënyrë të paligjshme t'i fshehë nga organet tatimore shtetërore, nga bankat komerciale ka marrë kredi në emër të tij si person fizik, si dhe në emër të dy personave, të punësuar në subjektin juridik në pronësi të tij, ndërsa kreditë me kohë janë shlyer. Gjithashtu, theksojnë nga MPB, N. SH. me qëllim të shumës së plotë mjete në para të fituara në mënyrë të paligjshme t'i transferojë në llogaritë e transaksioneve të hapura në emër të tij në bankat komerciale në shtet, ka kryer edhe më tepër transaksione të pjesshme "nga" dhe "ndaj" personit fizik "SHEJDOTRANS", ndërsa me urdhër të tij një pjesë të këtyre mjeteve në vlerë prej 500.000 euro, në bazë të dyshuar për "investim në aksione" janë transferuar në llogari të transaksionit në Austri, të hapur në emër të personit fizik në Austri ku i denoncuari paraqitet si pronar.

Shkup, fundjava me 23 aksidente

Shkup, 25 mars - Gjatë fundjavës së kaluar në Shkup janë sanksionuar 159 shoferë për vozitje të shpejtë, 16 shoferë kanë kaluar udhëkryqin në dritën e kuqe të semaforit, katër shoferë nuk kanë dhënë leje kalimi për këmbësorët në vijat e bardha, pesë shoferë për rreshtim jo të rregullt, një për parakalim të parregullt, dy shoferë nuk kanë dhënë leje kalimi veturave në zonat e udhëkryqit, 51 shoferë për mospërdorim të helmetës mbrojtëse, 11 shoferë për mospesedim të rripit të sigurisë dhe 29 shoferë për shfrytëzim të telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit, tregojnë të dhënat e buletinit të SPB- Shkup. Gjatë fundjavës në Shkup kanë ndodhur gjithsej 23 aksidente ku një nga këmbësorët ka marrë lëndime të rënda trupore, në 11 lëndime të lehta kanë marrë 17 persona, ndërsa në 11 është shkaktuar dëm material. Policia e komunikacionit ka shqiptuar 206 dënime për parkim jo të rregullt, ndërsa me veturën speciale "karrotreci" janë larguar 139 vetura.

VENDKALIMIT KUFITAR BELLANOC-STANÇIÇ NUK I DUKET FUNDI

KUFIRI QË PO NGEÇ



• Marrëveshja për hapjen e pikës kufitare Bellanoc-Stançiq është nënshkruar në vitin 2013, ndërsa hapja solemne ishte planifikuar më 1 janar 2019. Themeli për ndërtimin e objektit kufitar ishte vënë në qershor të vitit 2018, por nëntë muaj më pas, kati i dytë i objektit kufitar ka mbetur në gjysmë

Punët që duhet të kishin përfunduar që para tre muajve, herë ngecin e herë zhvillohen me tempo të ngadalësuar, ndërsa në afërsi të pikës kufitare, janë katër gurë betoni që kanë bllokuar hyrje-daljet Maqedoni-Kosovë. "Kantier ndërtimi" dhe "Kujdes! Zonë punimesh" janë shënimet e vetme që shoqërojnë murin prej telash në mes të rrugës, ndërsa kati i dytë i objektit kufitar ka mbetur në gjysmë

Koha

Vedat MEMEDALIU

Shkup, 25 mars - E iniciuar që në vitin 2011, ndërsa e planifikuar të hapej në janar të këtij viti, vendkalimit kufitar Bellanoc-Stançiq nuk i duket fundi. Përveç asfaltimit të rrugës me dy korsi, nga fshati Sllupçan deri në fshatin Stançiq të Kosovës, objekti ku duhet të vendoset pika kufitare akoma nuk ka përfunduar, edhe pse në qershor të vitit të kaluar, zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ai i Maqedonisë, Bujar Osmani dhe ambasadori i BE-së në Shkup, Samuel Zhbogar, vunë gurthemelin e objektit kufitar, ndërsa siguruan se në janar 2019, pika kufitare do të jetë e hapur.

Punët në terren herë ngecin e herë zhvillohen me tempo të ngadalësuar, ndërsa në afërsi të pikës kufitare, janë katër gurë betoni që kanë bllokuar hyrje-daljet Maqedoni-Kosovë. "Kantier ndërtimi" dhe "Kujdes! Zonë punimesh" janë shënimet e vetme që shoqërojnë murin prej telash në mes të rrugës, ndërsa kati i dytë i objektit kufitar ka mbetur në gjysmë. Projekti ndërkufitar Maqedoni-Kosovë realizohet me financimin e Bashkimit Evropian, ndërsa është pjesë e projekteve për bashkëpunim ndërkufitar. Veç kësaj, edhe rruga që çon drejt vendkalimit kufitar, nga fshati Sllupçan deri në Bellanoc, tashmë është në gjendje të mjerueshme. Gurë dhe dheu anash tashmë janë shembur në rrugë, ndërsa duket se asnjë institucion, qoftë lokal apo qendror, nuk kujdeset për pastrim. Tanimë rruga me dy korsi ka mbetur e hapur vetëm në mes, pasi anash nuk qarkullohet dot. Në Komunën e Likovës thonë se përgjegjësia për kujdesin e rrugës nuk bie mbi ta, pasi është rrugë regjionale dhe jo lokale. "Kujdesi për këtë rrugë nuk bie mbi ne, por mbi ndërmarrjen 'Rrugët Shtetërore', pasi është rrugë regjionale", thonë në Komunën e Likovës. Analizat gjeologjike, shtojnë në Ko-

munën e Likovës, kanë treguar se problem paraqet përbërja e tokës e cila nuk është e nivelit me të cilën është bërë projekti fillestar. Dhe me këtë, rrezik për rrëshqitjen e dheut dhe gurëve vazhdon edhe më tej, ndërsa nuk ka asnjë shpresë se deri në fund të vitit, do të mund të përfundojnë punimet. Në Qeveri konfirmojnë se nga ana kosovare po bëhen analiza rreth gjeologjisë së tokës, pikërisht në pjesën ku ndërtohet objekti kufitar, pasi ky vend i takon Kosovës.

"Megjithëse punimet janë nga fundi, shpresojmë se deri edhe pak muaj, pika kufitare të hapet. Është obligim i palës kosovare që të përfundojë me ndërtimin e objektit kufitare dhe rrugës në atë pjesë. Ndërsa ne, me hapjen e pikës kufitare, do të pastrojmë edhe shembjen e dheut në pjesën mbi fshatrat e Likovës e deri në kufi", thonë në Qeveri. Ankohen edhe banorët e fshatrave të Likovës. "Kemi shpresuar që kjo rrugë, ashtu siç ishte thënë, të përfundojë me kohë dhe të ishte hapur tani këtë vit. Por, duket se nuk do të hapet edhe gjatë kohë. Kjo është tallje me komunën

tonë, sepse për të udhëtuar në Kosovë, na duhet të shkojmë që në Bllacë, dhe pastaj të lidhemi me Gjilanin dhe qytetet tjera të Kosovës. Të bëjmë edhe rreth 150 kilometra më shumë vajtje-ardhje deri në Gjilan, ndërsa këndej nga Bellanoca kursejmë deri në dy orë", thotë Sead Zimberi nga fshatrat malor të Likovës.

Shqetësimin e njëjtë e ndan edhe Qazmedin Azizi. Ai për gazetën KOHA tregon nga fshati Sllupçan e deri në Gjilan nuk bëhet më shumë se 30 minuta rrugë, gjithmonë nëse do të ishte hapur pika kufitare. "Është e tmerrshme që për 60 kilometra rrugë, të bëjmë deri në 200 kilometra vajtje-ardhje për në Gjilan apo kudoqoftë tjetër në Kosovë. Kemi dhe familje, tregti... por si gjithmonë, premtimet nuk mbahen", thotë ai.

Ndryshe, marrëveshja konkrete për hapjen e pikës kufitare Bellanoc-Stançiq është nënshkruar në vitin 2013, nga ministrat e atëherëshëm të Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska e Maqedonisë dhe Bajram Rexhepi i Kosovës. Hapja solemne ishte planifikuar më 1 janar 2019, ndërsa ishte parashikuar të jetë pika e tretë kufitare mes Kosovës dhe Maqedonisë pas asaj në Elezhan-Bllacë dhe Jazhincë-Glloboçicë, por si pikë e parë kufitare e integruar mes dy shteteve, që do të thotë një kontroll për ata që kalojnë kufirin. Projekti për godinën kushton 1.2 milionë euro, ndërsa Ministria e Vetëqeverisjes Lokale e Maqedonisë së Veriut ka siguruar shumën e nevojshme për kofinancimin në vlerë prej 104 mijë euro.



• Veç kësaj, edhe rruga që çon drejt vendkalimit kufitar, nga fshati Sllupçan deri në Bellanoc, tashmë është në gjendje të mjerueshme. Gurë dhe dheu anash tashmë janë shembur në rrugë, ndërsa duket se asnjë institucion, qoftë lokal apo qendror, nuk kujdeset për pastrim

Biçikletat edhe pse vazhdimisht po përdoren si mjete transporti në Shkup, ata ende nuk e kanë hapësirën e mjaftueshme për lëvizje. Kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut pavarësisht se tenton ti përshtatet trendëve botërore me ndërtimin e shtigjeve për biçikleta, deri më tani e ka humbur luftën me veturat dhe automjetet tjera që shpeshherë i uzurpojnë hapësirat për çiklistë

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 25 mars - Kur janë në trotuar, i shajnë qytetarët. Kur zbresin në asfalt, i ofendojnë shoferët. Kjo është përditshmëria e një pjesë të banorëve të Çairit, të cilët e shfrytëzojnë biçikletën si mjet transporti. Në mungesë të shtigjeve për biçikleta, ata shpeshherë detyrohen ti pranojnë reagimet dhe vërejtjet e bashkëqytetarëve të tyre.

Filloreta Adema, e cila jeton në Fushë Tophane në Shkup, për gazetën KOHA thotë se një pjesë bukur të mirë të sfidave me të cilët ballafaqohet ajo dhe shokët e saj, e kanë edhe institucionet, në këtë rast Qyteti i Shkupit.


"Aspak nuk jam e kënaqur nga infrastruktura për biçikleta. Një mendim të tillë e ndajnë edhe kolegët tjetër që biçikletën e përdorin si mjet transporti për punë, për shëtitje apo për rekreacion. Jetoj në Komunën e Çairit. Për fat të keq, këndej nuk ka shtigje të përshtatshme për biçikleta. Paraprakisht është ndërnuar një korsi në lagjen Shkup-Veri. Por bëhet fjalë për një destinacion tepër të shkurt, që nuk na kryen punë fare. Megjithatë, edhe kjo pjesë e vogël shpeshherë është e bllokuar nga automjetet", thotë Filloreta. Derisa mungojnë shtigjet e standardizuara për biçikleta, edhe siguria në komunikacion është e rrezikuar. Kështu vlerëson gazetari Bekim Laçi, i cili shton se dy herë ka qenë dëshmitar kur çiklistët kanë pësuar në rrugët e Çairit.

"Njëri prej rasteve ndodhi në rrugën Xhon Kenedi, në afërsi të shkollës së mesme 'Cvetan Dimov' dhe tjetri në afërsi të urës së Bit Pazarit. Të njëjta i kam dokumentar me fotografi dhe xhiruar me celular. Më pas i kam postuar në profilin tim në Fejsbuk. Këto informacione mundën ti vërtetojnë edhe nga policia. Për këtë arsye, apelojmë se shtigjet për biçikleta janë siguri për neve dhe njëkohësisht jetë", shton Laçi.

Kultura e ulët në komunikacion dhe trafiku i ngarkuar nëpër rrugët e Shkupit, nuk paraqet problem që Dimitrije Aleksov, esnaf i Çarshisë së Shkupit, për më tepër se 70 vite ti ndahet biçikletës. "Dikush na jep përparësi kur e ngasim biçikletën, e

KUR VETURAT MBIZOTËROJNË RRUGËT E SHKUPIT


ÇIKLISTËT, "DELET E ZEZA" NË KOMUNIKACION



DIMITRIJE ALEKSOV

Dikur, kur mësonim ne, kultura e përgjithshme në qytetet, përfshi edhe atë në komunikacion, ishte ndryshe. Shoferët kishin sjellje tjetër. Tash shpesh ndodh që njerëzit të vrapojnë në mes të rrugës. Nuk dëshirojnë të presin askund. Jeta sot është dinamike. Nga shtëpia ime në mëhallën e Muhaxhirëve e deri në Çarshi ka më tepër se një kilometër. Në disa rrugë ka shtigje, në disa jo. Janë humbur

dikush jo. Varësisht prej njerëzve. Dikur, kur mësonim ne, kultura e përgjithshme në qytetet, përfshi edhe atë në komunikacion, ishte ndryshe. Shoferët kishin sjellje tjetër. Tash shpesh ndodh që njerëzit të vrapojnë në mes të rrugës. Nuk dëshirojnë të presin askund. Jeta sot është dinamike. Nga shtëpia ime në mëhallën e Muhaxhirëve e deri në Çarshi ka më tepër se një kilometër. Në disa rrugë ka shtigje, në disa jo. Janë humbur. Nëse ka shtigje më të mira, më shumë njerëz do ti shfrytëzonin biçikletat", thotë plaku 90 vjeçar, Dimitrije.




SENZHANA DOMAZETOVSKA

Shtigjet për biçikleta janë në gjendje më të mirë se sa kanë qenë para fillimit të projektit 'Shkupi Velo Qytet'. Mirëpo, shtigje nuk mund të hasen gjithandej. Ndërtimi i tyre është bërë vetëm në bulevardet kryesore. Por, siç është rasti me lagjen e Kisella Vodës në Jug të Shkupit, apo pjesën e Çairit dhe Butelit në Veri, nuk ka. As edhe në rrugët kryesore dhe as në ato anësore

Grupi më i njohur që angazhohet për plotësimin e të drejtave të çiklistëve në Shkup, pa dyshim është ai "Na toçak" (Në biçikletë). Ndonëse nuk janë të regjistruar si shoqatë, ky grup joformal që përbëhet nga aktivistë të ndryshëm qytetarë, duke filluar nga arkitektë, urbanistë, gazetarë e juristë, aktivistë merr pjesë në përpilimin e politikave të Qyteti të Shkupit për ndryshimin e infrastrukturës për biçikleta në kryeqytet.

Përfaqësuesja e këtij grupi, arkitektja Snezhana Domazetovska, kur e komenton çështjen e çiklistëve në



VALON SALIHU

Kemi ardhur me një pikë ku për dallim nga këmbësorët dhe çiklistët, një veturë ka privilegjin më të madh në komunikacion. Ky problem fatkeqësisht ekziston. Ne si administratë kemi ndërmarrë disa masa, siç janë vendosja e shtylla për ndarjen fizike të trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta. Mirëpo, ende nuk mund të arrijmë te pika që të gjithë duam ta shohim ku do të ketë trotuare dhe shtigje të lira

vendin tonë, pranon se pjesa Veriore e Shkupit nuk disponon me shtigje për biçikleta, ashtu siç është rasti në pjesët tjera të qytetit.

"Shtigjet për biçikleta janë në gjendje më të mirë se sa kanë qenë para fillimit të projektit 'Shkupi Velo Qytet'. Mirëpo, shtigje nuk mund të hasen gjithandej. Ndërtimi i tyre është bërë vetëm në bulevardet kryesore. Por, siç është rasti me lagjen e Kisella Vodës në Jug të Shkupit, apo pjesën e Çairit dhe Butelit në Veri, nuk ka. As edhe në rrugët kryesore dhe as në ato anësore. Kuptohet se gjithkund nuk mund

të ngritën shtigje për biçikleta, nuk e lejon hapësira. Mirëpo në ato vend ku mungojnë këto shtigje, në një farë mënyre duhet të stabilizohet komunikacioni, qoftë me ngritjen e rrugëve apo ngushtimin e rrugëve për automjete, respektivisht krijimin e hapësirave të sigurta për biçikleta", thotë për KOHA, Domazetovska. Nga shoqata joqeveritare "Shëndeti para profitit", e cila merret me problemet e përditshme urbane të qytetarëve, theksojnë se Shkupi, për dallim nga qytet tjera përreth dhe kryeqytetet në rajon, e ka vendndodhjen më të mirë që çiklistët dhe shoferët e automjeteve të jenë të barabartë në komunikacion. Jana Belçeva, aktiviste shumëvjeçare e shoqatës "Shëndeti para profitit", thotë se është koha të vendoset rend në komunikacion, gjegjësisht shtigjet për biçikleta, të njëjtat të lirohen për lëvizje dhe në këtë mënyrë të krijohet hapësirë për mjete jo të motorizuara, siç janë trotinetet dhe biçikletat.

"Mendoj se në Shkup duhet të përmirësohet kultura në komunikacion. Por, duhet të përmirësohet edhe puna e policisë rrugore sa i përket shqiptimit të gjobave për kaosin në rrugë. Në botë ekzistojnë disa kategori për çiklizëm të sigurt dhe kështu janë nivelizuar (kategorizuar) shtigjet për biçikleta në pesë grupe. Kësisoj, kategoria më e sigurt e shtigjeve është ajo kur prindër nuk ndjejnë frikë për sigurinë e fëmijëve. Organet përkatëse nuk duhet të tolerojnë uzurpimin e këtyre shtigjeve", tha Belçeva.

Zëdhënësi i Qytetit të Shkupit, Valon Salihu, ndërkohë deklaroi qasja e ish-administratës së qytetit, përfshi edhe politikën në nivel qendror, fatkeqësisht automjeteve u ka mundësuar një komoditet më të lartë, në krahasim me pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

"Kjo rezultoi me kaosin e madh që mbizotëron në rrugët e Shkupit. Tash kemi ardhur me një pikë ku për dallim nga këmbësorët dhe çiklistët, një veturë ka privilegjin më të madh në komunikacion. Ky problem fatkeqësisht ekziston. Ne si administratë kemi ndërmarrë disa masa, siç janë vendosja e shtylla për ndarjen fizike të trotuareve dhe shtigjeve për biçikleta. Mirëpo, ende nuk mund të arrijmë te pika që të gjithë duam ta shohim ku do të ketë trotuare dhe shtigje të lira", thotë Salihu.

(Me këtë shkrim, gazeta KOHA i bashkëngjitet fushatës nga interesi publik për ambientin jetësor më të mirë "Mos injoro! Reago!")

MBI 140 ÇIKLISTË NË 2018 JANË AKSIDENTUAR

Të dhënat e Sektorit për Punë të Brendshme në Shkup tregojnë se brenda vitit 2018, janë shkaktuar gjithsej 147 aksidente ku pjesëmarrës kanë qenë edhe çiklistë, apo 19 kanë përfunduar me lëndime të

renda trupore, ndërsa 128 të tjerë janë lënduar lehtë. Këtë vit, konkretisht vetëm në janar dhe shkurt, thonë nga policia e Shkupit, janë shkaktuar 11 aksidente.

Edhe pse më i lirë dhe më efikas, afaristët akoma shumë pake shfrytëzojnë arbitrazhin si një mundësi për të lehtësuar biznesbërjen

ARBITRAZHI NË BIZNES

KONTESTI ZGJIDHET ME MUAJ, JO ME VITE



klauzolën e arbitrazhin për të zgjidhur më shpejt dhe më efikas kontestet e ndryshme. Përvojat e shteteve të rajonit si Kroacia tregojnë se arbitrazhi i zgjidh shumicën e kontesteve ekonomike, siç janë ndërtimi i rrugëve, infrastruktura dhe të ngjashme.

Vlerësohet se tradita e gjatë e punës dhe ekzistencës së gjykatës së arbitrazhit ka rolin kryesor pse Kroacia ka rezultate më të mira në këtë drejtim se i gjithë rajoni bashkërisht. Ish kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike në Kroaci, Mihajlo Dika, thotë se në periudhën e kaluar apo në mbi 20 vite janë zgjidhur konteste të vlefshme më shumë se 700 milionë euro, edhe atë kryesisht në sferën e ndërtimitarise. Ai sugjeron zbatimin më të madh të këtij lloji të zgjidhjes së kontesteve, edhe promovimin më të madh ndër kompanitë, drejtorët, menaxherët, shërbimet juridike, komercialistët... që duhet të kuptojnë përparësitë e arbitrazhit në vend të kompetencës së gjykatës shtetërore. "Mendon mirë, përllogaritni, bëhuni racional dhe zgjidhni arbitrazhin", porositi eksperti Dika.

Ndryshe, vlerësohet se Maqedonia vështirë mund të arrijë sukseset e Rumanisë me 20 milionë banorë, me numër të madh të investimeve të huaja, dhe rritje të madhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto që në vitet e kaluara ka zgjidhur bile 1600 konteste të arbitrazhit brenda një viti, apo dy herë më pak konteste biznesi në raport me gjykatat e rregullta. Megjithatë, intenca është që Maqedonia të zgjidhë së paku 100 konteste në vit.

gjyqësore. Megjithatë, kompanitë gjatë vendosjes pro apo kundër kësaj mënyrë të zgjidhjes së çështjeve të ndryshme, kanë parasysh se përmes arbitrazhit nuk ekziston mundësia e përsëritjes së procedurës apo e drejta për ankesë për shkak se vendimi i miratuar është i plotfuqishëm.

Nga Gjykata e Arbitrazhit thonë se në mesatare, kohëzgjatja e një procedure vitin e kaluar ishte 186 ditë apo afër gjashtë muaj, dhe paraqet një avancim në raport me 7.5 muaj në vitin 2017. Nga ana tjetër, kontestet në gjykatat e rregullta mund të zgjasin edhe disa vite. Bile, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 90 për qind e kontesteve përfundojnë në arbitrazh, ndërsa në Gjermani kjo përqindje arrin në 60. Kompanitë në këto shtete, si veçorinë më pozitive të arbitrazhit e theksojnë faktin se vendimi i miratuar është i plotfuqishëm, nuk ka kohë për ankesa, ndërsa e tërë procedura është fleksibile, madje ka mundësi të zgjidhen arbitrat që do të vendosin për kontestin.

"Trendet botërore tregojnë se

arbitrazhi është i pakontestueshëm tek komunitet i biznesit, si mënyrë më e preferuar për zgjidhjen e kontesteve afariste. Këtë e konfirmojnë edhe analiza e universitetit 'Kuin Meri' nga Londra dhe shoqëria e avokatëve 'Vajt Kejs', e realizuar ndër shërbimet juridike të kompanive, arbitrave dhe avokatëve. Njëherësh, kur bëhet fjalë për kontestet me elemente ndërkombëtare, të dhënat udhëzojnë se arbitrazhi paraqet metodë të preferuar për zgjidhjen e kontesteve tek 97 për qind e subjekteve, thotë sekretarja e Gjykatës së Arbitrazhit, Tatjana Shterjova.

Sipas saj, në dy vitet e kaluara, 54 për qind e procedurave pranë Gjykatës së Arbitrazhit kanë qenë kontestet me elemente ndërkombëtare, ndërsa 46 për qind kanë konteste të brendshme.

Kohë më parë, nga Gjykata e arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë kanë bërë thirrje që edhe kompanitë shtetërore, si dhe komunat ngjashëm me një pjesë të bizneseve që kanë filluar të përdorin këtë mundësi, të vendosin

Bekteshi pret rritje rekorde të investimeve

Kërçovë, 25 mars - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, në intervistë për televizionin lokal "Curra" foli për situatën ekonomike në vend, investimet e drejtpërdrejta të huaja dhe politikën që i krijon Qeveria për të rritur dhe të ndikimin e stabilitetit të shtetit në nivel të investimeve - ekzistuese dhe potenciale. Bekteshi tha se hyrja në NATO e siguron stabilitetin dhe sigurinë e shtetit, gjë që kontribuoi për rritje rekorde të investimeve prej mbi 624 milionë euro, prej të cilave pjesa më e madhe janë nga BE-ja, SHBA-ja dhe Turqia, që i hap dyert për vende të reja dhe mirë të paguara të punës, rritje të standardit të jetesës dhe rritje të shkallëzuar ekonomike. Ai theksoi se për këtë vit presim vlerë rekorde të re të investimeve, rreth një miliardë euro dhe mbi 30 kompani të mëdha. Ai foli për programin për konkurrencë, inovacione dhe sipërmarrje, për rritjen e përkrahjes për kompanitë në vitin 2018, respektivisht biznes subjektet kanë pasur në disponim 47 milionë denarë dhe me to është siguruar përkrahje të zhvillimit të mbi 150 ndërmarrjeve. Këtë vit ndërmarrjet kanë madje diçka mbi 53 milionë denarë, të ndara në pjesë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, për të cilat veçmë janë aktive disa masa, një pjesë për politikën industriale, ku përkrahje do të marrin subjektet nga industria përpunuese, një pjesë për shoqërim klaster dhe një pjesë për punë shoqërore-përgjegjëse, tha ministri Bekteshi. Në vazhdim ai foli për trendin e rritjes të BPV, i cili është pozitiv, që, sipas tij, konfirmon se politikën ekonomike qeveritare janë të vendosura në mënyrë të rregullt dhe se masat mirë të pararenduar në të gjitha sektorët i japin rezultatet e pritura.

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 25 mars - Procedura të shpejta dhe cilësore si dhe harxhime të ulëta janë vetëm disa nga përparësitë pse për zgjidhjen e kontesteve në ndryshme në biznes preferohet arbitrazhi në vend të procedurës standarde gjyqësore. Thënë ndryshe, arbitrazhi është njëra ndër metodat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, në të cilën mosmarrëveshja zgjidhet nga një palë e tretë e pavarur përmes një vendimi detyruar për palët.

Mirëpo, edhe pse më i lirë dhe më efikas, afaristët në shtet akoma shumë pak e shfrytëzojnë një mundësi të tillë për të lehtësuar biznes bërjen. Dallimi midis procedurës në gjykatë dhe arbitrazhit është se, në të parën - procedura mund të zgjasë deri më 3 apo 3 vjet e gjysmë, ndërsa në të dytën - mund të zgjidhet problemi për tre deri në gjashtë muaj. Mirëpo, përkundër përfitimeve të shumta në kohë dhe të holla për të gjithë, në mesatare në shtet në vit zgjidhen vetëm nga 10 konteste përmes arbitrazhit, ndërsa prej vitit 1993 e kënde, kur një trup i tillë është vendosur pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë, janë zgjidhur pak më shumë se 300 konteste.

Vlerësohet se shkaqet për shfrytëzimin e dobët të shërbimeve të tyre nga ana e afaristëve, qëndrojnë në informimin e pamjaftueshëm të kompanive dhe avokatëve, si dhe vendosja si zakonisht e klauzolës në marrëveshjet e ndryshme se kontestet zgjidhen përmes rrugës

Maqedonia e Veriut kryeson me Nënkomitetin e bujqësisë të CEFTA-s



Shkup, 25 mars - Republika e Maqedonisë së Veriut sivjet do të jetë kryesues me Nënkomitetin për bujqësi dhe fushën sanitare dhe fitosanitare. Qëllimi është harmonizimi i certifikatave sanitare dhe fitosanitare si do të lehtësohet tregtia midis vendeve të CEFTA-s. Këtë e theksoi drejtori i Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari, Zoran Atanasov, i cili dje ka mbajtur takim me grupin ekspert ad hok për shkëmbimin e informacioneve në fushën e çështjeve sanitare dhe fitosanitare. "Për mbrojtjen gjendja është e keqe sepse ka vonesa në kufi, përplasje të panevojshme me kërkesë të dokumenteve, kontrollove të panevojshme nga

shërbimet e inspektimit të kufijve, dhe shumë procedura të ngatërruara në import dhe eksport të punëve të vendeve të CEFTA-s. Me vendosjen e shkëmbimit elektronik të të dhënave e gjithë kjo do të duhej të minimizohet dhe tregtia të lehtësohet", tha Atanasov. Ai theksoi se me harmonizimin e certifikatave sanitare dhe fitosanitare do të mundësohet bashkëpunim korrekt dhe efikas dhe lehtësimi i vetë procedurave gjatë importit dhe eksportit, por edhe do të shkurtohet koha e vonesës në kufi. "Me këtë proces duhet të ulen shpenzimet e kompanive gjatë importit dhe eksportit, ndërsa në të njëjtën kohë të sigurohet

import i ushqimit të sigurt për njerëzit dhe kafshët. Zbatimi i procedurës megjithatë varet nga faktorë të tjerë, sepse CEFTA ndërkohë shpall edhe tender për shtëpi informative e cila duhet të gjithë ato punë t'i vendosë në procedurë, gjegjësisht në implementim. Të dhënat që do të shkëmbehen më mënyrë elektronike do ta lehtësojnë procesin e përpunimit dhe mbledhjes së të dhënave, që të mundet të bëhet vlerësimi i duhur i rrezikut", u shpreh Atanasov. Ai theksoi se deri më tani janë mbajtur dy takime, megjithatë nuk ka pasur rezultate dhe se shpreson se gjatë kryesimit tonë sivjet çështja përfundimisht do të mbyllet.

PAS DËMTIMEVE DHE VJEDHJEVE TË MBUROJAVE

FILLON VENDOSJA E TELIT MBROJTËS

Në Pollog, viteve të fundit numri i aksidenteve të shkaktuara nga kafshët lëviz diku nga 100 deri në 120, aksidente që kanë ndodhur në autostradë. Rastet më të shpeshta janë vjedhjet e telave dhe shitja e tyre, por nuk janë të pakta edhe rastet kur bujqit për të arritur më lehtë deri tek arat e tyre, dëmtojnë telat mbrojtës së autostradës dhe kjo ndodh në tërë autostradën Shkup-Tetovë-Gostivar



dekadën e fundit, në autostradën "Nënë Terezë", kjo dukuri përsëritet dhe pasiguria është e pranishme çdo ditë, ngase ka shumë kafshë që kanë qasje të lehtë në autostradë.

"Ndërmarrja publike shtetërore 'Rrugët e Maqedonisë' ka filluar me sanimin e mburojave mbrojtëse përgjatë autostradës Gostivar-Shkup-Tetovë, të cilat në masë të madhe janë dëmtuar gjatë periudhës së dimrit, por edhe tani në pranverë. Me këtë rast, janë duke u sanuar mburojat mbrojtëse në mbi 10 mijë metra rrugë, ndërsa në ato pjesë ku këto mburoja janë të dëmtuara në masë të madhe, të njëjtat zëvendësohen me të reja", deklaroi Gajur Kadriu, drejtor i Ndërmarrjes publike shtetërore "Rrugët e Maqedonisë".

Gjithashtu, Ndërmarrja publike shtetërore "Rrugët e Maqedonisë" tani në muajt e pranverës ka

ndërmarrë edhe një aksion me karakter ekologjik, ku punonjësit e kësaj ndërmarrje po punojnë në drejtim të grumbullimit të mbeturinave në rrugët shtetërore, ndërsa pritet që të angazhohen edhe pjesëtarët e Armatës. Në ndërkohë, drejtori Kadriu ka njoftuar se shumë shpejtë do të ketë disa rikonstruime të rrugëve në Pollog.

"Së shpejti, Ndërmarrja publike 'Rrugët e Maqedonisë' do të fillojë edhe me rikonstruimin e rrugëve në rajonin e Pollogut, ku prioritet do të jetë rikonsultimi i rrugës nga stadium i qytetit deri në fshatin Poroj, ndërsa në të ardhmen pritet që të fillojnë punimet edhe për rikonstruimin e rrugës që shpion nga qyteti i Tetovës për në Kodrën e Deillit, ku do të bëhet një rikonstruim i tërësishëm i kësaj rruge", deklaroi Kadriu. Në Pollog, viteve të fundit numri i aksidenteve të

shkaktuara nga kafshët, lëviz diku nga 100 deri në 120, aksidente që kanë ndodhur në autostradë. Rastet më të shpeshta janë vjedhjet e telave dhe shitja e tyre, por nuk janë të pakta edhe rastet kur bujqit për të arritur më lehtë deri tek arat e tyre, dëmtojnë telat mbrojtës të autostradës, dhe kjo ndodh në tërë autostradën prej Shkupi-Tetovë-Gostivar. Edhe nga Policia edhe nga ndërmarrja "Rrugët e Maqedonisë" apelojnë që qytetarët të jenë më të kujdesshëm që të mos dëmtojnë këto mburoja dhe të kujdesen për të njëjtat. Në ndërkohë, sipas policisë së Tetovës së këndejmi sa më parë duhet të merren masa dhe të bëhet diçka në këtë drejtim pasi që gjatë periudhës së ardhshme, në mënyrë enorme do të shohet numri i veturave në komunikacion me ardhjen e sezonit veror.

Prej sot më ftohtë, rënie e temperaturave për 10 gradë

Shkup, 25 mars - Në ndikimin e masës së ndjeshme të të ftohtit, prej sot deri te enjten do të ketë rritje të vranësirave, në pjesët perëndimore dhe jugore me reshje të dobëta lokale të shiut, ndërsa na male borë. Drejtorja për Punë Hidrometeorologjike ka paralajmëruar se do të fryjë erë e përforcuar veriore deri në mesatare, ndërsa temperatura e ditës do të ulet për rreth dhjetë gradë në krahasim me të sotmen. Nga e premtja temperaturat e mëngjesit në vend do të zbresin edhe nën zero, ndërsa gjatë ditës do të jenë në rritje.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 25 mars - Këtyre ditëve, kanë filluar sërish punimet për vendosjen dhe rregullimi i telit mbrojtës përgjatë autostradës Shkup-Tetovë-Gostivar. Këto punime zhvillohen pothuajse çdo vit nga ana e Ndërmarrjes publike shtetërore "Rrugët e Maqedonisë" pasi që teli mbrojtës ose vidhet ose dëmtohet përgjatë autostradës. Kryesisht, vjedhja bëhet edhe për përfitime materiale, por edhe nga ana e personave, të cilët largojnë të njëjtin për të patur qasje deri tek pronat e tyre bujqësore. Por kjo e rrit rrezikun për qasje më të lehtë dhe të pakontrolluar të kafshëve të ndryshme në autostradë. Pikërisht,

Qendra e re klinike mund të fillojë deri në fund të vitit

Shkup, 25 mars - Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, dje deklaroi se pret në afatet e parashikuara të përfundojnë të gjitha procedurat dhe se ka shanse serioze themelet e qendrës së re klinike të vendosen deri në fund të vitit. "Në këtë moment rishikohet studimi i fizibilitetit për lokacionin grinfield. Tashmë janë mbledhur të dhënat e drejtorëve të klinikave për atë si dhe çka supozojnë dhe duan të implementojnë në repartet e tyre, ndërsa në kuptim të sallave të reja operative, numrit të krevatëve, sipas numrit të pacientëve të cilat trajtohen viteve të fundit. Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe të gjitha punëve tjera përgatitëse rreth tokës presim të bëhet gati në muajin maj dhe pastaj të jemi të gatshëm edhe zyrtarisht ta fillojmë procedurën", tha Filipçe, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve pas konferencës për shtyp me rastin e shënimit të Ditës botërore për luftë kundër tuberkulozit. Ai potencoi se rishikimi zgjat dhe punën aktuale në lidhje me tokën në komunën Gjoçe Petrov edhe këtë periudhë e shfrytëzojnë që të përgatiten për të gjitha aktivitetet.

Shkolla e mesme teknike bëhet me fabrikë

Gostivar, 25 mars - Shkolla e mesme teknike komunale në Gostivar është një ndër shkollat e rralla që në kuadër të saj do të ketë edhe fabrikë. Fabrika "Megametal 2018" do të sigurojë që nxënësit në një vend të njoftohen dhe të shfrytëzojnë mjete dhe teknologji modern për dizajn dhe prodhim. Koordinator i projektit, profesor Ekrem Miftari thotë se kjo fabrikë është rezultat i një pune të vështirë njëvjeçare të profesorëve por që me përkushtim mund të arrihet gjithçka. "Mega-

metal 2018 është rezultat i një pune njëvjeçare të vështirë e shumë profesorëve, nxënësve, udhëheqësisë së shkollës dhe e partner kompanisë. Sot ne në shkollë kemi një kompani me organet e veta menaxhuese, legjislacion përkatës dhe më e rëndësishme, me makinën CNC dhe pajisje tjera me të cilat ne mund të prodhojmë, të edukojmë dhe të jemi inovativë", tha Miftari. Kryetari i Komunës së Gostivarit, Arben Taravari është shprehur se fillimisht kur ka filluar të realizohet

projekti, është dukur një mision i rëndë, por në fund kjo shkollë tashmë është shembull se si duhet të jenë shkollat që kanë drejtime teknike dhe nxënësit aftësohen për tregun e punës. Për drejtorin e shkollës kjo është një meritë e të gjithëve që përkrahën dhe e iniciatorëve, por edhe e shkollës, ngase nxënësit përgatiten në mënyrë profesionale për në të ardhmen. Shkolla e mesme teknike komunale në Gostivar aplikoi dhe mori grant në kuadër të

Projektit për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit, të zbatuar përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe financuar nga një hua e Bankës Botërore. Në këtë kompani do të mund të prehen metalet deri në 30 milimetra të trashë, ku do të prodhohen artikuj metalikë, si pajisje urbane, kazanë për mbeturina, llamba, sende shtëpiake, pajisje ndërtimi, pajisje reklamuese dhe punime me porosi nga kompani të interesuara. (U.H)

Blegtorët nuk presim probleme me shitjen e qengjave

Shkup, 25 mars - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe Qeveria e përcjellin gjendjen me blerjen e qengjit. Deri në fund të qershorit Agjencia për ushqim dhe veterinarin do të përfundojë me regjistrimin dhe do të dalë me numër të saktë të deleve dhe dhive, që është me rëndësi për definim preciz të politikave në afat të mesëm, por edhe të gjatë, si dhe

për shpërndarje të drejtë të subvencioneve për blegtorin. Këtë dje e theksoi ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Luçjo Nikollovski, i cili së bashku me këshilltaren e posaçme për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave të kryeministrit Lençe Nikollovski dhe ekipi i MBPEU, mbajtën mbledhje pune me blerësit, përfaqësuesit e thertoreve dhe ekspor-

tuesit e qengjave.

Në mbledhje, siç kumtoi MBPEU, është biseduar për gjendjen aktuale me blerjen e qengjave dhe për eksportin. Nikollovski në mbledhje edhe një herë potencoi se Qeveria nuk do të lejojë që blegtorët rritës së deleve nga prodhimi i tyre të bëjnë humbje. Nikollovski theksoi se MBPEU në mënyrë të vazhdueshme punon në vendo-

sjen e kontakteve me tregje të reja për eksport të mishit të qengjit dhe se tashmë vijojnë bisedime për marrje të kuotës dhe eksportit të mishit të qengjit në tregun turk. Nga ana e blerësve, siç është theksuar, u potencua se nuk presin probleme me plasmanin dhe se qengji në tërësi do të blihet.

Sipas të dhënave nga AUV, në dhjetor të vitit 2018 nga shteti ynë

janë ekspozuar 2897 qengja apo sasi në kilogramë 33.509 kilogramë. Këtë vit janë eksportuar 16.533 kilogramë apo sasi në kilogramë 173.427 kilogramë. Gjatë ditës së sotme (e martë) në MBPEU do të mbahet takim pune me përfaqësues të shoqatave të rritësve të deleve, në të cilën do të bisedohet gjithashtu për gjendjen e blerjes së qengjave.

HULUMTIM I UNIONIT TË NXËNËSVE SHQIPTARË

NGACMIMET NË SHKOLLA SHËNOJNË RITJE

Rreth 44 për qind e nxënësve të anketuar janë shprehur se kanë qenë pre e ngacmimit dhe kjo tendencë shkon në rritje. Gjithashtu, 79 për qind prej tyre vlerësojnë se më i pranishëm është ngacmimi i padukshëm, ose psikik edhe atë më shumë në relacionin mesimdhënës-nxënës, por edhe midis vetë nxënësve

Shkup, 25 mars - Ndasitë e thella në aspektin social, komunikimi i tepërt në rrjetet sociale si dhe mungesa e kontrollit nga ana e prindërve, janë shkaqet kryesore që kanë çuar në rritjen e ngacmimeve si dukuri, që në vete përmban fyerjen dhe kërcënimet në formë të vazhdueshme në mesin e të rinjve në Maqedoninë e Veriut. Në bazë të një hulumtimi të realizuar nga Unioni i Nxënësve Shqiptarë të shkollave të mesme në Maqedoninë e Veriut, ka dalë në pah se pothuajse çdo i dyti nxënës ka qenë pre e ngacmimit.

"Në bazë të hulumtimit që kemi realizuar duke anketuar rreth 2 mijë nxënës të shkollave të mesme nga mosha 15 deri në moshën 19 vjeçare, 44 për qind e tyre janë shprehur se kanë qenë pre e ngacmimit dhe sipas të gjitha gjasave, kjo tendencë shkon në rritje. Gjithashtu, mund të themi se ngacmimi shndërrohet në një sjellje rutinë për nxënësit. 79% e nxënësve të anketuar vlerësojnë se më i pranishëm është ngacmimi i padukshëm, ose psikik edhe atë më shumë në relacionin më-



simdhënës-nxënës, por edhe midis vetë nxënësve", ka bërë të ditur për Radion Evropa e Lirë, Blendi Hodai kryetar i Unionit të Nxënësve të shkollave të mesme të Republikës së Maqedonisë, duke shtuar se kjo dukuri paraqet rrezik për ardhmërinë e nxënësve të cilët më vonë gjatë jetës mund të përballen me pasoja serioze, sidomos në aspektin emocional.

Por, sociologët e shkollave problemin e kanë adresuar në mungesën e komunikimit në relacionin prind nxënës dhe lirinë e tepërt që ua japin prindërit fëmijëve të tyre në raport me komunikimin në rrjetet sociale, prej ku në raste të shumta buron një kulturë e vrazhdë e komunikimit. Ndërkaq, Naser Miftari profesor në gjimnazin e Shkupit "Zef Lush Marku", për Radion Evropa e Lirë, thotë se ngacmimi shfaqet si pasojë e përdorimit të pakontrolluar të rrjeteve sociale. Miftari thotë se mediat duhet të luajnë një rol sensibilizues veçanërisht për vetëdijesimin e prindërve sa i përket ngacmimit mes të rinjve. "Mendoj se mediet mund të kontribuojnë shumë në të mirë ndaj gjithë kësaj që ne e quajmë luftë kundër ngacmimit, por duhet cekur se në shumë raste këto medime vetë paraqesin burim edhe atë të fuqishëm të bulizmit mes

nxënësve. Do të thotë ngritja e vetëdijes është e patjetërsueshme për ngritjen e vetëdijes nga pasojat e shfaqjes së kësaj dukurie. "Duhet të punohet më shumë në ndërgjegjësimin e mbi çfarë është ngacmimi, si ndikon tek fëmijët, cilat janë pasojat e tij dhe si të parandalohet", thotë Naser Miftari. Nga Drejtoria e Arsimit në Maqedoninë e Veriut thonë se kanë mbështetur shumë projekte për ndërgjegjësimin e nxënësve, mesimdhënësve, por edhe prindërve për detektimin e kësaj dukurie duke theksuar se për të pasur sukses lufta kundër ngacmimit, duhet një bashkëpunim i fuqishëm mes këtyre tri hallkave.

Ndërkaq, Ilia Acevski, sociolog, thotë se institucionet arsimore duhet t'i qasen me shumë seriozitet këtij problemi. Acevski thekson se një gjë duhet kuptuar se "fjalët godasin" po aq sa lëndon goditja fizike, madje edhe më shumë.

"Ngacmimi në moshën më të re transferohet në injorim, në mungesë të kulturës elementare të komunikimit. Kjo dukuri duhet trajtuar me shumë profesionalizëm nga ana e institucioneve arsimore sepse pasojat barten në zhvillimin e mëtejshëm të individit", thotë Acevski.

(REL)

Vjet, 243 doktorë shkencash

Shkup, 25 mars - Profesionin doktor i shkencave në vitin 2018 ka arritur 243 persona, që është më shumë se 16.3 për qind në krahasim me vitin 2017. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, më shumë (34.9) persona kanë doktoruar në fushën e shkencave shoqërore, më pas në shkencat mjekësore (28.8) edhe në shkencat humane (18.5). Të tjerët kanë doktoruar në fushën e teknikës dhe teknologjisë, matematikat natyrore dhe shkencave bioteknike. Më i madh është numri i grave që kanë doktoruar vitin e kaluar, 141 ose 58 për qind nga numri i përgjithshëm i personave që kanë doktoruar në vitin 2018. Përqindja më e madhe (28.8) nga numri i përgjithshëm profesionin e tyre e kryejnë në veprimtarinë arsimore.

Padi për dilerin e kokainës nga Haraçina

Shkup, 25 mars - Prokuroria Themelore Publike Shkup deri te Gjykata Themelore Shkupi 1 ka ngritë akuzë kundër një 20 vjeçari nga Haraçina e Shkupit, i dyshuar për veprën penale "prodhimtari e palejuar dhe lëshim në qarkullim e drogave narkotike, substancave psiko-trope dhe prekursorëve". I akuzuari në shtëpinë e tij në Haraçinë ilegalisht për shkak të shitjes ka mbajtur gjithsej 128,63 gramë kokainë. Gjatë bastisjes nga personat zyrtar te ai është gjetur edhe një peshore digjitale si dhe para në vlerë totale prej 155.550 denarëve dhe 100 euro. "Duke pasur parasysh atë se



edhe më tutje ekziston frikë e arsyeshme se i akuzuari mund të arratiset ose të përsërisë veprën penale për të cilën ngarkohet, prokurori kompetent publik deri te Gjykata Themelore Shkupi 1 Shkup ka dorëzuar edhe propozim për vazhdimin e masës së përcaktuar të paraburgimit për personin e akuzuar", kumtoi PPRM-ja. (O.Xh)

KRONIKË

Gostivar, shtatë të lënduar në aksident

Të dielën rreth orës 13 e 15 në rrugën magjistrale Gostivar-Kërçovë, rreth 500 metra afër kthesës për në Mavrovë, ka ndodhur aksident trafiku ku janë përfshirë dy vetura. Sipas njoftimit të policisë, njëra veturë e markës BMW është drejtuar nga E.M 41 vjeçare nga Gostivari dhe veturës Pasat me targa të Tetovës e drejtuar nga 68 vjeçari D.A nga Tetova. Në këtë aksident, lëndime ka marrë bashkudhëtarja në BMW. Pas marrjes së ndihmës së parë në Spitalin e Gostivarit, ajo është dërguar si rast urgjent në Klinikat e Shkupit. Në aksident po ashtu lëndime kanë marrë edhe gjashtë udhëtarë të tjerë në dy veturat, të cilët pas marrjes së ndihmës së parë janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Aksidentohet rëndë një fëmijë 11 vjeçar

Të dielën rreth orës 12 e 45 minuta në rrugën rajonale Ratajë-Zhelinë, gjegjësisht në fshatin Shemshovë, veturë e markës Fiat Punto e drejtuar nga S.M 48 vjeçar, ka aksidentuar një fëmijë 11 vjeçar nga fshati Shemshovë, i cili ka qenë duke drejtuar biçikletën. 11 vjeçari është dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin Klinik të Tetovës dhe më pas është dërguar në Klinikat e Shkupit, kurse policia punon në zbardhjen e plotë të rastit.

Gostivar, një 22 vjeçar lëndon policin

Të dielën mbrëma rreth orës 23 e 30 minuta në Gostivar, duke zhvilluar aktivitete në komunikacion, pjesëtarët e policisë kanë ndaluar veturën Ford Fokus me targa të Gostivarit të drejtuar nga 22 vjeçari S.K, ku ka patur edhe dy persona tjerë. Pas ndalimit, vozitësi menjëherë e ka nisur sërish veturën me shpejtësi, përderisa dera e bashkudhëtarit ka qenë e hapur dhe ka goditur një pjesëtarë të policisë. Menjëherë vozitësi është arrestuar dhe mbajtur në Stacionin policor në Gostivar për procedurë të mëtejshme.

Digjen pyjet në Likovë dhe Kumanovë

Ekipe të filialit të Kumanovës së "Pyjeve të Maqedonisë", në mëngjes me dy ekipe të të punësuarve po tentojnë që ta lokalizojnë zjarrin i cili shpërtheu dje pasdite në Likovë, të fshatrat Runicë, Dumanovcë, Bellanoc dhe Brezë. Nga zjarri janë kapluar kashta dhe pyjet e ulëta. "Ka qasje të vështirësuar, po tentojmë që ta lokalizojmë zjarrin. Janë njoftuar edhe shërbimet kompetente", deklaroi drejtori i filialit të Kumanovës, Luan Bajrami. Dje, ka intervenuar edhe një ekip i njësitit zjarrfikës me cisternë. Dje digjej edhe bari në fshatin Suv Ora, informojnë sot nga QRMK Kumanovë. Prej atje shtojnë se ka intervenuar ekip i ekonomisë pyjore. Edhe atje digjet pylli, ndërsa terreni është i pakapshëm. Zjarri ende nuk është aktiv, theksohet në kumtesën e QRMK Kumanovë.

(U.H)

"Ballkanizimi" i BE-së është i rrezikshëm



Nga
Ivajlo DITCHEV

Rajoni i Ballkanit është bërë sinonim i grindjeve dhe përçarjeve të pafundme. Kombet e reja dolën nga Perandoria Osmane dhe Austro-Hungaria falë ndërhyrjes së fuqive të jashtme. Si rezultat, ata vuajtën jo vetëm nga zhvillimi më i ulët ekonomik dhe social, por edhe nga mungesa e elitave të vërteta, elitave të përligjura. Politikanët e këtyre vendeve rrallë përfaqësonin interesat e popujve të tyre, në të shumtën e herëve ata vinin "prej askundi" dhe përpiqeshin të konsolidonin pozitën e tyre në vendet përkatëse.

Burimi i tyre kryesor ishte përkarhja që ata merrnin nga fuqitë e mëdha. Në këtë kontekst, rumunët ishin mbrojtësit e interesave të Francës në rajon, serbët dhe bullgarët konkurronin për dashurinë e "Nënës Rusi", grekët dhe turqit i kishin varur shpresat te Britania e Madhe, kroatët dhe boshnjakët te Austria. Në fund të Luftës së Ftohtë, rajoni kishte ndoshta përqendrimin më të lartë të kufijve për kilometër katror: midis NATO-s në jug dhe Paktit të Varshavës në veri, midis Jugosllavisë pa bllok, Greqisë që ishte anëtare e BE-së dhe vendeve të Evropës Lindore të COMECON (Këshilli për Ndihmën Ekonomike Reciproke), midis Bullgarisë pro-ruse dhe Rumanisë së Çausheskut, e cila ishte distancuar nga Bashkimi Sovjetik.

Shqipëria madje njëherë u bë edhe "kliente" e Kinës së largët deri sa më vonë arriti në përfundimin se lideri kinez, Deng Xiaoping, sikurse edhe Nikita Hrushovi, e kishte tradhtuar komunizmin. Si rezultat, Shqipëria vendosi të qëndronte e vetme kundër pjesës tjetër të botës. Konfliktet ndërmjet "sponsorëve" gjeopolitikë - të mbartura në këto nivele miniaturash - çuan në tensione rajonale dhe madje edhe luftëra. Cili ishte funksioni i një fragmentimi të tillë absurd që e pengoi rajonin të bëhej një hapësirë përbashkët ekonomike e begatë? Ai i jepte përligje politike elitave lokale që luftonin njëra-tjetrën.

PÛRKRAHJA E FUQIVE GLOBALE

Le ta shohim BE-në e sotme nga kjo perspektivë. Debatet midis Të Majtës dhe Të Djathtës, midis konservatorëve dhe liberalëve, duket se kanë dalë në plan të dytë, për shkak të përplasjes së koordinatave gjeopolitike globale. Elitat kombëtare kanë filluar të orientohen te fuqitë globale, sikurse në rastin e Ballkanit, në shekullin e njëzetë. Por sot mbështetja e tyre është e paqëndrueshme dhe e ndryshueshme - ndryshe nga epoka e

Luftës së Ftohtë. Distancimi nga Evropa i SHBA-së nën udhëheqjen e Obamës është kthyer tani, në kohën e Trump-it, në një refuzim të hapur. Kjo e ka detyruar Francën dhe Gjermaninë të bëjnë plane për autonomi të Evropës në fushën e sigurisë. Të tjerë, si Polonia, qëndrojnë të vendosur pas Shteteve të Bashkuara. Falë mbështetjes amerikane, Varshava ndihet edhe më e fortë në pozitën e saj anti-evropiane, për të cilën Komisioni i BE-së ka nisur një procedurë sanksionesh sipas nenit 7. Vizita e Presidentit të SHBA-së në Varshavë ishte padyshim edhe një shpërblim simbolik për populistët polakë. Kështu, një fuqi botërore përfshihet në konflikte brenda BE-së, që ka çuar në një seri ndarjesh të brendshme. Një shembull për këtë është projekti i Steve Bannon-it për të mobilizuar një "internacionale" kundër BE-së, mbi bazën e ideologjisë amerikane të së djathtës alternative (Alt-Right).

FLIRTIMI HAPUR ME PERANDORINË E PUTINIT

Edhe më tronditëse është flirtimi i hapur me mbretërinë e Putinit. Nga Italia në Estoni, partitë e djathta populiste dhe ekstremiste rivalizojnë me BE-në duke shfaqur haptazi afërsinë e tyre të veçanta me Moskën. Nga Bull-

garia në Letoni, ish-komunistët marrin e japin me miqësi dhe nostalgji komuniste. Disa kundërshtojnë sanksionet e vendosura nga Perëndimi kundër Rusisë pas aneksimit të Krimës, të tjerë shpresojnë të përfitojnë gaz me çmim të ulët ose të ndërtojnë centrale bërthamore. Për të tjerë, si liderja e së djathtës franceze, Marine Le Pen, si Matteo Salvini në Itali ose Volen Siderov në Bullgari, ndihma financiare nga Moskë është tashmë e dëshmuar. Ombrellat amerikane dhe ruse ngjasojnë me njëra-tjetrën në disa pika, por nuk janë njësoj. Për shembull, do të ishte e vështirë të imagjinohej që populistët polakë të mbështesnin Putinin apo që socialistët bullgarë të mbështesnin Trumpin, megjithëse partitë përkatëse kanë ideologji të ngjashme ksenofobike, konservatore dhe proteksioniste. Por të gjitha "klientelat" politike të fuqive të mëdha kanë një gjë të përbashkët: Në përpjekjet e tyre për të dalë fitues ndaj rivalëve të tyre evropianë, ata mbështeten nga një "sponsor" i huaj. Kjo është pikërisht ajo që vendet e Ballkanit kanë bërë për më shumë se një shekull. Lojtari i ri "global" është Kina. Kjo fuqi në rritje po depërton në Zonën Ekonomike Evropiane - jo vetëm përmes mallrave me çmim të ulët që shtyjnë prodhuesit vendorë

Lojtari i ri "global" është Kina. Kjo fuqi në rritje po depërton në Zonën Ekonomike Evropiane - jo vetëm përmes mallrave me çmim të ulët që shtyjnë prodhuesit vendorë nga tregu, por edhe nëpërmjet investimeve agresive të subvencionuara nga shteti. Kulmi i tyre është projekti faraonik i Rrugës së Re të Mëndafshit



nga tregu, por edhe nëpërmjet investimeve agresive të subvencionuara nga shteti. Kulmi i tyre është projekti faraonik i Rrugës së Re të Mëndafshit. Komisioni i BE-së po përpiqet ta mbajë nën kontroll përhapjen e gjigantit aziatik, duke hartuar disa masa që duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare, por më kot: dakordimi në këtë pikë duket më larg se kurrë.

RRUGA E MËNDAFSHIT NË ITALI

Para ca kohësh Italia vendosi t'i bashkohet iniciativës "Belt-and-Road" - duke dalë kështu kundër Komisionit të BE-së. Më parë, Greqia ia kishte shitur Kinës disa asete të rëndësishme, ndërsa Evropa Lindore është e prirë të ndjekë shembullin e Greqisë. A është kjo vetëm një çështje pragmatizmi ekonomik? Apo mos vallë politikanët evropianë po përpiqen të kompensojnë legjitimitetin e tyre duke gjetur aleatë të fortë në luftën heroike kundër "euroburokracisë"? Evropa dikur ishte qendra e forcës në botë. Mjerisht, sot ajo është e përçarë midis fuqive rivalizuese dhe protezhuese. Dhe ne e dimë nga historia se ku të çon ky lloj "ballkanizimi". (DW)

(Autori është një antropolog kulture nga Bullgaria, aktualisht ai është profesor i ftuar në Universitetin e Regensburgut)

KOHA PÛR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr. 11, | Q.T. Mavrovashja lok. 14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë, 25 mars 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI • Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollgarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Ngritja dhe rënia e Kuvendit të Shqipërisë



Nga
Artan FUGA

Porsi tempujt e tjerë, edhe ky tempull quhet me një fjalë që thërrieste ardhjen e një drame, sikurse Nabukodonosori digjte tempullin dhe përzinte hebrenjtë, ose si e përdhosnin tregtarët tempullin që Jezusi u detyrua t'i përzinte me kamxhik... Kuvendi i Shqipërisë nisi të bënte kuadrin e ri ligjor të vendit dhe kështu u hodhën bazat e ligjshmërisë, që premtonte se do të ngrihej një strukturë politiko-shoqërore demokratike në Shqipëri.

Fillimisht populli pa në Kuvendin e Shqipërisë jo vetëm përfaqësuesit për të cilët kishte votuar vetë drejtpërsëdrejti, por edhe që kishin një nivel arsimor dhe kulturor shumë më të lartë sesa niveli mesatar i shoqërisë në përgjithësi. Nga ai Kuvend, gradualisht nëpërmjet transmetimeve televizive, audiencat masive nisën të kuptojnë politikën e re, mësuat terminologjinë e re politike, kishin një lloj akses në qeverisjen e shoqërisë, si edhe nga figura të nderuara që atje nuk kanë munguar të marrin fjalën si tribunë të vërtetë, masat arritën të frymëzohen nga ideale kombëtare dhe shoqërore të larta.

Kanë rënë qeveri si në vitin 1991, në vitin 1997, 2001, por Kuvendi nuk ka rënë kurrë. Ishte institucioni i fundit i shtetit që mund të supozohej që mund të sulmohej sepse atje flinin shpresat e popullsisë, ishte siguresa e fundit e shtetit, që askush nuk e luan te dorë. Sulmoheshin institucionet e tjera si Kryeministria, Ministria e Brendshme, Presidenca, por asnjëherë Kuvendi i Shqipërisë. E kundërta e asaj që ndodh sot, kursulmohet Kuvendi dhe jo institucionet e tjera të shtetit. Pse nuk sulmohej Kuvendi? Sepse kontrata ishte bërë, çdo deputet atje ishte i zgjedhur nga populli dhe prandaj populli nuk mund të sulmonte veten e tij. Kur them populli, asnjëra palë e militantëve sepse fjala "popull" është shumë e madhe dhe askush nuk mund ta mati dot se kush ka me vete "popullin", aq më shumë që ky "popull" përfshin në vetvete dhe të mirin edhe drejtin, edhe të ziun edhe të bardhin, edhe horrin edhe naivin, edhe të ndershmin edhe maskarain, të gjithë kanë të drejtë të çojnë në Kuvend përfaqësuesit e tyre.

Nisi pra, apogjeu i një institucioni, lartësimi i tij, ngritja e tij në zenith. Nuk thonë kot të vdekurit e mëdhenj, që duhet me u ruajt nga apogjeu, nga pika më e lartë e ngritjes në karrierë a në pushtet, sepse pas kësaj pike, vjen stanjacioni dhe rënia. Konfuci e thoshte bukur, që trishtëhej kur ishte në zbritje të një mali, sepse do të vinte e përpjeta e malit tjetër dhe gëzohej nga

“Kuvendin e Shqipërisë e kanë quajtur tempullin e Demokracisë. Kjo ndodhi pra, pas vitit 1990, kur nga pluralizmi i partive lindi Kuvendi i parë i Shqipërisë, i supozuar që në mënyrë të lirë përmbante delegimin e sovranitetit të kombit. Konsiderohej jo vetëm si tempulli i fjalës së lirë, por me ligjet e nxjerra, edhe si mekanizmi me të cilin populli në liri qeveriste veten me ligjet që përfaqësuesit e tij bënin

ngjitja, sepse pas saj do të fillonte zbritja. Kuvendi i Shqipërisë nisi ta konsiderojë veten si një institucion përtej vlerave dhe moralit të demokracisë, si një pushtet që prodhon ligje, por vetë de facto është përmbi ligjin. Përse ndodhi kjo? Mund të ketë shumë arsye. Mundet që klasa e deputetëve, duke marrë disa mandate radhazi nisi ta konsiderojë veten si elita e përhershme politike e kombit dhe nuk pranonte të zbriste nga kolltukët e Kuvendit të Shqipërisë. Ndofta u dhjamën në pasuri dhe nga bashkëjetesa e gjatë, palët politike në Kuvend nisën të shkëmbejnë privilegje dhe nder me njëri-tjetrin. Unë jam deputet në pushtet, por marr në punë njerëzit e afërm të kolegëve të mi deputetë të opozitës dhe anasjelltas. Ose ndofta ka ndodhur ajo që ka shkruar disa dekada më parë Herbert Markuz, sipas të cilit, në kushtet e shoqërive moderne lind rreziku i madh, që edhe opozita të nisi të bëhet nga pikëpamja e interesave, mendësive, pasurisë, e integruar në të njëjtin sistem privilegjesh sikurse edhe klasa politike në pushtet.

Grupet e deputetëve që u përkohën partive politike kaluan disa herë në parajsën e pushtetit dhe aty u infektuan me privilegje dhe me mendësinë, se ata dhe vetëm ata e bartnin pushtetin e sovranit. Në këtë dehe nga vetëquajtja e vetes si "tempull", pra si vend i të shenjtëve, i të pakritikueshmëve, i të përjetshmëve, i të pacenueshmëve, i të vernerueshmëve, i të paprekshmëve, Kuvendi i Shqipërisë deshi të ngrihej edhe më lart se vetë ajri, deshi të fluturonte në galaksitë e mbipushtetit. Nga institucion i deleguar në pushtet nga kombi, në një çast, kombi, zgjedhësi, qytetari, populli u hoq dhe ai nuk votonte më direkt përfaqësuesit e tij në pushtet, deputetët, por thjesht hidhte votën për

listat e partive që përgatisin kryetarët e partive politike. Jo vetëm aq, por duke parë se deputetët ishin tashmë një klasë politike më vete, ku ngjashmëritë ishin bërë më të mëdha sesa dallimet midis kampeve politike, populli nisi ta shiste votën. E çfarë ta donte!!!

Kështu Kuvendi i Shqipërisë, krahas njerëzve të ndershëm, nisi të mbajë si deputetë edhe individë me rekorde kriminale, individë që për t'iu fshehur ligjit kishin ndryshuar emrin dhe mbiemrin, si edhe shumë mediokër, me nivel më të ulët sesa mesatarja kulturore e zgjedhësve, prapanicëlëpirës, individë që kërkonin pasurim të lehtë mes pushtetit, lloj-lloj parazitësh, që kurrë nuk kishin bërë ndonjë punë në jetën e tyre. Kuvendi i Shqipërisë në dehjen nga madhështia e një tempulli si vend i shenjtë, si vakëf, nisi të kërkojë edhe më shumë pushtet nga lart dhe nga poshtë, të merrte pushtet nga të dyja anët. Etja për pushtet u bë e jashtëzakonshme. Nga poshtë ji mori pushtetin zgjedhësit, i cili tanimë votonte vetëm për lista emërore partiake dhe jo për deputetë të veçantë si persona konkretë; nga lart nuk pranonte më kurrë Kuvendi i Shqipërisë të kishte sipër kokës së vet një institucion tjetër, së paku verifikues a korrektues. Gjykata Kushtetuese e nxjerrë nga Kuvendi, pra nga partitë politike atje, as nuk guxonte kurrë të ndërhynte sistematikisht për të kthyer pas ligje, por thjesht kërkonte redaktimin e tyre, Presidenti i Republikës zgjidhej në fund të procesit me një shumicë të thjeshtë, edhe ai mbeti pa kompetenca, kurse një dhomë të dytë senatoriale, Kuvendi i Shqipërisë i dalë nga ethet partiake, as ka pranuar kurrë të ekzistojë.

Pa asnjë pushtet kontrollues ndaj tij, pa fre, pa litarë, pa byzylykë, Kuvendi i Shqipërisë dalëngadalë "u çmend", domethënë nisi të iki nga funksionet e tij. Këtu nisi edhe rënia e tij. Sot jemi në këtë fazë rënieje. Nuk shkruante kot Osvald Shpençleri një shekull e ca më parë, se çdo gjë në shoqëri i ngjan njeriut, pra ka fazën e vet të lindjes, të maturimit dhe të rënies. Nga Kuvend i përbërë nga individë deputetë, Kuvendi u kthye në institucion, brenda të cilit kishte grupe politike, por jo deputetë që gëzonin faktikisht përgjegjësinë e vendimarrjes individuale. Kuvendi që tashmë kishte marrë të gjitha kompetencat e administratës, gjykatave, mediave, ekzekutivit sepse të gjitha përmbledheshin te pushteti i partisë, pra i krerëve të partive politike parlamentare, nisi të bëjë gjithçka, veç ligjeve që përfshijnë interesin mbarëkombëtar. Ligjet u politizuan, Kuvendi nisi të "hetojë, bren-

da tij bëhen fushatat elektorale dhe gradualisht shërri politik u shndërrua si forma e vetme e asaj që mund të quhet fushatë elektorale e përherëshme, e pandërprerë, e bazuar te hilaritetet, te fjalët e shkurtra vrastare, te ofendimet e ndërsjella, e kështu me radhë.

Meqë u bë realisht vendi i vetëm i shtetit edhe shumica, edhe opozita aty me ligjëratat politike kërkojnë të zgjidhin çështje që i takojnë funksionimit të gjykatave, prokurorisë, administratës civile, e të gjithë hallkave të tjera shtetërore në përgjithësi. Në këto kushte, opozita u ndodh në kurth sepse në Kuvend nuk mund të zgjidhen këto çështje, sepse aty sundon dhuna e kartonit, e shpjeguar para dy shekujsh që në veprën mbi demokracinë në Amerikë nga ana e Tokëvil. E enjtja ku transmetohen seancat e punimeve të Kuvendit në televizione u bë një ditë ilariteti popullor që tejkalon çdo skeç, estradë, varietet, komedi. Imazhi i Kuvendit të Shqipërisë shkoi në shkallën më të fundit me një nivel reputacioni, që sipas sondazheve që unë njoh, është edhe më i ulët sesa i Policisë, i universiteteve apo i spitaleve publike. Dalja e opozitës së tanishme nga Kuvendi i dha atij një goditje të rëndë. Është në përgjegjësi të këtyre partive politike opozitare që të matin pasojat e aktit të ndërmarrë. Të marrësh pjesë dhe të bësh betejë politike në një Kuvend ku nuk pyetesh, sikurse ka ndodhur me qindra e mijëra herë edhe në vende të tjera në histori, apo të braktisësh lojën politike duke iu kthyer rrugës, kjo nuk është aspak një shaka dhe sjell mbi vete përgjegjësi aq të mëdha, saqë pasojat e këtij akti mund të sjellin kthesa historike aq të paparashikuara, saqë përballjen me to mund ta bëjnë ose vizionarët e ndritur, idealistët e mëdhenj, heronjtë e vërtetë, ose kokëkrisurit e papërgjegjshëm, gjaknxehët e çartur, apo naivët e pandreqshëm.

Përtej goditjes ndaj politikave të qeverisjes kemi një fakt, një ngjarje, një rezultat që nuk është as më shumë, por edhe as më pak, por vetë rënia e Kuvendit të Shqipërisë si pasojë e degradimit shumëvjeçar të tij nga vetëfryrja si tempull i demokracisë, tek institucioni që sot është jo vetëm më i kontestuar, jo vetëm me imazhin më të ulët nga të gjitha institucionet e tjera të shtetit, por edhe i dalë krejtësisht nga funksionet parësore që ai do të duhej të kishte. Mund ta diskutoj një herë tjetër këtë temë të daljes së partive politike opozitare nga Kuvendi i Shqipërisë, sado me të meta dhe i degraduar të jetë ai, nëse publiku dëshiron, por ndërkohë futja në këtë

Kuvend e deputetëve nga listat rezervë, është një degradim edhe më i madh. Marrja e mandatit nga kandidatët e listës, funksionimi i Kuvendit duke u bazuar te prania e tyre, do të ishte kriza e krizës së Kuvendit të Shqipërisë. Këta deputetë që marrin mandatet kanë legjitimitet prej partive që i kanë vendosur në listat elektorale dhe nuk kanë legjitimitet nga vetja e tyre. Është absurde të mendosh që ata mund të kenë legjitimitet në një Kuvend, kur partia politike që i ka vendosur në listat e kandidatëve për deputet është tërhequr për të mirë a për të keq të Shqipërisë, e debatohet një herë tjetër këtë çështje, nga pjesëmarrja në këtë Kuvend. Dhe rënia e këtij Kuvendi bëhet edhe më e dukshme, kur shohim se ai, si vendi ku sovranit ka deleguar pushtetin e tij, sulmohet nga një pjesë e sovranit, kurse pjesa tjetër e sovranit ose qëndron e bën sehir, ose vazhdon jetën e vet sikur të mos ketë ndodhur gjë.

Tempulli i demokracisë e ka humbur shenjtërinë e vet. Goditjet nga jashtë, nga kushdo që të vijnë, sado të legjitimuara ose jo në vetvete, tregojnë se Kuvendi nuk është më i paprekshëm, nuk është më i virgjër, i paatakueshëm. Përtej krizës politike, kemi një krizë institucionale. Kuvendi i Shqipërisë si akumulues i panginjur i të gjitha pushteteve, pas të cilit qëndrojnë në fakt partitë politike që e kanë zhdukur deputetin si përgjegjësi individuale, mund të marrin një rrugë që në rënien e vet të shkasi njëherë e përgjithmonë në humnerë bashkë me shansin demokratizues të Shqipërisë. Të pranojë të lëshojë pushtetet, të jetë vetëm pushteti legjislativ, i dalë vërtet nga vota popullore, i bazuar te deputeti si person juridik përgjegjës, dhe jo sikurse është sot—kjo është rruga e reformave të shtetit në rënie sot.

1. Kuvend i Shqipërisë vetëm si pushtet legjislativ
2. Përgjegjësi individuale e deputetit
3. Zgjedhje të lira e të drejtpërdrejta për deputetët, jo për listat e partive politike.

Pa këto tri parime bazë reformuese të Kuvendit të Shqipërisë, pra, në fakt të institucioneve të qeverisjes së shtetit, pra pa një Republikë të Re, të tradhtuar, përbuzur dhe shkelur me këmbë si një flamur betejë i grisur, atij Kuvendi, por jo vetëm, do t'i bjerë me gurë çdo militant partie i inatosur, çdo qytetar që i ka humbur durimi, çdo individ që ndien se i bëhet padrejtësi, por edhe çdo person që merr adrenalinë nga dhuna ndaj institucioneve të shtetit, si mënyrë për t'i ikur thjesht dhe kolektivisht në turmë merrzisë urbane.

Isak Shema, fitues i orës së madhe letrare 'Flakadani i Karadakut'

Në kuadër të manifestimi tradicional mbarëkombëtar kulturor e sportiv "Flakadani i Karadakut 2019", në Viti është mbajtur ora e madhe letrare, në të cilën kanë marrë pjesë krijues, poetë e shkrimtarë nga hapësirat mbarëshqiptare.

Në këtë aktivitet që ka pasur karakter garues, vendin e parë e ka zënë prof. dr. Isak Shema me poezinë "Relikt". Ndërsa vendin e dytë e ka marrë Odise Plaku, kurse Vjollca Dibra është shpërblyer me ven-



din e tretë. Në fillim të këtij aktiviteti në emër të Komunës së Vitisë, një fjalë rasti e ka mbajtur zëvendëskryetari i kësaj komune, Ha-

san Aliu.

Gjatë këtij viti komisioni vlerësues për orën e madhe letrare ka qenë në këtë përbërje: prof. Agim Vinca, Zymrije Salihu dhe Ismajl Baftjari.

Mirënjohjet për pjesëmarrësit dhe çmimet janë ndarë nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Milot Lala, Ramush Azemi, babai i dëshmorit Nijazi Azemi – komandat Mjekra si dhe Qahil Sinani nga Komuna e Vitisë. /Epoka e re/



Libri i Xhevdet Bajrës merr çmimin "Medaljoni i Kristaltë"

Libri "Vitet që nuk e sollën pranverën" i poetit Xhevdet Bajraj, ka marrë çmimin si libri më i mirë, në Lidhjen e Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë. Libri është vlerësuar me "Medaljonin e Kristaltë" ndërsa është botim i klubit letrar "De Rada". Xhevdet Bajraj, është një prej shkrimtarëve më të suksesshëm kosovarë. Ndër vite ai është vlerësuar me disa çmime. Në vitin 2000 morri çmimin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Çmimi Ndërkombëtar i Goliardos për Poezi në vitin 2004, çmimin për dramën më të mirë origjinale të shkruar në gjuhën shqipe në 2013 nga Festivali Monodrama në Vlorë. Por poezia mbetet një prej pasioneve të tij më të mëdha. Në 2015 u vlerësua edhe me një çmim, atë për poezinë më të mirë të paraqitur në Panairin Ndërkombëtar të Prishtinës.

"Britma" në një tjetër interpretim

Një ekspozitë e re në Muzeun Britanik duket se do t'i japë fund debatit të gjatë. Figura në pikturë nuk bërtet, por dëgjon një britmë.

Në një ekspozitë të re të titulluar "Edvard Munch: Love and Angst", Muzeu ekspozon një version litografik të imazhit që i parapriu pikturës ikonike të vitit 1893. Në fund të saj është një mbishkrim nga artisti: "E ndjeva një britmë të madhe në të gjithë natyrën".

Fjalja i referohet një shëtitjeje të Munch, bëri në fjarde prej ku shihet Osloja. Ai e përshkroi atë në një ditar me titull "Nice 22 January 1892": "Unë isha duke ecur përgjatë rrugës me dy shokë – dielli po perëndonte dhe papritmas qielli u kthye në gjak – ndalova i lodhur dhe u mbështeta në gardh. Kishte gjak dhe gjuhë zjarri mbi qytet



dhe miqtë e mi ecnin, unë qëndrova duke u dridhur nga ankthi dhe ndjeva një ulërimë të pafund që kalonte përmes natyrës", shkruante ai.

Një pjesë tjetër e dëshmime mbështetëse është edhe titulli origjinal i pikturës në gjermanisht "Der Schrei der Natur" ose "The

Scream of Nature" (Britma e natyrës).

"Ai po përpiquej të kapte një emocion ose një moment në kohë", ka thënë për "The Telegraph", Giulia Bartrum, kuratore e ekspozitës. "Nëpërmjet mbishkrimeve ne e dimë se si ndihej ai. Njerëzit mendojnë se ky është një person që

bërtet, por kjo nuk është ajo që po ndodh".

Studiues të tjerë të Munchut, përfshirë Gunnar Soerensen, ish-drejtor i Muzeut 'Munch' në Oslo, lënë një hapësirë pak më shumë për nuancë. "Mund të jetë një britmë në natyrë ose një person që bërtet", ka thënë ai. "Kjo është një çështje e interpretimit".

Pavarësisht nga kjo, interpretimi i ri mund të kërkojë disa përditësime për bazën e të dhënave gjithëpërfshirëse globale të figurave të vogla digjitale që paraqesin emocionet, në ato që quhen "emotikone". Në këtë rast është një fytyrë e verdhë që bërtet në frikë, e përshkruar nga sytë e gjerë, të bardhë, gojë të gjatë e të hapur me ballë të zbehtë blu, sikur të ketë humbur ngjyrën e cila ngjall pikturën e Edvard Munchut.

"Ajo" e More Raçës me rrëfimin për dhunën në familje udhëton nëpër botë

Fundjavën e ka përmbyllur para publikut italian, kur u shfaq në "Alessandria Film Festival" që përfundoi të dielën, por filmi "Ajo" i More Raçës nuk ndalet. Janë 5 festivale brenda 3 muajsh në të cilat tashmë e ka konfirmuar pjesëmarrjen.

Ky film i shkurtër kosovar, që shpërfaq historinë e dhunës në familje të shoqëruar nga guximi i një vajze të re për të shpëtuar veten dhe nënën e saj, do të shfaqet e rishfaqet para audiencës amerikane, aziatike, gjermane e spanjolle, shkruan "Koha Ditore".

"Ajo" do të jetë pjesë e festivalit të filmit të gruas "Beirut International Women Film Festival", "Cascadia International Women Film Festival", në festivalin gjerman të kategorisë A, "International Short Film Festival Oberhausen", "Short Shorts Film Festival & Asia" dhe "San Sebastian Human Rights Festival".

Festivali i filmit të gruas në



Beirut është organizim i përvitshëm që mëton ta promovojë një imazh pozitiv të grave dhe t'i vë në pah përpjekjet e tyre për ndryshime shoqërore.

Kryeqyteti i Libanit do të jetë

nikoqir i edicionit të 18-të të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Gruas me fillim nga dita e 22-të e prillit deri më 28, ku filmi kosovar "Ajo" është në mesin e 37 filmave të shkurtër të

përzgjedhur për kategorinë ndërkombëtare.

Prej ditës së 5 prillit për shtatë ditë me radhë është përzgjedhur që të shfaqet në festivalin "San Sebastian Human Rights Film Festi-

val", që do të mbahet në qytetin bregdetar spanjoll San Sebastian. Festivali i Filmit të Drejtave të Njeriut në San Sebastian është iniciativë e projektit "Hapësira për Projekt Kulturor të Paqes" dhe ka për qëllim të nxitë vetëdije më të lartë, debate dhe informacione për të drejtat e njeriut përmes kinemasë dhe shprehjeve artistike e kulturore dhe vlerave si: solidariteti, respekti për jetën, paqja, liria dhe drejtësia shoqërore.

Tjetri në radhë është festivali treditor i filmit të gruas "Cascadia", që mbahet prej 11 prillit në Bellingham otë Washingtonit. Për regjisorin Raça është hera e dytë që do të prezantohet atje, ngase në vitin 2016 ishte pjesë e festivalit me filmin "Home".

"E vlerësoj si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen për herë të dytë në këtë festival, ndër të tjera, për faktin se ky festival amerikan ka në fokus kinemasë gra", ka thënë Raça.

"PIKËBARDHA" E SEFERIT



Nga Vjollcë BERISHA

Gjithmonë jam ndjerë ngushtë kur më është dashur të jap një mendim lidhur me krijimtarinë e shkrimtarëve të rinj, jo për shkak të mungesës së entuziazmit se ata po shtohen, por për shkak të frikës reale të dozimit të fjalëve nxitëse e dëshirore. Kur them nxitëse, kam parasysh ato mendime që mund t'i japin hov e vetësiguri akëcilisht shkrimtar, duke ia përkëdhelur sedrën e duke e frymëzuar edhe më që ta shohë veten në radhën e shkrimtarëve të shquar. Ndërkaq fjalët a fjalitë dëshirore kanë të bëjnë me ato gjëra që do të dëshiroja t'i shihja ndryshe e më mirë te shkrimtari që ma ka paraqitur me zell dorëshkrimin. Kjo baraspeshë mes këtyre të dyjave është ai dozimi që ia kam frikën dhe e ndjej si barrë tek shkruaj një tekst për një autor të ri, edhe në rastet kur më pëlqen shkrimi, po edhe në rastet kur mendoj se ka tepri të disa gjërave në dëm të mendimit, të ndjenjës, apo, ç'është më e rëndësishmja, të estetikës.

Dozimi është kaq brerjtës dhe bart kaq shumë përgjegjësi sa mund të ta shpjerë në theqafje gjumin për disa net rresht. Kurrë s'i kam kuptuar as ata kritikë që e fryjnë si tullumbace mjeshtërinë e një autori, e as ata që i bien shkurt e me negativitet, duke ia prerë flattrat që në fillim, apo, siç do të thoshte poeti Esad Mekuli, si ato mrazet e pranverës, duke ua mbytyë filizat mu në farë.

Dozimii këtyre dyjave ka të bëjë me baraspeshën dhe përgjegjësinë e fjalës. Një lëvdatë e tepërt, një mëtim për ta vendosur poetin e ri në maje të larta me "teleportim", është më shpesh një dëm, është mundësia për t'ia mbushur mendjen se ka një talent të rrallë, duke ia ndërprerë rrugën e kërkimit, e madje, edhe më skandalozja, edhe atë të leximit, aq sa e shndërron poetin në një kërkues botuesi a shtypshkronje dhe e vë në gjurmim të një njeriu tjetër që do ta fryjë atë flluskën e sapunit që e duan fort fëmijët, që e quajnë bubbles, që bëhet me ngjyra të rreme nga përthyerjet e dritës, e që fluturon larg, ku zhduket përfare, duke ia lënë fëmijës iluzionin gjysmë të besueshëm se u ngjit në qiell, ku syri i tij s'e gjen më...

Po edhe heqja e një vije të rreptë a e një ikisi barbar mbi krijimtarinë e tij është diçka e vrazhdë, e

Pikëbardha vjen si vazhduese e tërë atyre pikave që na bëjnë të mendojmë e që janë shumë në numër, si: pikëpyetja, pikëçuditësja, pikëprerja, pikëpjekja, pikëpamja, pikësynimi..., të cilat jo rrallë nuk janë vetëm kompozita të rëndomta, por metafora të mëdha ndjenjash e frikërash njerëzore. E tillë është edhe Pikëbardha, e cila, me mënyrën e thjeshtë të të thënit të gjërave, me gjuhën e drejtpërdrejtë, me figurat e natyrshme, u jep një emër konkret ndjenjave...

pamenduar mirë, diçka që s'e lejon t'i rriten flatrat, diçka që ia ndalon fluturimet e nesërme, diçka që u ngrit postbllloqe të tmerrshme muzave që e deshën, diçka që ia rrokullis vetëbesimin tatëpjetës së ëndrrës.

Pra, të dyja janë të rrezikshme dhe të dyja e zhdukin një krijues, andaj dozimi është domosdoshëm në rastin e krijuesve ende të paafirmuar. Kjo ndjenjë përgjegjësie më ndalon të shkruaj për librat e rinjtë botuar apo për ata që presin në dorëshkrim, edhe sot kur e ndjej, si asnjëherë më parë, mungesën e një kritike të mirëfilltë letrare. Mungesën e një kritike që në mënyrë korrekte, të drejtpërdrejtë, do të fliste për librat që duhen lexuar, do të trasonte rrugë të sigurt për krijuesit e rinj dhe jo vetëm për ata; një kritikë që do ta orientonte mendimin e lexuesit jo-profesionist, do t'i hapte horizontin një lexuesi të profesionalizuar për të bërë një studim për një vepër të caktuar, do t'i nxirrte nga anonimatia disa jvësi letrare që janë humbur në grumbullin me zhurmues të atyre që kanë botuar një deng librash sa për t'i marrë në qafë drurët që e bënë letrën...

Kaq shumë gjëra do të ndryshonte kultivimi i një kritike të mirëfilltë letrare, i një kritike me baraspeshë, i një kritike të bërë jo nga mjeshtër çollakë, por nga ata të

zanatit, nga ata që dozimin e njohin dhe e përfillin këmbëngulshëm, nga ata që s'i ze gjumi natës për një fjalë të thënë... A s'duket pak e shëmtuar të kesh frikë të shkruash e të japësh mendim për një vepër kur e di mirë se ç'hon të madh le në artet bashkëkohore (në të gjitha pa përjashtim) mosekzistimi i kritikës?! Sigurisht që po. Por ajo ndjenja e frikës nga dozimii saktë mbase ma jep një arsye...

Po këtë ndjenjë përgjegjësie e pata kur nisa ta lexoja tekstin në dorëshkrim të Sefer Selimit, ku lehtësisht shquhet kultura e tij e leximit dhe talenti që e mbështjell. Pikëbardha, si te prozat poetike, ashtu edhe te vjershat, ta vizaton vetë trajektoren e lëvizjes si lexues. Të bën t'i biesh rreth e qark pikës së bardhë që shquhet midis grisë dhe të zezës në jetën e subjektit lirik. Autori që në titull zbulon pikën e rëndësës, strumbullarin e tërë krijimeve të librit, të vetëdijëson për ekzistimin e një pike të bardhë që shquhet në mesin e të errtës, një pike që e zbardh përjetimin, që është kuptimi vetë, një pikë që ngjet diellit e që do t'i rrotullojë rreth vetes të gjitha krijimet e këtij libri, të gjitha prozat e poezitë që i këndojnë dashurisë - dashurisë në vetën e parë, dashurisë që kurrë s'di të jetë e shkuar përderisa këndohet, dashurisë së ndërprerë -

ndjenjës së veçantë që e ka prodhuar edhe këtë libër poetik të Seferit e që e shijojmë si tonën të gjithë që e marrim në dorë, për shkak të mënyrës së thjeshtë e të drejtpërdrejtë të të thënit të gjërave, për shkak të sinqeritetit, të mosrendjes dhunshëm pas figurës, pas eksperimentit me vargun, por gjithnjë duke e ruajtur linearitetin, natyrshmërinë dhe krejt atë që e bën të vështirë krijimin e vargjeve të lehta.

Pikëbardha është një përngjitje fjalësh që t'i kujton përrallat e mëdha, personazhet që kanë arritur të vizatojnë në kokat tona imazhin e vet vetëm për shkak të emrit të përngjitur, pa shumë cilësime e përshkrime, siç është për shembull Kësulëkuqja e dashur, Borëbardha e mirë, Mjekërkaltërti, Këmbëshpejti e një sërë personazhesh, të cilat me një fjalë të vetme, si në një sprovë vizatimi me një vijë të vetme të pashkëputur, kanë zënë vend në imagjinatën tonë që në vegjëli. Te poezia e Seferit, Pikëbardha nuk është vetëm një emër i përngjitur, një cilësor, ajo është kompozitë-figurë, është një ndalesë, një e bardhë në telajon zezë ku pikturohet dashuria, ndoshta një pikë në fund të një fjalie, të një rrëfimi, të një historie... ndoshta pika borhesiane nga duket gjithçka, ndoshta pika më e largët e erosit, ndoshta të gjitha së bashku, ndo-

shta asnjëra... E ndoshta vetëm ajo vajza që ka marrë mbi vete tërë dashurinë e subjektit lirik dhe ia ka mbathur, duke e lënë një vend të zbrazët përgjithmonë, një vend që i ngjet një pike të bardhë.

I gjithë libri përshkohet nga një ndjenjë dhimbjeje, nga ajo që jepin mbarimet e dashurive, por askund s'të zë syri qaramani, dëshpërim, vuajtje... Subjekti lirik i kësaj poezie duket sikur është në përpjekje të njohjes së të gjitha ndjenjave, qofshin edhe ato që i jep ndarja, ndërprerja e dhunshme e një ëndrre, dëshira për t'u rikthyer, përjetimi i përsëritur përmes kujtimeve e të ngjashme. Askund nuk lexohet ndjesia e humbjes së një gjëje të shenjtë, përkundrazi: i këndohet njeriut të dashur me kënaqësinë që sjellin gjërat e bukura kur përjetohen, pa frikën e humbjes. Ti, fitorja ime e Pirros, thërret madje subjekti lirik, pa përlllogaritur numrin e fitoreve kundruall humbjeve që i sjell ajo.

Libri i ngjet një kënge të vetme, një letre të gjatë, shkruar kryesisht në vetën e dytë (siç shkruhen rëndom letrat), ku i këndohet dashurisë, ndarjes, honit që ka lënë pas, ditëve të shkuara, përmes të cilave lexuesit i jepen disa detaje nga përjetimet e perënduara dhe në këtë mënyrë sheshohen malet e dëshpërimit për ta shpërfaqur para syve receptues tërë gjeografinë e një dashurie të tashme, të përherëshme.

Nuk është vetëm erosi ai që e bën secilin ta ndjejë se kjo që po shkruhet është historia e vet, por edhe stili i thjeshtë, pa ojna, i autorit e bën librin të komunikojë lehtësisht me lexuesin e vet.

Pikëbardha vjen si vazhduese e tërë atyre pikave që na bëjnë të mendojmë e që janë shumë në numër, si: pikëpyetja, pikëçuditësja, pikëprerja, pikëpjekja, pikëpamja, pikësynimi..., të cilat jo rrallë nuk janë vetëm kompozita të rëndomta, por metafora të mëdha ndjenjash e frikërash njerëzore. E tillë është edhe Pikëbardha, e cila, me mënyrën e thjeshtë të të thënit të gjërave, me gjuhën e drejtpërdrejtë, me figurat e natyrshme, u jep një emër konkret ndjenjave dhe e josh lexuesin t'i afrohet ngadalë, me lapsin e gdhendur për të shënuar ndonjë varg që i le përshtypje të veçantë a një tepri poetike që i shkon në dëm estetikës së librit, sa për ta mbajtur në baraspeshë reale dozimin e nxitjes dhe dëshirës ndaj shkrimtarit të ri që po depërton në pyllin joshës të shkrimtarisë me fanarine dorës dhe përjetimet e veta, si mjete të vetme që do t'i hyjnë në punë midis bukurisë së pyllit dhe kërcënimit të egërsirave.

Pikëbardha

Sefer Selimi Jr.

KUSH ISHTEVINÇENS PRENNUSHI?

Nuk është e lehtë ta përmbledhësh me pak rreshta jetën aq të pasur të imzot Vinçenc Prennushit. Lindi në Shkodër më 4 shtator 1885. U Pagëzua me emrin Kolë, së shpejti ndjeu thirrjen e Zotit për jetën rregulltare. Hyr në kuvendin françeskan të vendlindjes më 1900; u shugurua meshtar në Tirol të Austrisë, ku kryente studimet, duke e ndër-ruar emrin në Vinçenc.

Nisi të botonte rreth 1909-1910-tës. Më 1911 botoi "Kangë popullore gegnishte"; më 1918 fletëpalosjen liturgjike "Fjala e Zotit"; "Java e Madhe", libër feje, për javën para Pashkëve. më pas dramën "E trathuemja" e "Prej robnie në liri"; studimin "Nder lamije të demokracisë së vërtetë" (1922). Kryeveprën poetike "Gjeth e Lule" e botoi më 1924, për të vijuar me veprat agjiografike "Shën Françesku i Asizit" dhe "Jeta e Shna Ndout prej Padue" (1913); "N'Agape", vjershë (1926); "Vorri i fratit", 1717-1918. Dy fjalë mbi jetën e A. Anton Soranit, dëshmitar feje françeskan (1918); Ndër përktimet e imzot Vinçenc Prennushit kujtojmë: "Quo Vadis" të novelistit polak, Henryk Sienkiewicz; "Burgjet e mia" të italianit Silvio Pellico, poemën "Dreizehn Linden" të gjermanit Friedrich Wilhelm Weber, nga e cila "Hylli i Dritës" u botuan te vetëm tri këngë. Këtu këputet veprimtaria e mbyllet, për të përfunduar kush e di se ku, arkivi i tij jashtëzakonisht i pasur.

Në poezinë e Prennushit, bota lëndore vë-shtrohet si një ndër arsytet e shkatërrimit të njeriut, për shkak të paaftësisë për t'u vetëpërmbajtur dhe të lakmive të pangopura vetjake. Shkruan At Justin Rrota: "E n'atë mënyrë qi At Fishta mund të thirret për kah trajta e gjuhës poeti i Gegnis, pse diji me i a vjedhë popullit të malit e të fushës bukuri më të pikaturat e të shprehurit, kështu Prennushi mund të mbahet si poeti i qytetit të vet, mbassi gjithshka gjeti të hijshëm në fjalë e në frazeologji të këtij dialekti e mblodhi si bleta dhe e vendoi me shije të madhe ndër shkrimet e veta".

Më 1947 imzot Vinçenc Prennushi u arrestua nga komunistët në Tiranë e më pas u nis për në Burgun e Durrësit, ku edhe vdiq më 19 mars 1949 në një natë të errët e të acartë, duke kërkuar "më shumë dritë e duke mbrojtur deri në frymën e fundit, vlerat, idealet e bindjet e veta. Shkruan mes tjerash Arshi Pipa, që ia mbylli sytë e vdekur "...asht vështirë me pranue se gjithçka mbaron me trupin, kur vërejmë qysh njerëzit vdesin për ideale".

"Asht i formuem jo vetëm nga ana fetare, atdhetare dhe kulturore, por radhitët ndër letrarët ma në za të Rilindjes sonë. Shkruan në revistën "Hylli i Dritës", "Lajmtari i Zembrës së Krishtit", "Zani i Shna Ndout" dhe ka vlera të posaçme për artikujt e shkruem në gazetën "Ora e Maleve", mbasi, aty, Ai shfaq edhe pikëpamjet e veta atdhetare, politike dhe demokratike. Ban pjesë në veprimtari e vazhdueshme të klerit për parvarësinë dhe, si i tillë, me rastin e ngritjes së Flamurit në Kalanë "Rozafat" në Shkodër, më 14 mars 1914, mban fjalimin kryesor ku spikat oratoria e At Vinçencit", shkruan Arshi Pipa. Prof. Arshi Pipa, në "In memoriam", për Imzot Prennushin tregon: "Kur gjyqi ushtarak që u zhvillue në një dhomë të burgut e dënoi me 20 vjet burgim të randë, fjala e tij e mbrojtjes qe: "Nuk i kam dashtë kujt të keqën. Jam mundue me ba mirë".



VINÇENC PRENNUSHI

AMË E BI

*Ka ra rrezja nder bajama!
T' bin e vet kshtu e pvetë e ama:
— Ç'ke, moj bi, qi kjan e fshan?
Kjan e fshan, e vetllat vran?—*

*— Kjava shum, mori lum nana,
Tuj qindisë e m'ra gjylpana;
M' ra gjylpana nen balkue,
E jam ulë tash me e kerkuë. —*

*— Po çka kje qi lodt t'i xori?
Ku kje dhima, a ku kje zori?
A por, drue, mos m'je harlisë,
Qysh se kjan—o tuj qindisë.
Pasha nanen nuk mund t' bari,
Qi të me ndezet bija zhari!
Do t' a dije e zeza nanë,
Pse ti vetllat shpesh m' i vranë;
Pse ç'kah mot, moj, buza s't'qeshet
E n'argtime zemra s't'ndeshet. —*

*— Nuk a gja, moj nanë s'a gja;
Por po t'tham, se as kot s'jam vra:
Dicka vlon n'ket çerdhe zanash;
Vlon dashtni, si n'bija nanash!
Nane, dashtnija m'ka molisë,
Prandej kja—o tuj qindisë!—*

*— T'u thaftë goja, bi, ç'po thue?
A kaq shpejt ti m'je terbue?
Po shikjo, moj bi kercuna,
Se, po bana 'i herë e t'xuna,
Bana e t'pava tuj m'dalë n'derë,
Nuk m'ke pshtim, jo metshta e mjerë!—*

*— Jam shqyptare e bi shqyptari,
E ato fjalë, nanë, s'mund i bari:
S'ke me m'pa, jo, tuj dalë n'derë,
Si kujton, pse m'ke per nderë;
As, moj nanë, nuk jam harlisë
Veç pse kja—o tuj qindisë,
E shka n'zemer m'ka pengue,
Asht gja e dejë, o nanë, per mue. —
Fillon nana tash me u vra:
Diçka nakel së mjerës i asht ba;*

*Don me çilë të ngratën gojë;
Por dro e mjera mos t'gabojë:*

*— Fol, moj bi, mos m'len nder grepa,
Mos më mshef gja, moj, se do djepa
I kam luejtë der tash e m'ke
Dhellen t'vjeter: Ty sot be
T' paça lshue, tash me m'diftue,
Se pse zemra peshë t'asht çue.*

*— Nanë, dashtnija m'ka molisë,
Prandej kja—o tuj qindisë. —
Bindej nana, gja s'kuptote,
Por, të miren kah i a dote
Muer me t'amel e i tha e mjera:*

*— Mori bi, moj si prendvera,
Pash njat diell e pash njat hanë,
Pash njat Zot, qi kthiell e vranë,
M' difto sot, ç'sokol ke xanë?—*

*— Ç'farë sokolit thue, moj nanë?
T' thaçë, moj, t' thaçë se s'm'a ban ndera,
S'm'a ban shpija, as s'm'a ban dera
Me luejtë mendsh, moj nanë, mas kuej:
S'i kam dhanë, jo, fjalë kurrkuej.
E po t'tham: Se n't'endun t'motit,
Po t'tham, po, me besë të Zotit,
Ty due fjalët me t'i ndigiuë, As s' kam men
d me t'u largue.
Zemren dysh un s'mund e daj:
M'len t'qindisi, m'len të kja!—
U ngri nana, lodt i pshtuen;
Para s'bis fort syt i u xuen.
Kaluen dit e kaluen net,
Vajza ma me gojë s'po flet:
Me gojë s'flet edhe na a smue,
Rat e mjera a tuj lingue:
Lingon keq n'at shtroje deket
E shpesh paket edhe meket.
Ftyra e sajë pors flok bore;
Mndash, gjylpanë s'i hjekë prej dore;
Por punon e tuj punue,
Shef pelhuren se a'marue:
I lshon syt mi te me mall
Edhe e puthë e e ven në ball.
Nana vajzen tuj dihatë*

*Shpesh e ndien e:— Mori e ngratë,
A njimend s'don me m'diftue,
Se pse zemra peshë t'asht çue?—*

*— Nanë, dashtnija m'ka molisë;
Kjava mjaft-o tuj qindisë!
Kjava mjaft...— Ma desht t'ligjrojë,
Por i u kput ksajë fjala n'gojë.
Si fjalë tjera nuk mund të xori,
Mndash, gjylpanë prap n'dorë i mori;
Por dy duerët, pors florini,
Mi pelhurë deka i a ngrini.*

*— Kuku nana kjan me lot,
Se ç'me gjet mue t'mjeren sot!
Se ç'e gjet të zezën nanë
Nen ket diell e nen ket hanë!—
Merr pelhuren, qi pat enë
Bija e sajë; kishite pasë kenë
Kuaq e zi e m'te qindisë
Gjet dashtnin qi e kishit' molisë.
N' krye t'flamurit kishit' punue,
Per rreth shqyptare, m'dorë prarue,
Fjalët e hershme, fjalët e të Parve:
Se Shqyptaria asht e Shqyptarve;
E nder skaje fjalët "liri".
Merr nanë-shkreta e pshtuell at bi,
Qi, pa njofët tjetër dashtni,
Ishte shkri veç per Shqyptari.
Eni bija, zana malit,
Ju qi kjani n'dekë t'njij djalit,
E, permysë mi ket bujare,
N'te nderoni bin shqyptare;
E tuj puthë e mall e vajë
Njat flamur, qi dora e sajë
Diejti aq bukur me qindisë,
Pse dashtnija e kishit' molisë;
Lidhniu tok: Per herë dashtnija
Per vend t' uej t' u jet stolija;
Pe, po kje qi, si kjo bi,
Rriten vashat në Shqyptari,
N'vend do të shkojë-o fjala e t'Parve,
Se Shqyptaria asht e Shqyptarve.
Lidhniu tok, si bajshin motit
Ato bijat e Kastriotit,
E broh'ritni n'gzim e n'vajë:
Rrnoftë Shqyptaria e flam'ri i sajë*



Ajo fjalë shënjon një vijë prej kilometrash të gjatë dhe vite të trashë. Është një vragë që për-

Kufiri, Alessandro Leogrande


shkon materien dhe kohën, netët dhe ditët, brezat, ashtu si edhe vetë zërat që tregojnë për të, që ndjekin njëri-tjetrin, mbivendosen, kundërshtohen, ngjishen, zgjerohen. Është kufiri.

Është një vijë imagjinare e, megjithatë, është reale sa më s'ka... është një plagë e pambyllur, një vend i të gjithëve dhe i askujt, në të cilin, në mënyrë të padukshme, kushdo është pjesë: është kufiri që ndan e bashkon njëherësh veriun e botës: demokratik, liberal dhe të civilizuar, me jugun: të varfër, të kafshuar nga lufta, të prapambetur dhe antidemokratik. Pikërisht në zgrip të këtij kufiri luhet loja e madhe e botës bashkëkohore.

Ky prag është i parrokshëm, i papërvijueshëm, jomaterial: shkrimi i qaset kuturimthi, përmes orvatjeve, duke lëvizur në truall të paeksploruar, atje ku ndodhin migrimet dhe dëbimet, atje ku luftohet për të jetuar a për të vdekur.

Leograndeja na çon në bordin e anijeve të

operacionit Mare Nostrum dhe peshkon fjalët nga thellësitë detare, ku kanë ngecur dhe rrinë fshehur. Na çon të njohim trafikantët dhe bebis kafistët, bashkë me historitë e të mbijetuarve nga mbytjet e anijeve në Mesdhe, në detin e hapur pranë Lampeduzës; rindërton historinë e eritreasve, popull ndër ata që diktatura mizore i ka shtyrë drejt emigracionit, rrjedhojë edhe e kolonializmit italian; na tregon kufirin tjetër, atë grek, atë të Agimit të Artë dhe të Patrës, por edhe kufij të tjerë Ballkanit; na fut në një Libi që ka shpërthyer dhe është rrënuar, na fut në Qendrat të Identifikimit dhe Dëbimit, në Itali duke na njohur me shkeljet e të drejtave që ndodhin aty, në dhunën e periferisë romane dhe në atë që gjendet e fshehur në shpirtrat tanë: kështu i jepet zë vrimës së zezë së pashtershme, ku çdo ditë shemben të drejtat komunitare dhe ndërgjegjet tona. Sa vuajtje! Sa kaos! Sa indiferencë! Diku në të ardhmen, pasardhësit tanë do të pyesin veten se si vallë e lamë të ndodhte e gjitha kjo.



Vejusha e zezë, Daniel Silva

Daniel Silva vjen me një thriller të ri në shqip: "Vejusha e Zezë": Atij i thonë Saladin; Ajo është një vejushë e zezë; E etur për gjak... Një rrëfim rrënqethës, i mbushur me intriga dhe emocione. Atij i thonë Saladin... Ajo është një vejushë e zezë. E etur për gjak... ISIS-i ka organizuar një sulm me bombë në Paris, gjë që nxit qeverinë franceze të vihet në ndjekje të personit përgjegjës, para se ai të sulmojë sërish. Gabriel Alonit nuk i mbetet veçse të infiltrojë një agjente në grupin terrorist më të rrezikshëm në botë. Misioni i saj i rrezikshëm do ta çojë nga periferitë e Parisit, në ishullin e Santorinit, në realitetin e tmerrshëm të kalifatit të Shtetit Islamik e në fund, në Uashington, ku Saladini planifikon një natë të mbushur me terror, që do të ndryshojë rrjedhën e historisë.



"Të sapomartuarit", Ethel Turner

"Të sapomartuarit" është romani më i ri botuar nga Shtëpia Botuese OMSCA-1, i shkrimtares Ethel Turner, që rrëfen fillimin e martesës së dy të rinjve të dashuruar, të cilët zanafillën e njohjes së tyre e kishin që nga fëmijëria e hershme. Lindja e fëmijës, e kësaj krijese të dashur për të dy prindërit e rinj, sjell një marrëdhënie të re në përpjekjen e tyre për të gjetur balancat e duhura për ruajtjen e familjes. Përkthyes: Viola Robo

Mall për ty, Harlan Coben

Harlan Coben - autori më i lexuar dhe i klasifikuar i pari në listën e shkrimtarëve më të lexuar sipas New York Times-it, botohet për herë të parë në shqip.

- Fitues i Çmimit Letrar më të famshëm dhe më të paguar në të gjithë botën për romane të kategorisë mister/thriller: RBA Prize for Crime Writing (Premio RBA de Novela Policiaca).

- Fitues i Edgar Award (Edgar Allan Poe)

- Fitues i Anthony Award (Anthony Bucher)

Mall për ty (Missing you) - një thriller kush-tuar një dashurie të porealizuar dhe një krimi që shoqërojnë jetën e personazhit kryesor të romanit.

Kejt Donovan, detektivja e Departamentit të Policisë së Qytetit të Nju-Jorkut, duke lundruar në një faqe interneti për njohje të reja, ndjeu se iu përmbys bota.

I fejuari i saj i dikurshëm, të cilin nuk e kishte parë prej tetëmbëdhjetë vjetësh, burri që i kishte copëtuar zemrën, po e vështronte ngul-tas nga ekrani i kompjuterit.

Por, kur Kejt nis të hyjë në komunikim online me burrin që fshihej pas atij profili, një komplot i paperceptueshëm del në dritë. Ndërkohë që fillon të hetojë, ndjenjat e saj për çdo njeri që kishte dashur, u vunë në dyshim - madje, edhe ato për babanë e saj, vrasja mizore e të cilit mbeti për Kejtin një enigmë e pazbuluar.


Duke guxuar dhe thelluar hetimin, ajo vë në rrezik jo vetëm jetën e saj, por edhe atë të njerëzve që e rrethojnë...

"Romanet e Harlan Coben-it janë si labirinte... Nëse do të jeni të mençur, do ta 'përpini' këtë libër dhe puzzle do të plotësohet."


-The Huffington Post

"Autori eksploron kostot e bashkëjetesës sonë të çmendur me teknologjinë... duke e bërë 'Mall për ty', një libër që nuk duhet humbur."

-The Providence Journal



Shantaram, Gregory David Roberts



Botimet Living prezantojnë librin më të ri "Shantaram", një vepër madhështore nga Gregory David Roberts.

"Vetëm pas një kohe të gjatë e pasi shëtita botën mbarë, arrita të mësoja se ç'është dashuria, fati dhe zgjedhjet që bëjmë në jetë. Ama, për të kuptuar thelbin e vërtetë të këtyre gjërave, më mjaftoi vetëm një çast, pikërisht atëherë kur më kishin lidhur me zinxhirë pas një muri e po më torturonin."

Kështu fillon kjo histori magjepsëse, e cila vjen nga bota kriminale e Bombayt të sotëm.

Lini, një i dënuar që arratiset nga një burg i sigurisë së lartë në Australi, përfundon në rrugët gumëzhitëse të një qyteti që i jep mundësinë të bëhet i padukshëm.

Ai dhe Prabakeri, udhërrëfyysi dhe miku i tij besnik, depërtojnë në shoqërinë e fshehtë të Bombayt, të mbushur

me lypsarë e mafiozë, prostituta e shenjtorë, gangsterë e aktorë, indianë e mërgimtarë, të cilët kërkojnë në këtë vend të mrekullueshëm, atë që nuk mund ta gjejnë gjetkë.

Rrugëtimi i Linit ndërthuret me luftën, burgun, torturat, vrasjet dhe një sërë tradhtish të mistershme e të përgjakshme.

Geto mes flakëve dhe hotele me pesë yje, dashuri romantike dhe vuajtje në burg, beteja mes bandash kriminale dhe filma të Bollivudit, të gjitha këto pasqyrojnë botën dhe eksperiencën njerëzore të përshkruar më së miri në këtë vepër madhështore, e cila ka në zemër dashurinë e zjarrtë për Indinë.

Bazuar në historinë e vërtetë dhe jetën e autorit, ky roman është pa dyshim prezantimi i parë i një zëri të jashtëzakonshëm në letërsi.

PËR 5 VJET, MË SHUMË SE 170 MIJË KOSOVARË LËSHUAN VENDIN

KOSOVA PO BRAKTISËT, POLITIKËS S'I BËHET VONË!

Në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme është theksuar se emigrimi i lartë do të ndikojë edhe në strukturën e popullsisë në vitet vijuese, pasi vlerësohet se pjesa dërmuese e emigrimit kishte përfshirë grupmoshat e reja kryesisht 25-44 vjeç. Shqetësuese, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbetet emigrimi i qytetarëve me nivel të lartë të edukimit. Më shqetësuese është edhe fakti që kjo dukuri po tenton të minimizohet nga autoritetet e vendit, të cilat kanë përgjegjësinë kryesore për këtë emigrim



dhe arsyet ishin: bashkimi familjar, martesat, punësimi, studimi, etj.

Qytetarët e Kosovës, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, migruan kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian, por kishte edhe qytetarë që u evidentuan se emigruan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Kanada. Sa u përket të dhënave për vitin 2018, ato nuk janë finalizuar ende nga autoritetet e Kosovës, por sipas disa të dhënave që i janë dhënë Radios Evropa e Lirë nga zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, tregohet se trendi i emigrimit ka shënuar rënie edhe gjatë vitit 2018. Sefedin Kuçi, udhëheqës i Divizionit për planifikim dhe statistika në Ministrinë e Punëve të Brendshme thotë për Radion Evropa e Lirë se të dhënat për numrin total të emigrantëve të Kosovës për vitin 2018 nuk dihen, por dihet se janë rreth 3500 qytetarë, të cilët kanë kërkuar azil në vendet e BE-së përgjatë vitit 2018. "Në aspektin e migrimit, në përgjithësi, duke përfshirë edhe çështjet që kanë të bëjnë trendet gjatë këtyre viteve, kanë qenë pozitive sa i përket emigrimit të parregullt çka do të thotë se kemi pasur rënie të konsiderueshme të migrimit të parregullt. Nëse e shikojmë aspektin e azilkërkuësve në shtetet e BE-së, emigrimi në vitin 2018 ka qenë në pikën më të ulët të azilkërkuësve. Nga 67 mijë kërkesa për azil, të cilat kanë qenë në vitin 2015 kjo shifër në vitin 2018 ka qenë 3515, pra ka një rënie të konsiderueshme. Ne

mendojmë se ky trend i rënies do të jetë edhe në vitin 2019", thotë Kuçi.

Ai thekson se rreth 98 për qind e këtyre kërkesave për azil të qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së gjatë vitit 2018, janë refuzuar. "Në vitin 2018 kemi pasur një ndryshim sa i përket shteteve ku qytetarët e Kosovës kanë kërkuar azil. Para vitit 2018, vendet ku qytetarët e Kosovës kanë kërkuar më shumë azil ka qenë Gjermania, Franca, Austria...kurse gjatë vitit 2018 kjo ka pasur ndryshim në renditje, ku 58 për qind e kosovarëve kanë kërkuar azil në Francë ndërsa në Gjermani 16 për qind në Itali 9 për qind e kështu me radhë", thotë Kuçi. Ky trend i rënies së emigrimit të parregullt, shton Kuçi, do të ketë ndikim pozitiv edhe në liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, të cilët janë të vetmit në vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk mund të udhëtojnë në zonën Shengen pa viza.

Përfaqësues të organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut emigrimin e qytetarëve të Kosovës për në vendet e ndryshme të botës e konsiderojnë si mjaft shqetësues. Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në Këshillin për Mbrojtjen Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, thotë për Radion Evropa e Lirë se emigrimi i qytetarëve të Kosovës në vendet e botës është luftë për ekzistencë. Kosova, shton ai, është një vend, i cili nuk është duke iu ofruar kushte elementare qytetarëve të saj dhe perspektivë të rinjve.

"Emigrimi po ndodh për faktin

se ka mungesë të vendeve të punës. Të rinjtë ndonëse përfundojnë studimet apo shkollat profesionale nuk mund të gjejnë një vend pune. Nepotizmi ka lëshuar rrënjë në Kosovë, nëse nuk ke një përkrahje politike nuk mund të gjeësh një vend pune dhe në mungesë të perspektivës, ata janë të detyruar të ikin nga vendi dhe të bëjnë një punë që nuk është në përputhje me kualifikimin që kanë, mirëpo ata detyrohen të ikin për një jetë më të mirë", thotë Shala. Ai thotë se të rinjtë nga Kosova po emigrojnë duke kaluar në rrugë të rrezikshme dhe po ju rrezikohet edhe jeta. "Të rinjtë nga Kosova po detyrohen që të emigrojnë, kjo nuk është dëshira e tyre por është një zgjidhje e imponuar nga kushtet e vështira ekonomike dhe sociale dhe pa perspektivës. Emigrimi është bërë një domosdoshmëri për të mbajtur familjen", thotë Shala. Shala thekson se më shqetësuese është edhe fakti që kjo dukuri po tenton të minimizohet nga autoritetet e vendit, të cilat siç thotë ai, kanë përgjegjësinë kryesore për këtë emigrim. Në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme ishte theksuar se emigrimi i lartë do të ndikojë edhe në strukturën e popullsisë në vitet vijuese pasi që vlerësohet se pjesa dërmuese e emigrimit kishte përfshirë grupmoshat e reja kryesisht 25-44 vjeç. Shqetësuese, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbetet emigrimi i qytetarëve me nivel të lartë të edukimit.

"Emigrimi po ndodh për shkak të mundësive më të mira për të bërë karrierë dhe kushteve socio-ekonomike në vendet e destinacionit, siç është evidente mjekët po emigrojnë në Gjermani. Bazuar në këtë, Kosova gradualisht po ballafaqohet me fenomenin e 'lkjes së trurit' ose me humbjen e kuadrove", thuhet në raportin e Ministrisë. Popullata me origjinë nga Kosova që jeton jashtë vendit më 2017 është llogaritur të jetë më shumë se 800 mijë, që është ekuivalente me 46.36 për qind e popullatës që jeton në Kosovë. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, i bërë në vitin 2011, numri i qytetarëve të Kosovës është llogaritur të jetë rreth 1.8 milion.

Taksa 100% në plan të dytë

Ambasadori i SHBA-së dhe ai i Britanisë së Madhe në Prishtinë gjatë javës së kaluar kanë kërkuar vazhdimisht të luftohet korrupsioni, nepotizmi, por asnjë fjalë nuk e kanë thënë për heqjen e taksës ndaj mallrave serbe. Për shkak të zhvillimeve politike në Serbi dhe në BE, ku pritet të mbahen zgjedhjet në maj të këtij viti, vlerësohet se çështja e taksës po lihet në plan të dytë, shkruan gazeta "Zëri". Ndonëse në fund të muajit shkurt dhe në pjesën e parë të marsit presioni ndërkombëtar për heqjen e taksës kishte arritur kulmin, gjatë javës që lëmë pas nuk është dëgjuar asnjë thirrje nga bashkësia ndërkombëtare për pezullimin e tarifës. Përkundrazi, ambasadorët e vendeve të QUINT-it kanë mbajtur takime e konferenca të vazhdueshme, por përpos kërkesave për luftim të korrupsionit e të nepotizmit nuk kanë përsëritur fare kërkesën për suspendim të masës 100 për qind ndaj produkteve serbe. Njohësit e çështjeve politike vlerësojnë se një zbehje e tillë e presionit ndërkombëtar vjen si rrjedhojë e mostërheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj nga vendimi për taksën, si dhe për shkak të zhvillimeve të brendshme në Serbi. Sipas tyre, Serbia aktualisht po ballafaqohet me protesta masive kundër presidentit Aleksandër Vuçiq dhe në këtë formë as pala serbe aktualisht nuk ka gatishmëri për vazhdimin e dialogut, me ç'rast shihet e pamundur një marrëveshje përfundimtare mes dy shteteve gjatë këtij viti. Por pavarësisht kësaj, zëdhënësja e Bashkimit Evropian, Maja Kocijančiq, gjatë një përgjigjeje dhënë gazetës "Zëri" ka kërkuar edhe një herë që tarifa prej 100 për qind e vendosur ndaj produkteve që vijnë nga Serbia e Bosnjë e Hercegovina të pezullohet sa më parë.

Opozita: Jemi larg NATO-s

Janë bërë dy dekada nga fillimi i sulmeve ajrore kundër caqeve policore serbe dhe njëmbëdhjetë vjet të funksionimit si shtet i pavarur, por Kosova është ende larg që të bëhet pjesë e Aleancës Veriatlantike, shkruan gazeta "Zëri". Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë për "Zërin" se Kosova nuk është afër anëtarësimit në NATO. Sipas tij, ende

nuk janë plotësuar kushtet për anëtarësim në këtë organizatë.

"Nuk mendoj se Kosova është afër anëtarësimit në NATO. Ka ende shumë punë për t'u bërë. Ne ende nuk i kemi plotësuar kushtet. Duhet të punojmë shumë më shumë për t'u anëtarësuar në NATO dhe në Bashkimin Evropian", ka thënë ai. Kurteshi është shprehur i pakënaqur me zhvillimet

që janë bërë që dy dekada, prejse NATO-ja ka hyrë në Kosovë.

"Unë publikisht kam deklaruar se jam i pakënaqur me zhvillimet gjatë këtyre dy dekadave, por edhe ata të cilët kanë ndikuar drejtpërdrejt që Kosova të ngecë e pranojnë se Kosova as përafërsisht nuk është zhvilluar sa do të duhej të ishte zhvilluar. Ka ngecje shumë të mëdha të cilat përveç arsyeve



objektive si lufta, është edhe keqpërdorimi i pushtetit të atyre të cilët kanë udhëhequr me vendin

gjatë këtyre dy dekadave, një pjesë e të cilëve aktualisht është në pushtet", ka theksuar ai.

MJALTI SINTETIK PO MBYT EUROPËN

Mjalti nga Kina, veç faktit se nuk ka asnjë përfitim shëndetësor, dyshohet se përmban metale të rënda dhe toksike, si dhe antibiotikë të ndryshëm

Mjalti konsumohet më gjerësisht në ditët e sotme sesa kurrë më parë. Kërkesa në rritje ka çuar gjithashtu në rritjen e produkteve të falsifikuara, duke e bërë produktin e tretë më të falsifikuar ushqimor në botë. Franca konsumon 40.000 ton në vit, por vetëm 10.000 ton prodhohet në këtë vend. Ndaj jo vetëm Franca por të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian importojnë mjaltë nga jashtë, rreth 60% të sasisë që konsumohet.

Edhe pse vendet e Bashkimit Evropian kanë një legjislacion të fortë për këtë produkt ku thuhet se "quhet mjaltë vetëm fruti i




bletës pa asnjë modifikim apo sasi të shtuar", në dyqane është e lehtë të gjejmë mjaltë që nuk e plotëson këtë përkufizim. Një studim i Komisionit Evropian të vitit 2017 zbuloi se një në tre (32%) enë me mjaltë kishin sheqer të shtuar. 6% e 2000 mostrave të testuara treguan gjurmë të sheqerit të shtuar. Mashtrimi rezultojë në mjaltin nga jashtë dhe posaçërisht atë nga Kina.

Sipas autoriteteve franceze arit të lëngët, veç shtimit të sheqerit, etiketimit të remë të vendit

të origjinës, tashmë mashtruesit industrial kanë arritur të krijojnë edhe mjaltin sintetik, i cili është shumë i ngjashëm me atë natyral. Po ashtu, testet kanë treguar se disa enë mjalti të etiketuar si spanjollë përmbanin polene të cilat gjenden vetëm në Kinë. Prodhuesit kinezë për tu shpëtuar këtyre kontrolleve shtojnë copa mikroskopike të algave të detit, të cilat mund të fshijnë të gjitha gjurmët e origjinës.

Këto teknika gjithnjë e më komplekse po e bëjnë gati të pa-

mundur zbulimin e mashtrimit. Për të gjitha llojet e mashtrimeve, viktima mbetet konsumatori. Mjalti nga Kina, veç faktit se nuk ka asnjë përfitim shëndetësor, dyshohet se përmban metale të rënda dhe toksike, si dhe antibiotikë të ndryshëm. Ndërkohë, Europa po shqyrton se si të mbrojë industrinë e saj prej 14.2 miliardë euro. Tashmë Franca ka votuar për etiketimin e detyrueshëm për mjaltin, dhe nis zbatimin në shtator 2019.



"Russiagate", bien akuzat ndaj Trumpit

Prokurori i posaçëm për çështjen "Russiagate", Robert Mueller, nuk gjeti asnjë lloj marrëveshjeje midis fushatës presidenciale të Donald Trump dhe Rusisë.

Megjithatë, "edhe nëse raporti nuk arrin në përfundim se presidenti amerikan ka kryer një krim, në të njëjtën kohë ai nuk e shfaqë atë", thuhet në letrën e Ministrit të Drejtësisë, Ëilliam Barr, i cili përmban përfundimet kryesore të hetimit të Mueller. Teksti u dërgua në Kongresin e SHBA. "Prokurori special, - lexohet, - nuk ka gjetur që fushata e Trump ose dikush që ka lidhje me të ka komplotuar ose koordinuar me qeverinë ruse në përpjekjet e saj, pavarësisht ofertave të ndryshme nga individë të lidhur me Rusinë për të ndihmuar fushatën e Trump". Për më tepër, ministri Barr beson se nuk ka dëshmi të mjaftueshme në raportin e Mueller për të vërtetuar se Trump ka penguar drejtësinë. Letra drejtuar Kongresit me konkluzionet kryesore të raportit mbi "Russiagate", u zhvillua nga Barr dhe zëvendës Ministri Rod Rosenstein, pa u konsultuar me Mueller. Edhe Shtëpia e Bardhë nuk ishte përfshirë në shqyrtimin e raportit të Mueller. Nga raporti i Mueller, shfaqet "pafajësia e plotë e Trump". Kjo është njëjtuar nga zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders. Avokati i presidentit amerikan, Rudolph Giuliani, ka komentuar: "Është më mirë sesa prisja".



May para presionit për dorëheqje

Kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May është duke u përballur me presion gjithnjë e më të madh që vjen nga Partia e saj Konservatore për dorëheqje apo për caktimin e datës së largimit të saj, për të siguruar mbështetje për planin e saj rreth Brexit-it. Mediat britanike sot raportojnë se disa zyrtarë të lartë partiakë kanë kërkuar nga May të pranojë për pozitën e saj të dobësuar politike dhe të japë dorëheqje. Por, deri më tani nuk ka zëra nga "Downing Street" rreth dorëheqjes së mundshme. May deri më tani ka arritur të sigurojë mbështetjen në Parlamentin britanik për planin e largimit nga Bashkimi Evropian, të cilën deputetët e refuzuan në dy raste. Ajo ka paralajmëruar se ekzistencë mundësia që të dërgojë planin për herë të tretë në procedurë parlamentare nëse nuk sigurohet mbështetja për miratimin e tij. Britania duhet të largohet nga BE-ja më 12 prill, përveç nëse plani i largimit nga Unioni nuk miratohet apo nëse nuk arrihet një aranzhman i ri.

Paris, ushtria i bashkohet policisë për të shtypur protestat

Protestuesit e njohur si "Xhaketat e Verdha" në Francë, kanë hyrë në fundjavën e 19-të të protestave kundër qeverisjes së presidentit francez Emmanuel Macron. Forcat ushtarake janë vendosur në Paris për të ndihmuar policinë e vendit, për shkak të eskalimit të mundshëm në dhunë.

Protestuesve iu ndalua të afrohen tek pjesa kryesore e qytetit Champs Elysees, për shkak të ankesave të bizneseve dhe dëmeve të shkaktuara ndaj tyre gjatë protestave. Të ashtuquajtur "Xhaketat e Verdha" protestuesit në Francë janë duke protestuar nga nëntori i vitit të kaluar, që filli-



misht nisi kundër ngritjes së çmimit të naftës.

Kjo lëvizje ka shënuar rritje kundër qeverisjes së Macronit,

edhe pas tërheqjes së ngritjes së çmimit të naftës dhe shpesh ka përfunduar me përplasje me autoritetet dhe eskalim të dhunës.


Rumunia, vendi i parë i BE-së që zhvendos ambasadën në Jerusalem

Kryeministrja rumune, Viorica Dancila, njoftoi zhvendosjen e ambasadës rumune nga Tel Avivi në Jerusalem. Është vendi i parë i BE që arrin të transferojë selinë e tij diplomatike pas vendimit të administratës Trump. "Unë jam e lumtur të njoftoj zhvendosjen e ambasadës sonë në Jerusalem, kryeqytet i shtetit të Izraelit", tha Dancila në konferencën e AL-PAC në Uashington.

Shtetet e Bashkuara e kanë zhvendosur zyrtarisht ambasadën e tyre në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalem në 14 maj të vitit

të shkuar, ndërkohë që të paktën 52 palestinezë u vranë dhe qindra u plagosën në përleshjet me forcat izraelite përgjatë kufirit të Rripit të Gazës me shtetin hebre. Ambasada e përkohshme do të funksionojë brenda ndërtesës së konsullatës ekzistuese amerikane në Jerusalem, derisa të gjenet një objekt më i përshtatshëm.

Vendosja e ambasadës amerikane në Jerusalem u miratua me votim dypartiak në Kongresin amerikan që në vitin 1995. Deri tani, të gjithë presidentët e



mëparshëm amerikanë patën nënshkruar çdo gjashtë muaj një

shtyrje të zbatimit të këtij vendimi, për arsye sigurie.



EGZON SHKOLOLLI FITNESI KËRKON VETËM SERIOZITET

“Me CrossFit jam i lidhur shumë dhe i shpenzoj 12 orë në ditë duke u stërvitur me klientë të ndryshëm. Është formë mjaft e vështirë e ushtrimeve fizike, por për çdo njeri që merret me këtë sport, suksesi është i garantuar”, thotë kështu Egzoni

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

Trajneri i njohur i disiplinës CrossFit në Kosovë, Egzon Shkolli, vazhdon të jetë një nga emrat më të mirë të kësaj fushe. CrossFit është disiplinë e fitnesit me intensitet të lartë që i inkorporon elementet e sporteve të ndryshme dhe llojet e ndryshme të ushtrimeve fizike. Ai si një emër që zgjon interesim në rrjetet sociale lidhur me ushtrimet e tij, nga kjo disiplinë vjen në një intervistë për InfraRed të gazetës KOHA duke treguar këshilla mbi këtë fushë. “Me CrossFit jam i lidhur shumë dhe i shpenzoj 12 orë në ditë duke u stërvitur me klientë të ndryshëm. Është formë mjaft e vështirë e ushtrimeve fizike, por për çdo njeri që merret me këtë sport, suksesi është i garantuar”, thotë kështu Egzoni.

KOHA: Me peshë të trupit dhe me peshëngritje, ushtrimet fizike ndahen në dy grupe, cilat janë më efektive në këtë rast?

Më efektive për mendimin tim është me peshë e trupit të ush-

trohet sepse formësohet trupi ashtu si duhet.

KOHA: A është më mirë të ushtrohet me pesha trupore, bëhet më shpejtë ndërtimi dhe



definimi i muskujve?

Po normal është më mirë të ushtrohet me pesha trupore, cardio strong.

KOHA: Muskujt e barkut ndërtohen në kuzhinë e jo në palestër, sa e vërtetë është kjo thënie për ju si trajner profesionist?

Është shumë e vërtetë që muskujt e barkut të ndërtohen në kuzhinë me shumë disiplinë të madhe.

KOHA: Dëshira për të ndërton një trup të bukur dhe me muskuj brenda një periudhe të shkurtër është e madhe, a mund ta bëjnë atë edhe fillestarët?

Gjithçka është e mundur vetëm duhet seriozitet edhe atëherë suksesi është i garantuar, të gjithë dikur kemi qenë fillestarë.

KOHA: Çfarë ushtrimesh apo ushqimesh do t'u këshillonit personave që duan trup të definuar?

Ushqime sa më të pasura me proteina, carbohydrate dhe vitamina.

KOHA: Cila është më e preferueshme gjatë ushtrimeve fizike: uji apo lëngjet e ndryshme?



Uji është mbi të gjitha, nuk ka diskutim sepse pa ujë trupi nuk funksionon dhe nuk mund të ndërtohet.

KOHA: Duke marrë parasysh se jeni shumë aktiv edhe online dhe të hapur për personat të cilët kërkojnë këshilla rreth kësaj fushe, sipas eksperiencës me këta persona, a mund të na tregoni cili është gabimi më i shpeshtë që bëhet nga fillestarët?

Gabimet që bëjnë fillestarët është se duhet mos me u ndal jo

vetëm një muaj ushtrime, por me kërkim që një trup të jetë i bukur duhet shumë kohë të gjatë ushtrime e gjëra.

KOHA: A mund të bëhet shkurtesha e yndyrës apo humbja e peshës edhe pa inkuadrinim e makinave kardiovaskulare në program?

Po mund të bëhet edhe pa makina kardiovaskulare, ka plot mënyra tjera që mund të shkrihet dhjami, vrapimi i mëngjesit është numër një.



Ajo është liderja më e re femëre në botë, duke përfshirë Zelandën e Re si Kryeministre në moshën 37 vjeçare. Por përpara se të merrte detyrën e rëndësishme, Jacinda Ardern bënte një jetë tjetër... në skenë - një kontrast i madh me detyrat e saja politike. Të dhënat tregojnë se Jacinda dikur ishte DJ. Pas buzëqeshjes së saj të ëmbël, politikania luajti muzikë si DJ për 45 minuta në festivalin e muzikës Laneway të Auckland në 2014.

Që kur u bë udhëheqëse e Partisë Laboriste, Instagrami ilustron karrierën e saj, e cila shfaqet si një grua luftëtare. Spinoff zbuloi gjurmët e DJ-ve amatorë, nga e ka-

luara e saj. Fillimisht ajo luante muzikën e Spice Girls, Beatles, Iggy Pop dhe Snoop Dogg. “Ajo është ende e njëjta grua e vërtetë, e sjellshme dhe tepër e mençur. Është një mike që mund të të shkaktojë të qeshura”, tha Isabelle Truman, e cila e ka njohur që në vitin 2014. Gjatë një interviste Truman bëri një pasqyrim të shkurtër rreth jetës së Kryeministres së Zelandës së Re, duke thënë se ajo ishte liderja më e re femëre në botë.

Znj. Ardern u lind në një familje të besimit mormon dhe ishte shumë e devotshme. Rreth të 20-ve e la besimin në mes dhe pranoi martesat e të njëjtit seks.

JACINDA ARDERN, GRUAJA NGA DJ QË U BË KRYEMINISTRE


“Unë do të jem një Kryeministre dhe një mama. Ndërkohë Clarke do të jetë shtëpiak, për tu kujdesur për fëmijën”, tha ajo në njoftimin e saj. Në një deklaratë zyrtare, znj. Ardern konfirmoi se do të nisë punën 6 javë pasi të lindë fëmijën, që pritet të vijë në jetë më 17 qershor

Duket se ajo gjithmonë ka pasur interes për politikën. Zonja Ardern bënte fushata në zgjedhjet e shkollës së mesme - duke i bërë thirrje shkollës që të lejonte vajzat të vishnin pantallona. Në moshën 17-vjeçare, filloi vullnetarizimin për Partinë Laboriste - duke shpërndarë fletushka. Ajo ndërroi gardërobën e saj, nga veshjet e thjeshta tek kostumet dhe në vitin 2008 u bë deputetja më e re e Zelandës së Re.

“Unë e pranoj që nuk jam një person normal”, tha në fjalimin e saj të parë në Kuvend, Ardern. Atë kohë, ajo u takua me prezantue-

sin e tanishëm televiziv, Clarke Cayford. Ky i fundit i kishte shkuar një letër ku i shfaqte shqetësimet rreth një projekt-ligji që kishte të bënte me sigurinë. Ajo që filloi si miqësi, u shndërrua shumë shpejt në një romancë dashurie. Në fillim të këtij viti zonja Ardern dha lajmin se po pret një fëmijë, duke e bërë atë udhëheqësen e parë në botë që nga viti 1990, që pret një fëmijë ndërsa ishte në detyrë. Ajo pret fëmijën e parë me partnerin e saj Z. Gayford.

“Unë do të jem një Kryeministre dhe një mama. Ndërkohë Clarke do të jetë shtëpiak, për tu



kujdesur për fëmijën”, tha ajo në njoftimin e saj. Në një deklaratë zyrtare, znj. Ardern konfirmoi se do të nisë punën 6 javë pasi të lindë fëmijën, që pritet të vijë në jetë më 17 qershor. “Do të bëj një marrëveshje me ministrat e mi, në kohën që nuk do të jem në punë. Nuk jam grua e parë në botë që punoj dhe kam një bebe. E di që këto janë rrethana të veçanta, por kemi edhe gra të tjera që e kanë bërë këtë gjë më parë”, tha shefja e qeverisë.

“E dinim që do të jenë shumë agresiv dhe do të në sulmojnë nga minuta e parë, këtë gjë edhe e prisim. Mirëpo ne edhe njëherë dëshmuam se jemi duke u përmirësuar në çdo ndeshje. Na duhej kjo pikë dhe falë Zotit ajo erdhi në konton tonë. Tani duhet të vazhdojmë me këtë tempo dhe do të jetë ashtu siç kemi planifikuar”, deklaroi Enis Bardhi

ELIMINATORET - EURO 2020

BARDHI: DUHET TË VAZHDOJMË MË KËTË RITËM



raste, por në vendin e duhur ishte Egzon Bejtullai, i cilo shkëlqeu plotësisht, duke arsyetuar besimin e Angelovskit. Futbollisti shqiptar, Enis Bardhi siguroi një pikë të madhe për Maqedoninë e Veriut, duke shënuar golin e barazimit. Bardhi ka theksuar se është i kënaqur me pikën e marë dhe me golin e realizuar në këtë përballje. “E dinim që do të jenë shumë agresiv dhe do të në sulmojnë nga minuta e parë, këtë gjë edhe e prisim. Mirëpo ne edhe njëherë

dëshmuam se jemi duke u përmirësuar në çdo ndeshje. Kishim raste që të barazojmë edhe më herët rezultatin, por duhej që të ishim të qetë dhe të pritnim rastin më ideal. Në shënimin e golit, vetëm e përçolla aksionin e Alioskit dhe kisha fat që shënova gol. Na duhej kjo pikë dhe falë Zotit ajo erdhi në konton tonë. Tani duhet të vazhdojmë me këtë tempo dhe do të jetë ashtu siç kemi planifikuar”, deklaroi Enis Bardhi. Nga ana tjetër trajneri i reprezentacio-

nit të Maqedonisë së Veriut, Igor Angelovski është shfaqur i kënaqur me lojën, por jo edhe rezultatin e sfidës së zhvilluar në stadiumin “Stozhice”. “Mendoj se në fillim thash se gjithçka që do të jetë më shumë se 3 pikë në këto ndeshje do të jetë e mirë për ne. Mirëpo ajo se çka ndodhi në ndeshje, mund të them se me këtë lojë të shkëlqyeshme mundeshim të arkëtojmë 3 pikë. Loja është ajo që na gëzon shumë, pasi që krijuam shumë raste ndaj Sllovenisë edhe atë të fushës e kundërshtarit. Kjo është një shenjë për kualitetin tonë. Më vjen keq për futbollistët që në minutat e fundit humbën koncentrimin. Mundeshim që në Slloveni të arkëtojmë 3 pikë”, tha mes tjerash Angelovski. Dy sfidat e ardhshme, Maqedonia e Veriut do ti zhvillojë në terrenin vendas, kundër Polonisë dhe Austrisë, më 7 dhe 10 qershor.

Ançeloti bindet nga Hysaj

Elseid Hysaj vuajti jo pak te Napoli pas ardhjes së Karlo Ançelotit. Trajneri italian shpesh herë e la në stol mbrojtësin shqiptar duke i besuar serbit Nikola Maksimović ose francezit Kevin Malkyit. Megjithatë, viti 2019 ka ndryshuar krejtësisht raportin mes lojtarit dhe trajnerit. Hysaj është kthyer në të luajë si titullar te Napoli, duke fituar plotësisht besimin e trajnerit të njohur. Me rregullimin e raportit mes të dyve hapi i radhës është rinovimi i kontratës. Marrëveshja aktuale midis Hysajt dhe klubit italian mbaron në vitin 2021, por sipas “Corriere dello Sport”, te Napoli kanë filluar negociatat e para për rinovimin e kontratës. Kjo lëvizje vjen me miratimin e vetë trajnerit Karlo Ançeloti. Në javën në vazhdim drejtuesit e Napolit do të ulen në tavolinë me agjentin e lojtarit shqiptar për të parashtruar ofertën e tyre dhe për të dëgjuar kërkesat e futbollistit.

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 25 mars - Përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut, arkëtoi një pikë të madhe në përballjen me Slloveninë, në kuadër të raundit të dytë të eliminatorëve EURO 2020. Vendasit dominuan pjesën e parë, duke marrë epërsinë përmes Zajcit, edhe pse Enis Bardhi kishte rast ideal që të mbyll pjesën e parë me gol. Mirëpo mesfushori shqiptarë u përmirësua në fillim të pjesës së dytë, kur pas asistimit të Alioskit, barazoi shifrat në 1-1 dhe festoi në notat e Alioskit. Deri në fund të takimit, vendasit u kanosën në disa

KEK: NUK MORËM ATË QË DESHËM

Trajneri i përfaqësueses së Sllovenisë Matijazh Kek ka potencuar se ekipi i Sllovenisë, posedon kualitet, por ende nuk ka treguar atë në terrenin e gjelbër. Kek theksoi se është realizuar ajo që ka paralajmëruar para kësaj sfide, se Maqedonia e Veriut ka kualitet dhe është në formë të mirë. “Ne nuk morëm rezultatin që e pritëm në këtë përballje, por është një

rezultat i realët pas asaj që ndodhi në terrenin e gjelbër. Një ndeshje interesante me mjaft nivele të ndryshimit të tempos së lojës, mirëpo në fund nuk arritëm që të jemi të suksesshëm, që të tregojmë kualitetin tonë, ndërsa kundërshtari tregoi se është kualitativ, një gjë të cilën e kam paralajmëruar para zhvillimit të takimit”, theksoi Matijazh Kek.



Kosova U-17 nis me humbje në “Elite Round”

Përfaqësuesja U-17 e Kosovës në futboll ka startuar me humbje në “Elite Round” të Kampionatit Evropian për këtë grupmoshë. Kosova, të hënën në ndeshjen e parë të Grupit 5, ka pësuar humbje nga Ukraina me rezultatin 2:0. Kjo ndeshje u zhvillua në Nyon të Zvicrës dhe Ukraina dy golat i realizoi gjatë pjesëlojës së parë. Në këtë grup, bëjnë pjesë edhe Spanja e Greqia. Ndeshjen e radhës, Kosova e luan të enjten (28 mars) kundër Spanjës ndërsa të dielën (31 mars) do të përballlet me Greqinë.



Shkup, 25 mars - Të dielën me kombëtarës së Shqipërisë U-19 është zhvilluar ndeshja miqësore dhe moshatarëve të Maqedonisë,



Maqedonia U19 barazon me Shqipërinë

sfidë që është mbyllur me rezultatin e barabartë 1-1. Ndryshe nga dy kombëtarët tjera kuqezi, ajo A dhe e U-21, 19-vjeçarët nuk janë mposhtur, pasi Broja ka shënuar gjatë pjesës së dytë për të rikthyer baraspeshën pas golit të Todorovskit që në minutën e 12 të takimit. Djemtë e drejtuar nga Nevil Dede

bënë një ndeshje relativisht të mirë, por ishin në disavantazh për shumicën e takimit. Kuqezinjtë tanë U-19 mbyllin me sukses një tjetër miqësore dhe tekniku Dede gjithmonë e më shumë po ndërton një formacion bazë për ekipin e tij, pasi ka testuar shumë lojtarë në këto sfida jo zyrtare.

LIGA E DYTË

Gobleni mposht Genç Kalemler

Shkup, 25 mars - Ekipi i e Goblenit ka shënuar fitore me rezultatin 1:0 ndaj Genç Kalemler në kuadër të javës së 17 në Ligën e Dytë-Perëndim. Golin e fitores për ekipin nikoqir e shënoi Hasani në minutën e dytë të ndeshjes. Kjo ishte fitorja e

parë e Goblenit para shikuesve te vet, e dyta radhazi në sezonin pranveror. Pas kësaj fitore tani skuadra e Goblenit radhitet në vendin e tetë me 20 pikë, kurse Genç Kalemler një vend më poshtë me dy pikë më pak.

NGA RABIOT, TE DE GEA E GODIN, YJET QË MUND TË LARGOHEN FALAS

Merkato e verës afrohet dhe po ndizet edhe më shumë dhe janë shumë lojtarë që në qershor do të jenë pa kontratë dhe mund të largohen në cilin klub të dëshirojnë

Fundi i këtij sezoni po afron, merkato e verës ndizet edhe më shumë dhe janë shumë lojtarë që në qershor do të jenë pa kontratë dhe mund të largohen në cilin klub të dëshirojnë. Po iu sjellim disa nga emrat më në zë që klubi juaj i zemrës mund t'i marrë për o euro.

Adrien Rabiot - Mesfushori do të largohet nga PSG në fund të këtij sezoni. Destinacioni më i mundshëm është Barcelona, por deri tani nuk është arritur të gjendet akordi mes palëve dhe blerja e Frenkie de Jong prish të gjitha planet. Për këtë një sërë klubesh janë vënë pas francezitet. Arsenal, Liverpool dhe Manchester United janë ndër emrat më të përfolur nga Pre-



mier League, gjithsesi Rabiot ka kërkuar pagë dhe pagesë të majme për parakontratë.

David de Gea - Portieri i Manchester United do të jetë lojtar i lirë në fund të këtij sezoni, duke qenë se i skadon kontrata në muajin qershor. Për spanjollin po

bëhen përpjekje për të rinovuar, por deri tani nuk është gjetur akordi. Real Madrid është i vetmi klub që mund të plotësojë kushtet e de Gea, por klubi spanjoll më parë duhet të zgjidhë të ardhmen e Thibaut Courtois dhe më pas të vihet në lëvizje për 28-vjeçarin.

Diego Godin - Mbrojtësi i Atletico Madrid e ka bërë të qartë se këtë verë do të largohet nga Spanja dhe të gjitha rrugët e çojnë në Itali, ku sipas të gjitha informacioneve flitet se ka firmosur një parakontratë me Inter. Gjithsesi për uruguaijanin interes të fortë ka edhe Manchester United në Angli.

Ander Herrera - Spanjoli është vlerësuar shumë tek Manchester United, cilësohet si mesfushor shumë punëtor, por deri tani nuk ka rinovuar kontratën e tij që i skadon në fund të sezonit. Herrera pritet të largohet nga United dhe e ardhmja e tij me të gjitha gjasat do të jetë në Francë, tek PSG.

David Luiz dhe Oliver Giroud - Të dy lojtarët e Chelsea janë në prag të skadimit të kontratës dhe vëra duket se do jetë e nxehtë për të dy. Giroud me të gjitha gjasat do të largohet nga Londra dhe për të do jetë një rikthim në Francë, ku Lyon dhe Marseille janë vënë pas tij për të gjetur akord. Edhe për Luiz duket se do të ketë ndryshim ambienti, për brazilianin ende nuk dihet se cila do jetë e ardhmja e tij.



Kroos mund të kalojë në PSG për 80 milion euro

Duket se kjo verë do të jetë vendimtare për të ardhmen e mesfushorit gjerman Toni Kroos, i cili është në kërkim të një sfide të re. Toni Kroos mund të kalojë në Paris Saint-Germain për një shumë rreth 80 milionë euro në verë, pasi është në kërkim të një sfide të re pas qëndrimit pesëvjeçar në Real Madrid. TalkSPORT raporton se një marrëveshje për ta sjellë mesfushorin gjerman në kryeqytetin francez mund të ndodhë shumë lehtë. Ky uebsajt nuk ka dhënë më shumë detaje rreth transferimit të mundshëm të Kroos, por pohon se blerja e tij mund t'i kushtojë PSG-së diku rreth 80 milionë euro.

Publicitet

Në bazë të nenit 17, 19 dhe 22 të Rregullores për realizimin e ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera në shkolla fillore nr. 07-9992/2 nga data 05.06.2014, Shkolla fillore komunale "Naim Frashëri", Kumanovë - Komisioni për furnizime publike shpall

SHPALLJE PUBLIKE
Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të lira të nxënësve për vitin shkollor 2018/2019

1. Ekskursion njëditor (piknik në natyrë) për të gjithë nxënësit prej klasës parë deri të nëntën
2. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasave të nënta në relacionin: Kumanovë-Shkup-Tetovë-Strugë-Ohër dhe anasjelltas,
3. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasave të pesta dhe të gjashta.

Kriteret për zgjedhjen e ofertuesit më të mirë janë këto:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me normat pozitive të Republikës së Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse nga turizmi;
- Të ketë realizuar me sukses së paku tri ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në tri vitet e fundit;
- T'i plotësojë kushtet për transportim të fëmijëve në grupe në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregulloren për kërkesa të veçanta të automjetit me të cilin barten fëmijët në grupe;

Oferta duhet të përmbajë - parasheh këto kushte:

- ☒ Çmimi për person dhe çmimin e përgjithshëm të shërbimeve (transporti, ushqimi dhe vendosja)
- ☒ Mënyra e pagesës;
- ☒ Numrin e arsimtarëve, udhëheqësve dhe mjekun
- ☒ Sigurimin e nxënësve
- ☒ Beneficionet për nxënësit që janë nga familjet me gjendje të rëndë sociale

Shpallja mbetet e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes në njetet e informimit publik.

Kriteri për zgjedhjen e ofertës më të volitshme është çmimi më i ulët i shërbimeve të ofruara.

Oferta e ofertuesit e cila nuk i plotëson kushtet minimale për shërbimet e ofruara dhe e cila nuk është e kompletuar sipas dokumentacionit të tenderit do të hedhet poshtë nga Komisioni për furnizime publike si e pa pranueshme.

Dokumentacionin tenderuesit mund ta marrin çdo ditë pune nga ora 8.00 - 16.00.

Oferta e kompletuar mund të dërgohet drejtpërdrejt ose në adresën e shkollës: Sh F K "Naim Frashëri", Kumanovë, rr. Vuk Karaxhiq p.n. Kumanovë, në kuvert të mbyllur me vërejtje "MOS E HA", për "Komisionin për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve".

Dokumentacioni e ofertës duhet të jetë në origjinal ose kopje e vërtetuar nga ofertuesi.

Kontakt: 031/427-423 ose 439-423 e-mail: naimfraseri_ku@hotmail.com

SHFK "Naim Frashëri", Kumanovë
Komisioni për furnizime publike

REPUBLICA E MAQEDONISË SË VERIUT
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" - Shkup
Fakulteti për elektroteknikë dhe teknologji informatike

Numër: 03-
Data: 2018.
SHKUP

Në bazë të nenit 172 dhe 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2008) dhe nenit 26 të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Fleta universitare nr.411/2018) dhe vendimi nr.02-602/4 e sjellur më 20.3.2019 nga Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit, dekani i Fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike ka sjellë **Vendim** për publikim

KONKURS
për zgjedhje në titull

1. Publikohet konkurs për zgjedhje të nga një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor për lëndët nga sferat mësimore-shkencore:

- 1.1. 10900 - Matematikë
- 1.2. 20302 - makina elektrike, transformatorë dhe aparate dhe 20303 - fuqia elektromotorike.

Zgjedhja është për periudhë prej 5 viteve

2. Publikohet konkurs për zgjedhje të asistentit për lëndët nga sfera mësimore-shkencore 103000 - fizikë

Zgjedhja është për periudhë prej 3 viteve

Kushtet: kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për arsim të lartë duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta dhe kushtet tjera të përcaktuara me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit Shën Kirili dhe Metodij dhe aktet e Fakultetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të paraqesin: dokumente për arsim të mbaruar, biografi të shkurtë, formularë të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, deklaratë për përmirshjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta nga vendi i punës, listë të punimeve profesionale dhe shkencore, nga një kopje të punimeve, certifikatë për njohje të gjuhës së huaj sipas nenit 24 të Rregullores (për kandidatët nën pikat 1.2 dhe 2).

Orari i punës është sipas orarit të orëve në semestër, ndërsa rroga themelore varet prej titullit dhe angazhimit mësimor në semestër. Mësimdhënësi i përzgjedhur themelon marrëdhënie pune për kohën për të cilën është zgjedhur.

Fletëparaqitjet me dokumentet e kompletuara të parashtrihen përmes arkivit të Fakultetit, ose përmes postës në adresën rr. Rugjer Boshkoviq 18, Shkup.

Konkursi zgjat 8 ditë nga dita e publikimit.

Nga FETI

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 nga Rregullorja për Mënyrën e Realizimit të ekskursionit shkollor për nxënësit e shkollave të mesme nr. 01-66/1 nga 26. 02. 2019, Komisioni për Mbledhjen e Ofertave për Realizimin e Ekskursionit të Nxënësve të SHM "Prerodba-Rilindja" - Zhitoshe publikon:

SHPALLJE
Për mbledhjen e ofertave për realizimin e ekskursionit të nxënësve pranë SHMK "Prerodba-Rilindja" - Zhitoshe

Në bazë të programit për realizimin e ekskursioneve përfundimtare disditorë të nxënësve, për vitin shkollor 2018-2019, mendimit të Këshillit të Prindërve, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Këshillit të Komunës së Dollnimit, SHMK "Prerodba-Rilindja" - Zhitoshe, në emër të prindërve organizon: Ekskursion përfundimtar disditorë me nxënësit e viteve III jashtë Republikës të Maqedonisë së Veriut në relacionin:

1. Zhitoshe - nëpërmjet Greqisë - në Kushadasi në R. e Turqisë - Zhitoshe, 5 ditë dhe 3 net.

Kriteret minimale që duhet t'i plotësojë ofertuesi janë këto:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM së V. për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.
- Të ketë realizuar me sukses së paku tre (3) ekskursione dhe aktivitete tjera të lira, në tre vitet e fundit;
- T'i plotësojë kushtet për transport të grupeve me fëmijë në pajtim me Ligjin për Sigurim në Komunikacion dhe Rrugë dhe Rregulloren për Kërkesa të Veçanta Teknike për Automjetet, me të cilat bëhet transporti i grupeve të fëmijëve.

Oferta duhet të përmbajë të dhëna për:

- Çmimi për nxënësit dhe ai i përgjithshëm (për vendosje, transport dhe ushqim),
- Kushtet për vendosje, meny për ushqim dhe transport,
- Në çmim hyjnë edhe sigurim gjatë udhëtimit dhe sigurim shëndetësor i nxënësve,
- Mënyra e pagesës,
- Udhëheqës turistik, numri i arsimtarëve (kemi 4 paralele në vitin III) dhe Mjek,
- Kushte të volitshme për nxënësit, të cilët vijnë nga familje me kushte të vështira sociale.

Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme - çmimi më i ulët.

- Ekskursioni do të realizohet me rreth 45 nxënës +- 10%.
- Ekskursioni është planifikuar të realizohet nga data: 28.04 - 03.05.2019.
- Programet në bazë të të cilës duhet përpiluar ofertat mund të merren në shkollë çdo ditë pune prej orës 09:00 - 14:00.

Me ofruesin e zgjedhur do të nënshkruhet marrëveshje, me kusht nëse deponon garanci bankare, për realizimin cilësor, me vlerë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Ofertat duhet të përfitohen në pajtueshmëri me Programin për Realizimin e Ekskursioneve dhe me dokumentacionin e nevojshëm i dorëzohen Komisionit, në arkivin e shkollës ose me postë.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur ndërsa në këndin e sipërm majtas të shkruhet "MOS E HAP - EKSURSIONI".

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune me ditën e publikimit.

SHMK "Prerodba - Rilindja" -fsh. Zhitoshe
P.F.Lazhan 7507 - Dollnen
Kont.tel.075 602 035
E-mail: miraim-bajrami@live.com

Të dhëna mbi strukturën dhe punën e botuesit të gazetës javore "Zenit"

Sipas nenit 15 të paragrafit 2 nga Ligji për media, Shoqata për veprimtari botuese, tregti dhe shërbime Zenit Pres Plus - import eksport SHPK Prilep, i publikon të dhënat në vijim:

1. Shoqata për veprimtari botuese, tregti dhe shërbime Zenit Pres Plus - import eksport SHPK Prilep, me seli në rr. Rampo Levkata 8a, është botues i gazetës javore "Zenit". Pronarë janë Svetlana Risteska, me vendqëndrim në rr. Boris Kidriqi nr.109 me pjesëmarrje të kryesisë themelore prej 50% të themelimit gjegjësisht prej 17.11.2015 dhe Ljupço Murgoski me vendqëndrim në rr. Marshal Tito nr.13 me pjesëmarrje të kryesisë themelore prej 50% të themelimit gjegjësisht prej 17.11.2015.
2. Redaktorë përgjegjës: Ljupço Murgoski dhe Svetlana Risteska
3. Në vitin 2018, 100% nga të ardhurat janë realizuar nga shitja e gazetave dhe reklamave.

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paraparë për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me sipërfaqe prej 9.000 m2. Tel. 071/372-215 & 078/243-583

NBA

ALDRIDGE MAGJIK PËR SPURS

Aldridge me 48 pikë e 13 rebaunder ka dhënë fitoren San Antonio Spurs në transfertën e Boston Celtics, me ndeshjen që përfundoi me rezultatin 96-115 për miqtë. Këta të fundit morën kryesimin e lojës që në periodën e parë, duke dominuar gjatë gjithë takimit



San Antonio Spurs mori një fitore shumë të rëndësishme 96-115 në parketin e Boston Celtics, duke hedhur një hap të sigurt drejt kualifikimit në play off, falë edhe humbjes së Sacramento Kings, që është skuadra e vetme që mund t'ia rrezikojë vendin e tetë. Të udhëhequr nga i papërmbyshmi LaMarcus Aldridge, i cili realizoi plot 48 pikë dhe kontrolloi 13 topa, teksanët gjetën forca për t'u rirritur pas dy humbjeve radhazi e tashmë mendojnë të qetë për takimin e ardhshëm me Charlotte Hornets. Në sfidën më të rëndësishme të mbrëmjes, Indiana Pacers dominoi në çdo aspekt ndaj Denver Nuggets, duke fituar me një rezultat të thellë 124-88. Spikati për Pacers kroati Bojan Bogdanovic me 35 pikë, ndërsa rivali i tij serb i Nuggets, Nikola Jokic, u ndal në 19 pikë e 11 "rebound". Sigurimi i një vendi në zonën play off mbetet tashmë formalitet për Houston Rockets, të tretët në Perëndim, që

fituan 90-113 në parketin e New Orleans Pelicans. Formacioni i Mike D'Antoni i dha drejtim sfidës që në periodën e parë me një rezultat të pjesshëm 19-33, pa e vënë në diskutim në asnjë moment suksesin. Shënuesi më i mirë ishte i zakonshmi James Harden me 28 pikë, i ndjekur nga Eric Gordon me 18 pikë, ndërsa për të zotët e shtëpisë 19 pikët e Frank Jackson ishin shumë pak për të rivalizuar skuadrën teksane. Fitore e bukur e Golden State Warriors 121-114 ndaj Detroit Pistons, me kampionët në fuqi të NBA që rimarrin kreun e Konferencës së Perëndimit. Stephen Curry e mbylli sfidën me 26 pikë, ndërsa Klay Thompson sh-

toi edhe 24 pikë të tjera për skuadrën e drejtuar nga Steve Kerr. Toronto Raptors, tashmë pa motivimin e duhur, pasi janë të blinduar në vendin e dytë në Lindje, humbën me vetëm një pikë diferencë 114-115 ndaj Charlotte Hornets. Kawhi Leonard (28 pikë) kaloi në avantazh të zotët e shtëpisë 114-112, por një trepikësh i çmendur i realizuar nga Jeremy Lamb para se të binte sirena për përfundimin e takimit u dha suksesin Hornets. Milwaukee Bucks dominoi ndaj Cleveland Cavaliers, duke triumfuar me rezultatin e thellë 127-105, falë "double-double" të të zakonshmit Giannis Antetokounmpo (26 pikë e 10 "rebound") dhe lojës në

grup, teksa 7 basketbollistë vendës arritën numër dyshifror pikësh. Kevin Love me 20 pikë e 19 rikuperime dhe Jordan Clarkson me 19 pikë rezultuan më të mirët në radhët e Cavaliers, që pa LeBron James këtë sezon e kanë të pamundur të klasifikohen në zonën play off. E meqë po flasim për "Mbretin" James, ishte pikërisht ish-i i Cavaliers inspiruesi i Lakers në fitoren 111-106 ndaj Sacramento King me "triple-double": 29 pikë, 11 asiste dhe 11 "rebound", i ndihmuar edhe nga Kyle Kuzma me 29 pikë. Gjithsesi, ky sukses nuk bën punë për zonën play off, pasi kalifornianët kanë mbetur jashtë edhe matematikisht.



Liverpooli gati të ulë çmimin për të "shpëtuar" nga Keita

Skuadra e Liverpoolit po vlerëson mundësinë për të larguar në fund të sezonit mesfushorin 24-vjeçar, Naby Keita, i cili u transferua me bujë të madhe nga Leipzig, që përfitoi plot 52 milionë pandë pas insistimit të Jürgen Klopp. Afrikani ka bërë një prezantim të dobët në 27 ndeshjet e fundit me Liverpoolin, duke mos shënuar asnjë gol dhe prania e tij në fushë thuhet se asnjë moment nuk ka bërë diferencën. Drejtuesit e klubit anglez janë gati të "humbi" një pjesë të investimit fillestar, duke pranuar 40 milionë paundë për futbollistin, që në Gjermani pëlqehet si nga Bayerni ashtu dhe nga Dortmundi. Menaxheri i Keita është në bisedime me të dy gjigantët gjermanë, por edhe me këtë ulje të çmimit duket e vështirë të arrihet marrëveshja.



Ferrero ëndërron Romën

Ndërkohë që shoqëria amerikane York Capital po negocion për të blerë Sampdoria, presidenti i kësaj të fundit, Massimo Ferrero ka konfirmuar dashurinë e tij për klubin e Romës. Numri një i dorianëve ka pranuar se ka lindur në Romë dhe se është verdhekuq, ndaj është i gatshëm të marrë skuadrën, në momentin që Pallotta të mendojë tërheqjen. "Kam lindur në Romë dhe jam verdhekuq. Jam gati të blej Romën, kur Pallotta të dalë në pension dhe t'u dhuroj tifozëve skuadrën që meritojnë", tha Ferrero. Presidenti aktual i Sampdorias është pyetur edhe më herët në lidhje me një tratativë të tillë, por ka thënë se për të blerë Romën, duhet më parë që pronari i saj të jetë dakord ta shesë.

"Fury is back", zyrtarizohet rivali i ardhshëm dhe data e rikthimit në ring

Tashmë është zyrtarë. Ish-kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri britanik Tyson Fury, do të duellojë më 15 qershor ndaj gjermanit Tom Schwarz, sfidë që do të zhvillohet në Las Vegas. Kjo do të jetë hera e parë për Fury, 27 fitore e 1 barazim në karrierën e tij, që duellohet në Teksas, ndërkohë që edhe rivali i tij gjerman është i pamposhtur në ring

(24 fitore e asnjë humbje). Schwarz një emër disi surprizë edhe pse është kampion i gjermanisë, por pak i njohur për fansat. Ndaj Fury konsiderohet si favorit për këtë duel, i pari për të që kur nënshkroi një marrëveshje me ESPN, sipas së cilës do të zhvillojë në Amerikë 4 sfidat e tij të radhës.



Fury është kritikuar për këtë zgjedhje, pasi sipas fansave nuk i garanton aspak suksesin mediatic që ai kërkonte, duke zbankuar në Amerikë. Schwarz mban vendin e dytë në kategorinë WBO, por

asnjëherë nuk ka duelluar në Amerikë. Boksieri britanik duhet të kishë zhvilluar në maj revanshin me Deontay Wilder, por marrëveshja u prish edhe pse fillimisht boksierët ranë dakord.

S'isha idiot të shkoja në lokale nate, flija mirë dhe pija vetëm ujë



Brugëtimi i Zinedine Zidane drejt majës si futbollist profesionist ka qenë i gjatë dhe i lodhshëm. Legjenda franceze ka rrëfyer për jetën e vet si futbollist. Zidane i kaloi pesë vitet e fundit të karrierës së tij si futbollist në Real Madrid, duke e fituar Ligën e Kampionëve dhe La Ligën, përkrah lojtarëve të mëdhenj si Ronaldo, Raul dhe Luis Figo. Megjithatë, hapat e tij të parë në futboll nuk ishin aq të shkëlqyer. "Prej fillimit e kam pasur të qartë. Krejt çka doja ishte të luaja futboll. Por kish vështirësi në

shkollë dhe prindërit më qortonin", tregoi Zidane. "E dija mirë se nuk e kisha qëndrimin e duhur. Pastaj, një ditë ata më thanë: 'ne e dimë që ke diçka në mendje, prandaj bëje atë që duhet ta bësh', shtoi ai. Ai tregoi se pasi iu bashkua Cannes në moshën 17-vjeçari ndryshoi stilin e jetës në mënyrë që të arrijë lart. "Kur mbërrita në Cannes, i pashë profesionistët duke stërvitur dhe thashë me vete: 'këtë dua ta bëj', shtoi ai. "Flija mirë, nuk isha idiot të shkoja nëpër lokale nate dhe pija vetëm ujë", tregoi ai.

"Juve e mirëpriti atë si një fëmijë, e bëri njeri. E ndihmoi të studionte dhe të stërvitej, e rriti atë në çdo drejtim. E bëri ky që është jo vetëm në fushë, por edhe në jetën si njeri. Klubi bardhezi ishte si babai i tij", ka thënë Isabelle

Moise Kean është lojtari i momentit në Itali, pasi shënoi dy gola njëri pas tjetrit. Të parin me Juventusin, kundër Udinese, ndërsa të dytin në debutimin si startues me kombëtaren axurre, kundër Finlandës. Tani, për të na treguar talentin e ri të futbollit italian, ka folur nëna e tij, Isabelle, e cila është intervistuar nga "Tuttosport". Ajo zbulon edhe një detaj për lindjen e Kean. "Giovanni lindi në vitin 1993 dhe Moise në vitin 2000. A e dini pse ne e quajmë atë të voglin e shtëpisë? Sepse lindja e tij ishte një mrekulli. Mjekët më thanë se nuk mund të kisha më fëmijë, unë bërtita dhe u luta. Natën që ëndërrova për Moise, ai "kishte ardhur" për të më ndihmuar, sepse pas katër muajsh isha përsëri shtatzënë", ka theksuar nëna e Kean. Jeta e familjes "Kean" ndryshoi kur Moise nënshkroi kontratën e tij të parë profesionale me Juventusin: "Ki-


KEAN, DJALOSHI QË NXORI NGA VARFËRIA FAMILJEN



shim shumë pak para në shtëpi. Një ditë, teksa ora shënonte 05:30 e mëngjesit, im bir, Moise, më telefonoi, ndërsa po shkoja në punë. Fillimisht u frikësova, mendova se diçka i kishte ndodhur atij, që më merrte në një orë të tillë, por më tha: mami, kam një surprizë për ty. Unë e pyeta plot ankth: Mos më thuaj që nuk ke nënshkruar me Juven. Dhe ai mu përgjigj: Jo, mami, kam nënshkruar dhe ju nuk do të punoni më, pasi do të vini të jetoni në Torino me mua". Dhe në fakt, djaloshti i talentuar i nxori nga varfëria, ku po "notonin" gjithë kohës. Kjo është arsyeja pse Isabelle e falënderon Juventusin,

që po punon për rinovimin e kontratës me Mino Raiola, për ta shmangur humbjen e Kean në afatin e caktuar, vitin 2020: "Juve e mirëpriti atë si një fëmijë, e bëri njeri. E ndihmoi të studionte dhe të stërvitej, e rriti atë në çdo drejtim. E bëri ky që është jo vetëm në fushë, por edhe në jetën si njeri. Klubi bardhezi ishte si babai i tij", ka thënë Isabelle. Së fundi, nëna e yllit të ri të Joves dhe Italisë konfirmon dëshirën e madhe të Kean, edhe brenda katër mureve të shtëpisë, ku nuk heq dorë nga "shoku" i tij më i mirë: "I jep atij një top dhe e bën të lumtur. Moise është i palodhur. Edhe pas

një dite trajnimit, ai kthehet në shtëpi dhe gjëja e parë që bën është të driblojë me topin. Problemi është se më përfshin dhe mua, më do si rivale, kur argëtohet me topin". Siç përmend "Tuttosport", Juventus po përpiqet ta "blindojë" Moise Kean, sepse xhevahirin e ri po e lakmojnë disa klube, mes të cilëve Ajax dhe Milan. Ato u interesuan edhe në janar, por trajneri Allegri kërkoi që sulmuesi i ri të qëndrojë. Sidoqoftë, gjërat mund të ndryshojnë, nëse Kean nuk merr më shumë garanci për aktivizim sezonin tjetër. Topi, me pak fjalë, kalon këtë kohë tek Allegri...



Messi fut në sherr dy federatat, Maroku shpërthen ndaj Argentinës

Gjithkush dëshiron ta shohë Messin në veprim, kjo është normale, sepse po flasim për futbollin më të mirë në botë. Kthimi i tij në kombëtaren e Argentinës iu mundëson më shumë tifozëve të futbollit ta shijojnë këtë lojtar, jo vetëm duke bërë mrekulli me katalanasit. Prandaj, zhgënjimi dhe zemërimi i Federatës së Futbollit të Marokut, duke e ditur se Leo Messi nuk do të marrë pjesë në miqësoren e së martës (ora 16:00) në Tangier, është i madh. Ylli i Barcelonës luajti 90 minuta në ndeshjen miqësore kundër Venezuelës, në "Wanda Metropolitano", që Argjentina e humbi 3-1, pavarësisht kthimit "nën armë" të pesë herë fituesit të "Topit të Artë". Pas kësaj ndeshjeje, shërbimet mjekësore të kombëtares argjentinase lëshuan një deklaratë, që pasqyrore një lëndim të vogël të Leos, që do ta pengonte atë të luante miqësoren e dytë, kësaj here ndaj Marokut. Sulmuesi argjentinasi u kthye në Barcelonë, në vend që të shkonte në Tangier, por Maroku pretendon se nuk është zbatuar kontrata mes dy federatave për këtë miqësore. Federata Marokene e Futbollit i kërkoi shpjegime homologues argjentinase për mungesën e Messit, duke i përmendur kontratën. Sipas marrëveshjes, Argjentina duhet të paraqitet me kombëtaren A në miqësoren me ta. Maroku e ka planifikuar ndeshjen kundër Argentinës në përgatitje për Kupën e Afrikës, që do të luhet në Egjipt prej 21 qershorit deri më 19 korrik, por nuk do të jetë në gjendje të përballlet me Leo Messin. Kapiteni i katalanasve tashmë është duke pushuar në shtëpinë e tij në Barcelonë, duke pritur ndeshjen e radhës të La Liga-s, derbin kundër Espanyol, që do të zhvillohet në "Camp Nou", të shtunën.




Reali ofertë monstruoze për Mbappe

280 milionë euro. Kjo është shifra që do të shpenzojë Real Madrid për të marrë Kylian Mbappe nga PSG. Sulmuesi francez është blerja galaktike që do të mbërrijë në verë në "Bernabeu". Ka qenë revista e famshme franceze, e cila jep edhe çmimin "Topi i Artë", "France Football" që në numrin e kësaj të hënë ka vendosur në faqe të parë planin për operacionin "Mbappe". Sipas kësaj medie, Zinedine Zidane ka vendosur që 20-vjeçari do jetë blerja e madhe e kësaj vere dhe presidenti Florentino Perez e ka përgatitur terrenin për të filluar punën. Në javët e ardhshme pritet që Reali të fillojë negociimin me PSG-në dhe do jetë një telenovelë e vërtetë deri në fund të sezonit. Do të zgjasë përgjatë gjithë pranverës dhe në verë do të jetë definitive. Nëse ku transferim do të realizohet do të ishte rekordi më i ri në botë. Duke qenë se kalimi i Neymar nga Barcelona te PSG kushtoi 220 milionë euro.

Icardi pranë rikthimit, Wanda provokon sërish Interin

Pas më shumë se një muaji pushim total, Mauro Icardi u kthye në stërvitje me Interin javën e shkuar dhe pas triumfit në derbi, ky ka qenë lajmi më i bukur për tifozët. Megjithatë, ish-kapiteni zikaltër nuk është ende gati për të luajtur dhe duket se do të duhet edhe pak kohë që të shërohen të gjitha plagët, edhe ato me klubin. Rinovimi i kontratës nuk po duket gjëkund dhe kjo është arsyeja pse Interi e Icardi janë në konflikt, ndërkohë që bashkëshortja-agjente e sulmuesit, Wanda Nara, thuhet se çdo ditë provokon, herë hapur e herë ë mënyrë të maskuar. Të dielën në mbrëmje Wanda postoi




një foto në Instagram, ku synimi është të reklamojë fizikun e saj, por ndërkohë mesazhi i fotos qëllon tjetërkund: "Ata që luajnë për të të humbur, lëri të fitojnë". Një mesazh në kod, që në një farë mënyre i drejtohet Icardit, i cili në

gjithë këto javë krizë nuk ka folur asnjëherë dhe ka pasur vetëm një mesazh në rrjetet sociale, ku ka deklaruar se nuk mendon për lajmin nga Interi. Gjithsesi, ndoshta planet e menaxheres së tij nuk janë të njëjtat...

Pogba ka vendosur ta lërë Unitedin

Paul Pogba ka vendosur ta braktisë Manchester Unitedin këtë verë. Agjenti i tij, Mino Raiola, është duke punuar tashmë për t'ia gjetur mesfushorin francez një klub të ri. Rrëfimi i fundit i Paul Pogbas se është ëndërr e çdokujt të luaj për Real Madridin me Zinedine Zidane në stol, ishte një lëvizje e menduar për të sugjeruar se ai është i hapur për t'iu bashkuar gjigantit spanjoll, shkruan e përditshmja spanjolle "AS". Pogba dëshi-

ron të largohet nga Premierliga pas tri viteve qëndrimi në "Old Trafford". Ai u përpoq të largohet gjatë afatit kalimtar dimëror, pas marrëdhënieve të këqija me trajnerin e atëhershëm Jose Mourinhos, dhe flitej se mund të kalonte në Barcelonë. Mourinho ka ikur po Pogba ende ndien e është koha që ai të largohet në kërkim të një sfide të re, qoftë në Spanjë apo në Itali. Agjenti i tij, Mino Raiola, është specialist në pazare të vësh-



tira, dhe është duke punuar për t'ia gjetur klubin e ti. Real Madridi është favorit për t'i siguruar shërbimet e tij, por ish-klubi i tij Juventus, do ta kthente francezin ka menduar dy herë, nëse ai vërtet ka vendosur ta lërë Unitedin.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do bëni mire te mos luani me zjarrin sot ju te dashuruarit sepse situata mund te dale jashtë kontrollit. Me qetësi dhe maturi do mund te zgjidhet me mire çdo gjë. Beqaret do marrin vendime te nxituara dhe mund te lëndohen tej mase. Buxheti nuk do jete i keq, megjithatë mire është te shpenzoni sa me pak ne mënyrë qe te grumbulloni te ardhura edhe për me vonë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Dite e jashtëzakonshme do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do keni një mirëkuptim dhe komunikim për t'u adhuruar. Beqaret do ndihen mjaft mire edhe me statusin qe kane dhe nuk do duan te bëjnë ndryshime. Me mire le t'ia lënë gjerat kohës dhe le te presin momentin e duhur. Financat nuk do kenë aspak te mira, prandaj shmangni me çdo kusht investimet e pamenduara.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Nëse kohet e fundit partneri iu ka kritikuar për mungese entuziazmi dhe dinamizmi, sot ai nuk do mundet dot ta beje. Atmosfera ne jetën ne çift ka për te qene e jashtëzakonshme. Beqaret do ndihmohen mjaft nga Marsi dhe do jene plot sharm dhe humor. Do tërheqin pas vetes shume persona dhe ne fund do bëjnë zgjedhjen e duhur. Sektori i financave ka për te qene i favorizuar.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dite e bukur dhe pa probleme do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Mosmarrëveshjet e se shkuarës do i harroni njëherë e përgjithmonë. Beqaret do kenë një dite goxha te ndërlikuar dhe nuk do e kenë aspak mendjen te kërkojnë dashurinë. Buxheti nuk do jete ne gjendjen me te mire te mundshme kështu qe mire është te mateni disa here para se te shpenzoni.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Sot do ketë ndryshime te mëdha ne jetën tuaj ne çift. Do flisni gjere e gjate me partnerin tuaj për te kaluarën dhe për te ardhmen. Ne fund te ditës do merrni edhe vendime. Beqaret nuk do e kërkojnë me ngulm princin e kaltër, por ja qe yjet do ua servirin ne pjate te argjendte. Buxheti do jete mjaft i favorizuar. Do i kryeni pa frike shpenzimet dhe mund te hiqni edhe disa para mënjane.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dite e bukur do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Nuk do keni aspak mosmarrëveshje, përkundrazi do merrni vesh edhe me mire me njeri-tjetrin. Beqaret do kenë ende nevojë për kohe për te menduar për ndryshime te statusit, prandaj do i refuzojnë ftesat qe do iu bëhen. Ne planin financiar ka rrezik te ketë goxha vështirësi. Kujdes me çdo shpenzim.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Sot do i jepni prioritet absolut jetës tuaj ne çift dhe marrëdhënia me partnerin do ketë goxha përmirësime. Vazhdoni t'i shprehni edhe ndjenjat ashtu si t'i keni ne zemër. Beqaret do kenë një dite te zakonshme dhe pa ndonjë takim mbresëlënës. Ende nuk ka ardhur koha e ndryshimeve t mëdha. Me shpenzimet duhet te tregoheni me te arsyeshëm ne mënyrë qe te mos lindin probleme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dita e sotme do filloje e qete për ata qe janë ne një lidhje, por pas mesditës gjithçka do ndryshoje. Do arrini t'i shprehni edhe me tepër ndjenjat tuaja dhe emocionet do shtohen. Beqaret do kenë vetëm disa takime interesante, asgjë me shume sesa aq. Ne planin financiar do keni një dite me shume fat. Buxheti do përmirësohet aq shume saqë do ju duket vërtet e çuditshme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Sot duhet te përgatiteni për një dite te jashtëzakonshme ju te dashuruarit. Marrëdhënia me partnerin do jete e kënaqshme dhe ne çdo çast do përjetoni emocione te forta. Beqaret do fiksohen keq pas një personi dhe do bëjnë te pamundurën për ta bëjnë për vete. Rezultati do jete i dëshiruari. Buxheti do jete me i mire për artistet, piktorët, aktorët. Te tjerët duhet te tregohen te kujdesshëm.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ka rrezik te takoni persona interesante sot dhe mund te mos i qëndroni besnike atij qe keni ne krah. Kjo mund te ndeze debate dhe konflikte te njëpasnjëshme. Beqaret me mire t'i marrin gjerat shtruar dhe për asgjë te mos nxitohen. Do vije edhe momenti i tyre. Me shpenzimet do jeni me te kujdesshëm kështu qe gjendja do mbetet e qëndrueshme ne çdo moment.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse jeni ne një lidhje, sot do kaloni një dite te mbushur me çaste te lumtura. Kënaqësitë do jete vërtet te forta dhe do ju bëjnë ta dashuroni akoma me tepër jetën. Beqaret nuk do ndihen ende gati për te filluar lidhje prandaj do i refuzojnë ftesat qe do iu bëhen. Për financat nuk ka për te qene një dite e mire. Mundohuni qe ne çdo moment te tregoheni me matur me shpenzimet.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dite shume e kënaqshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do merrni vesh për çdo gjë me atë qe keni ne krah dhe problemeve te se shkuarës do iu vini njëherë e mire kapak. Beqaret do i shprehin pafund ndjenjat e tyre edhe sikur ta dine se nuk do arrijnë atë qe duan. Për financat do jete një dite goxha e ndërlikuar. Kujdes me çdo shpenzim.



NE KETE DATE

Mensur Mamuti	UDHËHEQËSI I MADH I USHTRISË MUSLIMANE (NË FOTO)	NGACIMI	TË QENËT RIVAL ME NJE TJETER	UDHËPËRSHKRIM
SHTET ARAB (PASHQI), SULLTAN I TË CILIT U SHPALL PERSONI NË FOTO, MË 26 MARS 1169				
EZMADHON				
HISTORIANI ROMAK, TIT				
FUTBOLLISTI TURK, XHEM				
DREDHI, PADREJTESI (BISED.)				
FUTBOLLISTI SHQIPTAR, RRAHMANI				
PRUJËSI I KOZAKEVE				

KOHA	PASHTRRME (PERDORET PER KAFSHET)	USHTRIA REPUBLIKANE IRLANDEZE	MBËSHTJELLËSJA E METALTE E PLUMBIT	K	AKTORJA LATINO-AMERIKANE, RIERA
MONARKIA TË CILËN E THEMELOI PERSONI NË FOTO			VEND NË FRANCË		NOFKA E 'EMINEMIT', SHADI
AVIONËT					ERBIUMI
A					BANKA NACIONALE E GREQISE
KOHA	PËRHAPJA E DITURIVE (SH.)				SHKRONJA E KATERT
METRI	NDODHI, ÇËSHTJE (BISED.)	KËNGËTARI, FLORI			TITULLI I PRUJËSIT NË FOTO
SHTET NË AZI		KOSH PESHKIMI, RRAHÇE			
N				NJË NGA 56 POPULLT ETNIKE KINEZE	ULTRA FILTRIMI
KËNGËTARI VLLASALIU				QYTET NË AUSTRALI	ISH FUTBOLLISTI I SHKENDËJES, BESIM
E SJIELL RRETH E RRROTULL				ATLETI XHAMAJKAN, USAIN	
				LËNG PORTOKALLI	
				SHTET ARAB, SULLTAN I PARË TË CILIT PRUJËSI NË FOTO	
				METNERIUMI (ELEMENT KIMIK)	
GJUHË BANTU QË FLITET NË KAMERUN					KORNIZË
					TEMPERATURA
MATEMATIKANI DHE POETI GREK NGA KIRENEA					

ERATOSTENI, ARSIME, Ç, M, MUMAJESI, NEPAL, NU, UF, SINAN, BOLLT, END, EGJIPTI, LAIMBU, RAM, ZGJIDHET: SIRI, E RIT, LIVI, ATAN, HILE, AMIR, K, ADITA, DINASTI, ER, AEROPLANET,

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

2	8			5				6				9	2			
							9	8		1			3			9
		6	3					2		6			1		3	
9									8	2		3		9		1
		3			1	8					4				5	
	1	7		4					1			6		4		9 8
		9						5			9		3			2
	7		5	3							7					4
				8	7		3	4		4		2		6		

Shumë i lehtë: 281459376, 345726918, 796318425, 928673541, 453291867, 617845293, 839164752, 174532689, 562987134. Mesatar: 738942615, 415863279, 962517384, 827359461, 694178532, 153624798, 579431826, 286795143, 341286957.

NGA INDONEZIA DREJT RUSISË ME ORANGUTANGUN NË AVION!




Një turist rus, 27 vjeçar, u arrestua në aeroportin e Balit, në Indonezi, pasi agjentët e doganës i gjetën në valixhe një organutang 2-vjeçar, të narkotizuar. Andrei Zhestkov, i cili rrezikon për momentin 5 vjet burg dhe një gjobë prej 7 mijë dollarësh për "trafik të specieve të mbrojtura", ka rrëfyer se e ka blerë kafshën për 3 mijë

dollar nga një mik, i cili e kishte blerë në një markatë rruge në Giava. Zhestkov, në valixhen e të cilit, doganierët gjetën edhe mbulesa fëmijësh dhe qumësht për të sapolindurit, me qëllim që t'i shërbenin majmunit, shpjegoi se qëllimi i tij ishte të çonte kafshën në Rusi për ta mbajtur për shoqëri. Orangutangët janë një specie në



rrezik kritik, sipas Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, me vetëm 100 mijë ekzemplarë të mbetur në të gjithë botën. Sidomos në Indonezi, këto kafshë vriten dhe kapen me ritme të papërballueshme, si nga kontrabanduesit, si nga punëtorët që shpyllëzojnë pyjet për të kultivuar palmat për vaj.



Humb bagazhin, përfundon aventurën në liqenin e ngrirë

Një aventurier përfundoi një maratonë 100 milje përgjatë një liqeni të ngrirë Mongolian pasi linja ajrore e tij humbi bagazhin e saj. Peter Messervy-Gross, 47 vjeç, kaloi muaj duke blerë çantë specialistësh për sfidën katër-ditore të Mongol 100, e cila u zhvillua në temperatura deri në -25 °C. Por kur ai fluturoi nga Heathrow në kryeqytetin e Mongolisë, Ulaanbaatar, çantat e tij nuk dolën nga aeroplan. Në pamundësi për të blerë këpucë për të përshatur madhësinë e tij 13 metra, ai vendosi të marrë në sfidë në atë që ai kishte veshur. "Këpucët e mia janë mbajtur deri në mënyrë të habitshme mirë", tha Messervy-Gross. Messervy-Grossit, fillimisht nga linja ajrore Aeroflot iu tha se bagazhi i tij do të mbërrinte para garës. Por, kur ai dhe konkurrentët e tjerë morën udhëtuat nga liqeni Nuur në Khovsgol në veri të vendit ai kuptoi se çanta e tij nuk do të vinte. Udhëtarët e tjerë, dhe organizatorët e Mbretërisë së Bashkuar, i huan atij racione urgjente dhe rroba shtesë. "Njerëzit ishin të mahnitshëm, duke ofruar gjëra për mua për të përdorur, gjë që ishte e pabesueshme, sepse do të thoshte se ata ishin më keq. Një djalë më dha disa çorape, unë isha një dyqan bamirësie në këmbë!", shtoi ai.

Shpallet mësuesi më i mirë në botë, merr çmimin 1 milion dollarë

Një mësues i shkencave në Kenia, që ka dhënë pjesën më të madhe të pagës së tij për të mbështetur nxënësit e varfër, ka fituar një çmim prej 1 milion dollarë si mësuesi më i mirë në botë. Peter Tabichi fitoi çmimin 2019 Global Teacher Prize. Prifti françeskan u vlerësua për arritjet e tij në një shkollë provinciale të mbushur me nxënës dhe disa tekste librash. Ai mori çmimin në një ceremoni në Dubai. Tabichi ka dhënë 80% të pagës së tij për të mbështetur nxënësit në shkollën Keriko Mixed Day Secondary School në fshatin Pwani, Nakuru të cilët nuk kanë para për të blerë libra apo uniformat. Shumë prej fëmijëve që ndihmon janë jetimë ose kanë humbur një prind. Mësuesi 36 vjeçar dëshiron të ngrejë aspiratat dhe të pro-



movojë kauzën e shkencës, jo vetëm në Kenia, por në të gjithë Afrikën. "Afrika do të prodhojë shkencëtarë, inxhinierë, sipërmarrës, emrat e të cilëve do të jenë një ditë e famshme në çdo cep të botës," tha ai. Prifi mposhti në konkurs 10.000 mësues të tjerë të nominuar nga 179 vende të botës.

21-vjeçarja serbe fejohe me 74-vjeçarin: Seks çdo ditë!



Një histori dashurie, nëse mund të quhet e tillë, mes një 21-vjeçareje dhe një 74-vjeçari, ka tronditur Serbinë. Një vajzë e re është fejuar me një burrë 53 vite më të madh se vetja. Por Milijana Bogdanoviç, duke folur hapur për jetën e saj seksuale, thotë se bën seks çdo ditë me partnerin e saj. Ai quhet Milojko "Mikan" Boziç, për të cilin partnerja thotë se nuk ka nevojë të përdorë viagra. Çifti nga Serbia i ka habitur të gjithë me

marrëdhënien e tyre. Edhe pse Boziç iu nënshtrua një operacioni në zemër në dhjetor, kjo nuk i ka ndaluar të planifikojnë të ardhmen së bashku. Ata po përgatiten për t'u martuar më 7 shtator dhe shpresojnë të krijojnë një familje. "Ne bëjmë seks çdo ditë dhe nuk më duket e çuditshme. Ai është si një djalë i ri kur bëhet fjala për seks dhe nuk ka nevojë për viagra, - tha 21-vjeçarja. - Edhe pse nuk mund të flas shumë për meshkujt e rinj, pasi gjithmonë jam lidhur me burra më të vjetër se unë". Bogdanoviç shtoi se ishte pamja e të moshuarit që e tërhoqi.

"Për vitet që ka, duket i përsosur dhe nuk më intereson çfarë thonë njerëzit. E njoh Mikan prej shumë vitesh dhe e ndihmova kur ishte sëmurë, kur lindi edhe dashuria jonë", shtoi ajo. Në fakt, Boziç ka tre fëmijë të moshës 40, 35 dhe 30 vjeç, nga martesat e tij e parë dhe dy nipër 13 dhe 11 vjeç. Për të, kjo marrëdhënie ishte një surprizë e vërtetë: "Në moshën time nuk prisja të dashurohesha sërisht...".

1340 - Mbreti i Anglisë Eduardi III shpallet mbret i Francës.

1500 - Vicente Yáñez Pinzón është evropiani i parë që ka shkelur tokën e Brazilit.

1531 - Tërmet në Lisbonë: rreth 30,000 të vdekur.

1666 - Franca i shpall luftë Anglisë dhe Munsterit.

1699 - Venediku, Polonia dhe Austria nënshkruajnë Traktat të paqes me Turqinë.

1748 - Anglia, Holanda, Austria dhe Sardenja nënshkruajnë traktat kundër Francës.

1784 - Benjamin Franklin shpreh pakënaqësinë që shqiponja të jetë simbol i Amerikës.

1797 - Rusia, Prusia dhe Austria nënshkruajnë traktat paqeje.

1837 - Michigan shpallet shteti i 26 i SHBA.

1838 - Tennessee bëhet shteti i parë që ndalon pijen e alkoolit.


1910 - Shi i madh shkakton vërshime në Paris.

1939 - Franko pushton Barcelonën.

1957 - India përvetëson Kashmirin.

1980 - Izraeli dhe Egjipti vendosin marrëdhënie diplomatike.

Ekzistenca e Antarktikut ka qenë plotësisht e panjohur deri në vitet 1820 kur u vu re për herë të parë. Rreth 20 vite në pas u konfirmua fakti se nuk ishte një grup ishujsh, por një kontinent i tërë.



Në botë çdo ditë priten 27000 drunj për të prodhuar letër higjienike, dhe në qoftë se riciklohet letra, shpëtohen 17 drunj.



Vera në planetin e Neptunit është 40 vite e gjatë, por temperatura atje është -300 gradë.



HARRESA

Një qytetar shkon te doktori:

- Doktor, po vërej se nuk po mbaj në mend fare!
- Doktor: Prej kur?
- Qytetari: Çka prej kur?



Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh. (RALF VALDO EMERSON)